

Michele Greco da Valona, i rikthehet kombit shqiptar

Nga Marsela Rustemaj

“Michele da Valona- Protagonist i Rilindjes Adriatike mes Shqipërisë dhe Italisë”

Nga Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha



Festa e bukur e librit shqip në Preshevë

“Synojmë ta kthejmë
në traditë”

Nga **Ardita Sinani**,
Kryetare e Komunës së
Preshevës

Çmimi Special i Panairit Romanit “Brenga” të Pashko Camajt

Autori: çmimin ia kushtoj heroit real
të romanit, Tonin Mirakajt

U nderuan me “Çmimin e karrierës”
shkrimtarët Ylljet Aliçkaj dhe
Namik Dokle (fq. 8)

SHËNIME MBI LIBRAT

Libri “Dal në portë e hyj në dritë...” i Martin Cukallës

Legjendat e Butrintit
në një vëllim poetik

Nga **Ylli Pepo** (fq. 14)

Libri “Gruaja që endej hijeve” i Irena Dragotit

Bota femërore
në një vëllim me tregime

Nga **Fatbardh Amursi** (fq. 19)

“Grue prej zjermi” e Donika Dabishevcit

Arkitektura poetike
e qenies

Nga **Mërgim Bekteshi** (fq. 5)

Talia Hibbert, Trilogjia e Motrave Braun, Toena

Dëshira dhe e drejta për
lumturi: një lexim i trilogjisë
së motrave Braun

Nga **Anja Levanaj** (fq. 23)



Meditim mbi një tekst poetik të Ervin Hatibit

Nga Yzedin Hima

Poezia “**Mesnatë në bregdet**” e Ervin Hatibit është një krijim lirik me një ndjeshmëri të hollë, ku peizazhi detar dhe përjetimi intim shkrihen në një tablo unike estetike. Përmes një gjuhetë thjeshtë, por jashtëzakonisht figurative, Hatibi ndërton një urë mes reales dhe imagjinare, mes natyrës së qetësuar dhe botës së brendshme të subjektit lirik.

Vrasësi i Pushkinit: fakte tronditëse për të cilat tekstet shkollore heshtin

(fq. 22)

Çfarë mbetet nga romani “Emri i Trëndafilit”



Nga **Bruno Pischedda** (fq. 20)

BIBLIOTEKË

Xhelal Tosku (fq. 10)

Pilati lau duart

Gabriela Mujaj (fq. 12)

Lumnia

Arben Velo (fq. 13)

Fustani i Penelopës

Martin Cukalla (fq. 14)

Dal në portë e hyj në Dritë

Irena Dragoti (fq. 18)

Gruaja që endej hijeve

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Fundviti i studimeve në
Beograd dhe afrimi me Jakovin
Nga **Dhurata Xoxa** (fq. 16)

Botim i ri nga Ombra GVG


CARYL LEWIS, Mjaltë i hidhur

Përktheu: Sidita Dano Hoxhiq (fq. 21)

Libri shqip në SHBA
& KANADA

Dërgesa të shpejta
dhe të sigurta

www.albllibris.al



Fondacioni 355 Hub Foundation, në bashkëpunim me partnerët institucionalë shqiptarë dhe italianë, organizoi më 25 qershor 2026, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë – Qendra “Sotir Kolea”, konferencën ndërkombëtare “Michele da Valona – Protagonist i Rilindjes Adriatike mes Shqipërisë dhe Italisë”. Ky aktivitet synoi të rikthejë në vëmendjen e studimeve historiko-artistike figurën e piktorit Michele Greco da Valona, një prej personaliteteve më domethënëse të artit adriatik të fund shekullit XV dhe fillimit të shekullit XVI. Në vijim të kërkimeve më të fundit të studiuesve italianë, konferenca propozon një lexim të ri të veprës së tij si një urë lidhëse ndërmjet traditës bizantine shqiptare dhe zhvillimeve të Rilindjes italiane, duke e vendosur artistin në qendër të dialogut kulturor mes dy brigjeve të Adriatikut.

Konferenca solli në Tiranë disa prej studiuesve më të njohur italianë mbi këtë periudhë të historisë së artit, ndër të cilët Dr. Dora Catalano, historiane arti dhe ish-Superintendente e Arteve të Bukura të Rajonit Molise, autore e studimeve themelore mbi Michele da Valona; Dr. Veruska Picchiarelli, historiane arti pranë Muzeve Kombëtare të Perugias dhe Drejtorisë Rajonale të Muzeve Kombëtare të Umbrias; si dhe Dr. Alessandro Delpriori, historian arti dhe pedagog në Universitetin e Camerinos, studiues i artit të Rilindjes italiane. Në panel gjithashtu ishin të ftuar personalitete të jetës akademike dhe kulturore shqiptare, ndër të cilët Dr. Majlinda Toçi, Drejtore e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Prof. Asc. Dr. Ermir Hoxha, Prof. Asc. Dr. Mikel Temo, studiuesi Albert Habazaj, artisti bashkëkohor Shuk Orani dhe Msc. Fjoralba Prifti, Drejtore e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar.

Përmes referimeve dhe diskutimeve shkencore, konferenca synoi të evidentojë kontributin e Michele da Valona-s në historinë e artit evropian dhe të promovojë një interpretim bashkëkohor të rolit të tij në formësimin e asaj që historiografia e quan sot Rilindja Adriatike. Njëkohësisht, aktiviteti synon të forcojë bashkëpunimin akademik ndërmjet institucioneve shqiptare dhe italiane në fushën e historisë së artit dhe trashëgimisë kulturore. Përmes kësaj nisme, 355 Hub Foundation dëshmon angazhimin e tij në promovimin e kërkimit shkencor, diplomacisë kulturore dhe valorizimit të figurave historike shqiptare që kanë kontribuar në historinë artistike evropiane. Konferenca përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt njohjes

Mbi organizimin e Konferencës Ndërkombëtare “Michele da Valona - Protagonist i Rilindjes Adriatike mes Shqipërisë dhe Italisë”

Nga Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha

ndërkombëtare të Michele da Valona-s dhe riafirmimit të rolit të Shqipërisë në hapësirën kulturore të Adriatikut gjatë epokës së Rilindjes.

...

Historia e artit shqiptar ruan ende boshllëqe të rëndësishme për veprimtarinë e artistëve shqiptarë jashtë territoreve etnike gjatë Mesjetës së vonë dhe fillimit të epokës moderne. Një nga figurat më domethënëse në këtë drejtim është Michele Greco da Valona, piktor me origjinë nga Vlora, aktiv në Italinë jugore në fillim të shekullit XVI. Ai njihet sot përmes katër veprave të firmosura dhe të datuara në vitin 1505, të ruajtura në Molise dhe Abruzzo.

Nënshkrimi i tij, *Michaelis Greci de Valona*, ka rëndësi të veçantë, sepse nuk shërben vetëm si identifikim personal, por edhe si dëshmi e origjinës së tij gjeografike dhe kulturore. Në një periudhë kur Adriatiku nuk ishte kufi

ndarës, por hapësirë komunikimi, lëvizjeje dhe shkëmbimesh, referimi ndaj Vlorës e vendos Michele Greco-n në një kontekst më të gjerë kulturor, ku Shqipëria, Dalmacia, Venediku dhe Italia jugore ishin të lidhura nga rrjete tregtare, fetare dhe artistike.

Veprat e Michele Greco-s dëshmojnë një gjuhë figurative të ndërmjetme. Ai nuk mund të përkufizohet thjesht si piktor bizantin, por as si artist plotësisht i Rilindjes italiane. Nga tradita postbizantine ai ruan tipologjitë ikonografike, fondet e arta, monumentalitetin e figurave dhe karakterin hieratik të kompozimit. Nga ana tjetër, në veprat e tij dallohen ndikime të kulturës figurative perëndimore, sidomos në organizimin hapësinor, në trajtimin më natyralist të figurave dhe në elementet arkitektonike të sfondit. Në këtë drejtim, formimi i tij duhet parë brenda botëkuptimit figurativ të Carlo Crivelli-t dhe të rrethit adriatik që lidhej me të, ku dekorativizmi,

lineariteti i mprehtë dhe ndjeshmëria ndaj detajit bashkëjetonin me trashëgiminë e ikonës dhe me risitë e Rilindjes italiane. Pikërisht ky karakter hibrid e bën Michele Greco-n një figurë të rëndësishme të asaj që studiuesit e kanë quajtur “Rilindja Adriatike”. Ai përfaqëson një botë artistike ku traditat bizantine, dalmate dhe italiane nuk qëndrojnë të ndara, por ndërthuren në mënyrë krijuese. Siç kanë vënë në dukje Dora Catalano dhe Daniele Ferrara, veprat e tij nuk duhen parë si prodhime të izoluara provinciale, por si pjesë e një kulture figurative adriatike, ku qarkullonin modele, ide, artistë dhe porositës.

Rëndësia e Michele Greco da Valona-s qëndron edhe në faktin se ai është një nga figurat e pakta të periudhës para moderne që mund të lidhet qartë me një origjinë shqiptare dhe me një veprimtari artistike të dokumentuar jashtë Shqipërisë. Për këtë arsye, ai nuk duhet parë vetëm si një piktor shqiptar që punoi në Itali, por si një figurë ndërmjetëse midis dy brigjeve të Adriatikut. Krijimtaria e tij tregon se historia e artit shqiptar nuk mund të kufizohet vetëm brenda kufijve politikë apo gjeografikë të sotëm.

Si përfundim, figura e Michele Greco da Valona-s dëshmon praninë domethënëse të artistëve me origjinë shqiptare në hapësirën kulturore të Adriatikut në kalimin nga shekulli XV në shekullin XVI. Veprat e tij të vitit 1505 tregojnë ekzistencën e një mjedisi ndërkulturor, ku tradita postbizantine, kultura dalmate dhe risitë e Rilindjes italiane u ndërthurën në mënyrë krijuese. Në këtë këndvështrim, thyerjet e mëdha historike të shekullit XV, si rënia e Kostandinopojës dhe më pas pushtimi i pashmangshëm i Shqipërisë nga Perandoria Osmane, mund të kenë nxitur lëvizjen e artistëve drejt hapësirave të reja kulturore dhe artistike. Edhe pse Dr. Dora Catalano mendon se kjo lidhje nuk mund të vërtetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë për rastin e Michele Greco-s, mbetet e arsyeshme të mendohet se këto ndryshime historike krijuan kushte të reja lëvizjeje, kërkimi dhe përshtatjeje. Kështu, artistë si Michele Greco da Valona mund të kenë kërkuar një realitet të ri artistik, duke pasuruar gjuhën e tyre me elemente të reja dhe duke kontribuar njëkohësisht në skenën artistike të vendit të origjinës dhe në atë të mjedisit pritës. Për këtë arsye, ai meriton të vlerësohet si pjesë e historisë së hershme të artit shqiptar jashtë kufijve etnikë, por edhe si pjesë e historisë së artit italian, arbëresh dhe adriatik.



SAVE THE DATE



GIOVEDÌ
25 GIUGNO 2026
ORE 10.00



E ENJTE,
25 QERSHOR 2026
ORA 10:00



TIRANA
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
(Piazza Scanderbeg 9)

CONVEGNO INTERNAZIONALE
KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

MICHELE DA VALONA

Protagonista del Rinascimento adriatico
tra Albania e Italia.
Protagonist i Rilindjes adriatike
mes Shqipërisë dhe Italisë.

I più importanti studiosi di Michele da Valona (Vlorë, XV/XVI secolo) si incontrano a Tirana per una giornata di studi dedicata al dialogo artistico e culturale tra Albania e Italia nel contesto del Rinascimento adriatico.

Studiuesit më të rëndësishëm të Michele da Valona (Vlorë, shek. XV/XVI) do të mbledhen në Tiranë për një ditë studimesh kushtuar dialogut artistik dhe kulturor mes Shqipërisë dhe Italisë në kontekstin e Rilindjes adriatike.

Lidhja e thellë me tokën time të Lorigjinës, Shqipërinë, përbën rrënjën identitare dhe shkëndijën jetësore prej nga zë fill kjo nismë. Përvoja e emigrimit në Itali në moshë të re nuk e ka dobësuar aspak këtë ndjenjë; përkundrazi, ka vepruar si një katalizator, duke e intensifikuar vetëdijen për origjinën time dhe duke u shndërruar në dëshirën e thellë për të rizbuluar dhe nderuar kulturën tonë. Ky rrugëtim lind nga vullneti për t'ua përcjellë brezave të ardhshëm vlerën e saj të brendshme dhe krenarinë historike, në mënyrë që të mos harrojnë kurrë pasurinë e trashëgimisë që i ka formësuar.

Ideja për ta përqendruar këtë rrugëtim ambicioz rreth figurës emblematike të Michele Greco da Valona lindi dhe u strukturua falë shkëmbimit me Luca Meloni-n e Studio CLP në Milano. CLP përfaqëson sot një nga ekselencat më të larta italiane në sektorin e komunikimit të artit, duke qenë realiteti i parë në Itali që kuptoi mundësinë për të përshkruar dhe vlerësuar identitetin e një territori të tërë përmes parabolës artistike të një autori simbol të tij. Pikërisht në këtë shtrat merr formë dhe zhvillohet koncepti i “Rilindjes Adriatike”, që nuk është një lëvizje e kodifikuar, por një vizion që e ripërcakton hapësirën gjeografike si hapësirë kulturore të integruar.

Ky takim, sintezë e përkryer mes pasionit dhe kompetencës tekniko-shkencore, i dha jetë projektit të Michele Greco da Valona. Nuk ndodhemi përballë një ekspozite të thjeshtë apo një kremtimi të izoluar në kohë, por përpara një sistemi të mirëfilltë të strukturuar për të përshkruar kompleksitetin e një territori dhe për të bashkuar pazgjidhshmërisht dy brigjet e të njëjtit det. Në këtë skenar, Michele Greco da Valona shfaqet si dëshmitari më domethënës, që në shekullin XVI, i lidhjes kulturore, artistike dhe historike që mbështjell dy brigjet, duke vepruar si një urë ideale që kapërcen kufijtë kombëtarë për të mbërritur te një identitet kulturor i përbashkët dhe universal.

Ta rikthesh sot, idealisht dhe shkencërisht, figurën e tij në shtëpi do të thotë t'i kthesh kombit shqiptar një shtyllë themelore të kujtesës së tij historike. Është një akt që tregon konkretisht se Italia dhe Shqipëria janë vende historikisht dhe shpirtërisht të afërta, të afta ta shndërrojnë detin që i ndan në një shtrat dialogu dhe bashkëpunimi.

Michele da Valona,
Madonna me fëmijën midis
shenjtorëve, triptik, vaj mbi dru.
Vepra është pikturuar në vitin
1505 për kishën e Santa Maria
Maggiore në Guglionesi.
Tani ndodhet Muzeun Kombëtar
të Abruzzo-s në Aquila, Itali.

Michele Greco da Valona, i rikthehet kombit shqiptar

Nga Marsela Rustemaj

Përmes artit të Michele Greco-s, deti Adriatik resht së qeni një kufi fizik për t'u bërë një element lidhës, një urë qytetërimi që ka parë të lulëzojnë shkëmbime të pandërprera dijesh dhe vizionesh estetike.

Ky vizion gëzon tani qëndrueshmërinë institucionale të nevojshme për t'u përkthyer në veprime konkrete. Përmes 355 Hub Foundation, projekti do të marrë një dimension operacional në territor: parashikohen jo vetëm një ekspozitë e madhe monografike mbi artistin, por edhe seminare të nivelit të lartë shkencor dhe dhënia e bursave të studimit për studiues të rinj. Prandaj Fondacioni vendoset si garant i një rrugëtimi që synon të sanksionojë

një bashkim të frytshëm dhe të qëndrueshëm mes dy vendeve, duke u nisur pikërisht nga një mjeshtër që diti të shkrijë rrënjët e tij bizantine me risitë e Rilindjes italiane, duke krijuar një gjuhë unike dhe jashtë kohës.

Organizimi i kësaj konference buron nga vullneti për të formuar një skuadër ekselence, të denjë për prestigjin e Michele-s së Valona-s. Integrimi mes kompetencave akademike italiane dhe njohjes së thellë të studiuesve shqiptarë shënon nisjen e një pune kërkimore rigoroze. I çmuar ka qenë patronazhi i Institutit Italian të Kulturës në figurën e Drejtorit të tij, Dr. Alessandro Ruggera, i cili i

mundësoi delegacionit italian të kishte një partner autoritativ në Shqipëri. Një falënderim i veçantë duhet t'i kushtohet Prof. Ferid Hudhrit, mbështetja e të cilit ka qenë përcaktuese në ndërtimin e kësaj tryeze teknike dhe, mbi të gjitha, në nxitjen e takimit me Majlinda Toçin, drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare. Mikpritja dhe largpamësia e drejtoreshës, së bashku me dëshirën e saj për t'i hapur institucionet ndaj komunitetit shkencor ndërkombëtar, kanë qenë shtylla themelore për suksesin e këtij seminari.

Perspektivat që hapen janë të gjera dhe artikulohen në tri drejtime themelore.

Së pari, objektivi ynë është hartimi i një plani sistematik studimesh që të mos kufizohet vetëm te katalogimi i thjeshtë, por të çojë në botimin e një vëllimi monografik me rigorozitet të lartë shkencor, të aftë të bëhet pikë referimi e domosdoshme për njohjen e veprës së Michele Greco-s.

Së dyti, do të donim të promovonim një projekt ambicioz restaurimi konservues, të kuptuar jo vetëm si ndërhyrje teknike mbi ikonat e çmuara të ruajtura pranë Muzeut Kombëtar të Tiranës dhe Muzeut të Artit Mesjetar të Korçës, por si një laborator autentik shkëmbimi kompetencash mes restauratorëve italianë dhe shqiptarë.

Së fundi, nënshkrimi i dokumentit programatik të përbashkët do të shënojë hapin vendimtar drejt institucionalizimit të këtij bashkëpunimi. Kemi përcaktuar një kurs të përbashkët që do të mundësojë rikthimin në shtëpi të trashëgimisë së artistit, duke e bërë atë të qasshme dhe të gjallë.

Kjo përpjekje kolektive synon, në fund të fundit, të shkojë përtej dhe të kapërcejë fushën thjesht akademike, duke konsoliduar një lidhje të pazgjidhshme mes Italisë dhe Shqipërisë; arti i Michele Greco-s rikonfirmohet kështu jo vetëm si objekt hulumtimi, por si një gjuhë universale dhe dinamike paqeje, vëllazërie dhe përparimi kulturor.



Poezia **“Mesnatë në bregdet”** e Ervin Hatibit është një krijim lirik me një ndjeshmëri të hollë, ku peizazhi detar dhe përjetimi intim shkrihen në një tablo unike estetike. Përmes një gjuhe të thjeshtë, por jashtëzakonisht figurative, Hatibi ndërton një urë mes reales dhe imagjinare, mes natyrës së qetësuar dhe botës së brendshme të subjektit lirik.

Poezia hapet me një imazh të fortë vizual dhe thuajse agresiv:

“Neonët e qytetit / vjellin dritë...”

Folja **vjellin** krijon një kontrast të menjëhershëm me qetësinë e detit. Kjo është një estetikë e modernes, ndonjëherë e ngjashme me ekspresionizmin, ku drita artificiale e qytetit shihet si një ndërhyrje e dhunshme mbi natyrën. Megjithatë, ky tension shuhet shpejt nga pafundësia dhe qetësia e detit që “përlan” këtë dritë.

Hatibi shquhet për aftësinë e tij për t'i dhënë natyrës tipare njerëzore, duke e kthyer mjedisin rrethues në një bashkëpunëtor të gjendjes shpirtërore të subjektit mendues. Gjethet përshkruhen si *“veshë të nderur në përgjim”*, duke krijuar një ndjesi pezullimi dhe pritjeje mistike. Deti merr rol njerëzor, thuajse prindëror: *“ka vënë gishtin mbi buzë”* dhe lëshon onomatopenë *“Shët! Shët! Shët!”*. Ky det nuk është i frikshëm apo i stuhishëm, ai është mbrojtës i intimitetit njerëzor.

Një nga pikat më kulmante të estetikës së kësaj poezie është krahasimi i lëvizjes së dallgëve me puthjen e nënës:

“...aq lehtë, si puthjet e nënës / mbi ballin e dërsur të fëmijës së përgjumur.”

Kjo metaforë sjell një ngrohtësi universale dhe një ndjesi sigurie të jashtëzakonshme. Ajo zhvendos fokusin nga thjesht një peizazh romantik, në një dimension pastërtie dhe pafajësie absolute.

Në pjesën e dytë të poezisë, vëmendja zhvendoset te “Unë dhe ti”. Pagjumësia e tyre nuk është vuajtje, por *“pagjumësi e lumtur”*. Cigaret këtu humbasin konotacionin e tyre të zakonshëm (ves apo ankth) dhe kthehen në “fenerë të udhëve detare”. Ato janë dritëzash shprese që udhëheqin ditët e lumtura që po vijnë. Në finalen e poezisë, ndodh një zgjerim mahnitës i perspektivës. Majat e ndezura të cigareve të dy të dashuruarve pasqyrohen në qiell. Yjet nuk janë më thjesht trupa qiellorë, por kthehen në *“cigare të ndezura nga miliona të lumtur si ne”*. Autori e lidh përjetimin intim me një lumtur universale, kozmike.

Nga pikëpamja stilistike, futja e pasthirmës pyetëse “Ë?” thyen solemnitetin e poezisë klasike dhe sjell një natyrshmëri të gjuhës së folur. Kjo krijon përshtypjen e një pëshpëritjeje reale mes dy njerëzve në mesnatë. Nuk është një ligjëratë pompoze, por një bisedë e zhveshur nga artificialiteti, ku habia para bukurisë së botës ndahet me tjetrin me thjeshtësinë më të madhe.

Hatibi nuk e mbyll poezinë me një pikë, por me një pyetje të hapur, me atë “Ë?”-në që pezullon gjithçka. Bukuria e vërtetë këtu është se ai arrin ta kthejë një zakon kaq të rëndomtë e tokësor si ndezja e cigares në errësirë, në një zbulim befasues se diku atje tej, nën të njëjtin qiell, ka edhe miliona të tjerë që nuk i zë gjumi. Yjet bëhen si ato dritat e vogla që shkëmbejnë njerëzit në autostradë natën, një shenjë që të thotë: *“Të shoh, edhe unë jam zgjuar.”*

Është një lloj «klubi i natës» i të pagjumëve të lumtur, ku anëtarësimi kushton sa një fije shkrepëse. Në atë

Meditim mbi një tekst poetik të Ervin Hatibit

Nga Yzedin Hima



MESNATË NË BREGDET

poezi nga Ervin Hatibi

Neonët e qytetit
vjellin dritë
mbi sipërfaqen e qetë
të detit.
Era edhe flladin diku e harroi...
Gjethet kanë ngrirë,
si veshë të nderur në përgjim.
Asnjë zhurmë...
Deti ka vënë gishtin mbi buzë
dhe pëshpërit me gjuhë dallgëzash:
Shët! Shët! Shët!
Dallgëzat rrëshqasin mbi heshtjen e bregut,
aq lehtë, si puthjet e nënës
mbi ballin e dërsur të fëmijës së përgjumur.
Unë dhe ti
pagjumësinë tonë të lumtur
thithim në dy cigare.
Dy cigaret tona në këtë mesnatë,
si fenerë të udhëve detare,
rrugën e rrëfejnë ditëve të lumtura,
që shtegtimin kanë nisur drejt nesh.
Jemi këtu! Jemi këtu!
Mbi kokat tona yje.
O sa yje!
Ë?
Më parë sikur s'ka patur kaq shumë yje?
Ë?
A nuk të duket se kanë ndezur cigaret
miliona të lumtur si ne,
miliona,
si ne,
të pagjumë?

mesnatë, ata të dy nuk janë më vetëm; bota e tyre intime zgjerohet sa i gjithë universi. Ato miliona yje, që gjasme kanë ndezur cigaret, janë miliona njerëz të tjerë që, ashtu si ata, janë zgjuar nga lumturia, jo nga brenga. Është një estetikë e naivitetit të bukur, ku bota nuk të shtyp, por bëhet bashkëlumturuese me ty.

Hatibi bën një magji. Ai merr dy gjëra krejt të vogla e të rëndomta, dy pranishmëri cigaresh në errësirë dhe me to ndez gjithë qiellin dhe pastaj ndez edhe shpirtrat e lexuesve.

Ajo “Ë?”-ja që përsëritet është si një bërryl i lehtë që i jepet tjetrit krahë nesh: “A po e sheh edhe ti këtë që po shoh unë?”

Në atë moment, vetmia e dy njerëzve në bregdet zhduket. Ata nuk janë më vetëm; bëhen pjesë e një klubi gjigant, sekret dhe kozmik të njerëzve të lumtur e të pagjumë. Hatibi thjesht na thotë se lumturia nuk është një koncept i madh e i paarritshëm, por një gjendje kaq e thjeshtë sa të ndarit e një nate të qetë me dikë, ku edhe yjet duken sikur po pinë duhan me ju.

Nëse do të kërkonim të afërmit shpirtërorë dhe stilistikë të Ervin Hatibit në poezinë botërore, duhet të shohim drejt atyre poetëve që guxuan të zhveshin poezinë nga zhgualli i klasikes, duke futur brenda saj rrugën, bisedën e përditshme, kafenetë dhe objektet krejt të rëndomta, por duke i veshur ato me një petk magjik ose melankolik.

Poetët e “Beat Generation” të viteve ‘50-’60 kishin si parim: *“Shkruaj ashtu siç mendon dhe siç flet.”* Ky stil quhej ndonjëherë “I do this, I do that” (Unë bëj këtë, unë bëj atë), poezi që regjistron çastin ekzakt: *“Unë dhe ti / thithim në dy cigare”*. Cigaret si fenerë urbanë dhe ndjesia e të qenit jashtë rregullave të ditës, pagjumësia e lumtur, ku ka shumë nga fryma rebele, por sterile dhe e pastër, janë pikërisht të ngjashëm me lirikën “beat”.

Nëse do ta krahasojmë këtë tekst të Ervin Hatibit me tekst të një poeti tjetër të shquar bashkëkohor si Mark Strand, do shohim një formë nyjetimi të tekstit me mjaft pika takimi. Strand është mjeshtër i asaj që ndodh, kur nuk ndodh asgjë. Poezitë e tij shpesh nisin në dhoma të zbrazëta, në fusha nën dritën e hënës, ose në brigje ku njeriu thjesht është.

Edhe te Hatibi, fillimi i poezisë është një ushtrim në heshtje: *“Era edhe flladin diku e harroi... Asnjë zhurmë...”*. Ai pezullim i botës, ku natyra mban frymën takohet shpesh te tekstet e Strand. Te Mark Strand, kufiri mes asaj që është reale dhe asaj që është brenda kokës tënde është shumë i hollë. Ti po sheh një peizazh dhe papritur ai bëhet diçka tjetër. Hatibi bën saktësisht të njëjtën gjë: nisin me dy cigare në buzë të detit dhe përfundojnë duke parë miliona njerëz që kanë ndezur cigaret në qiell. Është një surealizëm që nuk të tremb, por të fton brenda me një butësi të madhe.

Asnjëri prej tyre nuk përdor fjalë të mëdha apo ornamente të rënda. Gjuha është pothuajse e tejdukshme, si ujë. Por

rreshtimi i fjalëve është aq i saktë, sa që një imazh i thjeshtë si ai i dallgëve që rrëshqasin *si puthje nëne mbi ballë* – të mbetet në mendje si një fotografi me dritë të ngrohtë.

Dallimi i vetëm, ndoshta, është se Strand shpesh ka një lloj melankolie më ekzistenciale, ndonjëherë pak më të ftohtë, ndërsa Hatibi këtu e mbush natën me një shpresë shumë djaloshare dhe një lumturi që pothuajse të prek fizikisht.

Të dy poetët, me të njëjtën mënyrë e kthejnë shikimin nga qielli dhe e bëjnë kozmosin të duket si një dhomë e shtëpisë së tyre. Mark Strand: ... *bota e pafund u nder mbi mua /dhe u habita /çfarë do të isha / dhe ku do ta kërkoja veten/ dhe ndonëse e humba veten,/ u ndjeva për një çast/ se qielli plot me yje ishte imi,/ teksa dëgjova emrin tim / si të parën herë, siç dëgjohet era dhe shiu,/ i mekur nga larg/ sikur nuk më thirrën mua, po i thirrën heshtjes nga kishte ardhur/ dhe ku do të shkonte...*(Fragment nga poezia “Emri im”).

Poezia “Mesnatë në bregdet” e Ervin Hatibit është një shembull i qartë i asaj që e bën zërin e tij poetik kaq origjinal dhe të veçantë në letërsinë bashkëkohore shqipe. Te kjo poezi jo vetëm që përzihen artet si piktura dhe muzika, por ky gërshetim është shtylla kurrizore e origjinalitetit të tij. Hatibi nuk shkruan, thjesht, një poezi; ai ndërton një instalacion pamor dhe akustik.

Hatibi e nis poezinë si një piktor modern, duke përdorur penelata të forta e pothuajse ekspresioniste, me kontrastin e ngjyrave dhe dritës: “*Neonët e qytetit / vjellin dritë mbi sipërfaqen e qetë të detit.*” Ky nuk është një peizazh romantik klasik. Përdorimi i fjalës “vjellin” krijon një imazh vizual të fortë, si hedhja e të bardhës me një penelatë disi brutale. Më pas, ai kalon te një pikturë më intime, dy drita të vogla cigaresh në errësirë që krahasohen me “*fenerë të udhëve detare*”. Në fund, tabloja zgjerohet në përmasa kozmike me miliona pika drite: “*miliona të lumtur që kanë ndezur cigaret*”, duke krijuar një imazh vizual magjik, ku qielli i yllësuar dhe bota njerëzore shkrihen në një telajo të vetme.

Poezia është e ndërtuar mbi një partiturë muzikore të kuruar me kujdes, ku elementi kryesor është dinamika e zërit dhe heshtjes: Onomatopeja “*Shët! Shët! Shët!*”, nuk është thjesht lexim, është tingull. Hatibi e bën detin të flasë me një pëshpërimë që lexuesi mund ta dëgjojë fizikisht. Poezia fillon me një qetësi të ngrirë: “*Gjethet kanë ngrirë, si veshë të nderur...*”, kalon në pëshpërimën e lehtë të dallgëve në një ritëm të ngadaltë si ninullë: “*si puthjet e nënës...*”, dhe kulmon me një ritëm bisedor në fund: “*Ë? / Më parë sikur s’ka patur kaq shumë yje? / Ë?*”. Ky përdorim i pyetjeve retorike dhe thirrjeve, “*Jemi këtu!*”, thyen monotoninë dhe krijon një ritëm si në muzikën xhaz.

Por magjia e vërtetë estetike e Hatibit ndodh te thyerja e distancës. Ai merr dy elemente krejtësisht tokësore, urbane dhe kalimtare – dy cigare të ndezura në errësirë – dhe përmes tyre ndryshon perspektivën e krejt universit. Në fund të poezisë, qielli i yllësuar nuk është më ai hapësira e ftohtë, e largët dhe e paarritshme e poetëve romantikë. Qielli kthehet në një pasqyrë njerëzore. Çdo yll bëhet maja e ndezur e një cigareje; çdo pikë drite në kozmos bëhet dëshmi e një pagjumësie tjetër të lumtur.

Origjinaliteti i tij qëndron pikërisht te ky guxim estetik: aftësia për ta zbritur madhështinë e qiellit në nivelin e një bisede intime në bregdet, duke e kthyer një çast të thjeshtë njerëzor në një instalacion arti ku drita, tingulli dhe fjala bëhen një gjë e vetme.

“Grue prej zjermi” e Donika Dabishevcit

Arkitektura poetike e qenies

Nga Mërgim Bekteshi

Përvoja e leximit dëshmon se disa libra poetikë mbeten në kujtesë për poezi të veçanta, ndërsa të tjerë për universin poetik që ndërtojnë. Në këta të fundit, secila poezi e zgjeron kuptimin e tjetrës përmes një rrjeti motivesh, simbolesh dhe përjetimesh, duke formuar një tërësi organike ku asnjë tekst nuk e shteron domethënien në vetvete. Pikërisht kësaj kategorie i përket “Grue prej zjermi”, libri poetik i rradhës i Donika Dabishevcit botuar nga Shtëpia botuese ‘Littera’ 2026.

Pas poetizimit të erotikës te “Kam me ardhë si deka” dhe dialogimit me kujtesën historike te “E gjithkohshmja Andërr”, poetja e zhvendos qendrën e vështirimit drejt hapësirës më të ndërlikuar të ekzistencës: te brendësia e qenies. Nuk është më historia ajo që e përcakton njeriun dhe as vdekja që e vë në provë ekzistencën e tij. Në qendër vendoset njeriu, me gjithë brishtësinë, kujtesën, trupin, dashurinë, mungesën dhe etjen për liri.

Po ta shohësh nga kjo perspektivë, tri librat e saj të fundit ndërtojnë një trekëndësh poetik: vdekja, kujtesa dhe identiteti. Secili e plotëson tjetrin dhe secili zgjeron horizontin e atij pararendës.

Por të kthehemi te libri i ri. Një nga cilësitë e para që bie në sy është mënyra se si autorja e ka ndërtuar librin si një organizëm artistik. Pesë ciklet: “T’pathanat”, “T’dhanat”, “T’mbajtunat”, “T’fjetunat” dhe “T’heshtunat”, përfaqësojnë lëvizje të brendshme, apo procese të vetëdijes poetike që kalojnë nga ajo që nuk mund të thuhet, drejt asaj që rrëfëhet, ruhet, ëndërrohet dhe në fund, heshtet. Libri fiton kështu një arkitekturë të menduar, ku secili cikël përgatit tjetrin dhe ku lexuesi nuk ndjek vetëm një varg poezish, por një udhëtim shpirtëror.

Në një lexim të shpejtë mund të krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me një libër dashurie, por një lexim më i kujdesshëm dëshmohej diçka tjetër. Dashuria nuk është tema përfundimtare e këtij libri; ajo është vetëm një nga format përmes së cilës poetja kërkon ta kuptojë qenien njerëzore. Pikërisht për këtë arsye, vargjet e saj nuk rrëshqasin në sentimentalizëm dhe as në retorikën e zakonshme të poezisë intime. Ato mbeten të përmbajtura, të kursyera dhe shpeshherë lënë më shumë të nënkuptohet sesa thuhet.

Vetë cikli i parë, “T’pathanat”, është një hyrje domethënëse në universin poetik të librit. Titulli nuk është vetëm emërtim; ai është çelësi i parë interpretues. E pathëna nuk nënkupton mungesën e fjalës, por kufirin e saj. Donika duket se i beson më shumë asaj që mbetet pezull sesa asaj që shprehet drejtpërdrejt.

Për këtë arsye, shumë poezi të këtij cikli nuk japin përgjigje, por hapin pyetje. Ato nuk mbyllen me fundin e vargut, por vazhdojnë të jetojnë në vetëdijen e lexuesit. Në një kohë kur shpesh poezia bashkëkohore rëndohet nga metafora të shumta dhe nga figura që e humbin natyrshmërinë e tyre, Donika zgjedh rrugën e kundërt. Ajo i beson fjalës së kursyer. Vargu i saj nuk kërkon ta impresionojë lexuesin me ndërlikim, por ta bindë atë, me saktësi dhe pikërisht kjo e bën poezinë e saj të fitojë peshë. Çdo fjalë duket e menduar dhe e vendosur aty ku duhet, pa zbukurime të panevojshme.

Në anën tjetër, në këtë vëllim poetja dëshmon edhe një ndjeshmëri të veçantë ndaj kohës në të cilën jetojmë, pasi që nuk e trajton bashkëkohësinë si dekor, por si pjesë të pandashme të përvojës njerëzore. Këtë e dëshmon edhe poezia “*Ne ishim ndryshe, syni jem*”, ku përmes figurave të botës digjitale poetja reflekton mbi transformimin e marrëdhënieve njerëzore. Dashuria, që dikur ndërtohej mbi praninë, kohën dhe pritjen, sot shfaqet si një përvojë që mund të nisë me një *add* e të përfundojë me një *unfollow*. Kjo nuk artikullohet si gjykim moral, por si vëzhgim poetik i një realiteti të ri kulturor, ku afërsia virtuale shpesh shoqërohet me largësi shpirtërore.

Në të njëjtën frymë, vargu *fëmijët mësojnë me rrëshqitë gishtin para se me mësue me prekë* sintetizon një prej



paradokseve themelore të kohës sonë: zëvendësimin e përvojës së drejtpërdrejtë me ndërmjetësimin teknologjik. Kështu, poezia e Dabishevcit e tejkalon regjistrin intim dhe shndërrohet në një reflektim mbi njeriun bashkëkohor, duke dëshmuar një vetëdije poetike që dialogon njëkohësisht me ndjenjën dhe me kohën.

Një nga boshtet më të rëndësishme të këtij libri është figura e “synit”, e cila shfaqet vazhdimisht dhe krijon një ndjenjë vazhdimësie mes poezive. Në leximin tim, “syni” nuk duhet kuptuar vetëm si figura e të dashurit. Ai është shumë më tepër se kaq. Herë është bashkëbisedues, herë dëshmitar, herë kujtesë, herë vetë ndërgjegjja e poetes. Në disa raste të krijohet përshtypja se poetja dialogon me një prani të padukshme, ndërsa në raste të tjera duket sikur po flet me vetveten. Pikërisht kjo shumëkuptimësi ia shton forcën artistike figurës dhe e bën atë një nga elementet unifikuese të gjithë vëllimit.

Tutje gjejmë vargjet “*Ne nuk fituem, syni jem. Ne u harruem*” ku harresa nuk lidhet me shuarjen e dashurisë mes dy njerëzve, por me ndjesinë e dy qenieve që i përkasin një sistemi tjetër vlerash dhe që, brenda ritmit të vrullshëm të epokës digjitale, mbesin në skaj të kohës. Ata nuk humbin njëri-tjetrin; humbin vendin e tyre në një botë që ndërkohë ka ndryshuar mënyrën e të jetuarit, të të dashuruarit dhe të të komunikuarit.

Në këtë kuptim, poezia fiton një përmasë brezore e kulturore. “Ne u harruem” shndërrohet në metaforë të një gjenerate që e ndien veten të zhvendosur përballë një realiteti të ri, ku shpejtësia, virtualiteti dhe konsumimi i çastit e kanë zëvendësuar ngadalësinë, praninë dhe thellësinë e përvojës njerëzore.

Një poezi tjetër që fiton peshë të veçantë është “Trup që flet”. Që nga titulli kuptohet se poetja synon ta zhvendosë komunikimin nga fjala te vetë qenia fizike. Trupi nuk është më vetëm prani biologjike; ai bëhet bartës i kujtesës, i plagëve, i mungesave dhe i dashurisë. Në poezinë e Donika Dabishevcit trupi nuk shërben për ta zbukuruar ligjërimin me nota erotike, siç ndodh shpesh në poezinë bashkëkohore, por shndërrohet në një hapësirë ku depozitohen përvojat më të thella të njeriut. Ai flet edhe atëherë kur gjuha hesht. Ai kujton edhe atëherë kur mendja përpiket të harrojë.

Kjo është arsyeja pse në këtë libër marrëdhënia ndërmjet trupit dhe shpirtit nuk paraqitet si kundërvënie, por si bashkëjetesë. Të dy ecin paralelisht dhe e plotësojnë njëri-tjetrin. Ajo që përjetohet shpirtërisht lë gjurmë në trup, ndërsa ajo që prek trupin vazhdon të jetojë në kujtesë. Pikërisht në këtë ndërthurje qëndron edhe një nga veçoritë estetike të këtij vëllimi.

Këtij motivi i bashkohen natyrshëm poezitë “T’duem”, “N’ty”, “T’jam dorëzue, syn!” dhe “Yjet nën lëkurë”. Ato nuk flasin për dashurinë si gjendje kalimtare, por si një përvojë që e ndryshon qenien e njeriut. Dashuria nuk paraqitet si triumf romantik dhe as si strehë e sigurt. Përkundrazi, ajo është një proces që e

(Vijon në faqen 6)

(Vijon nga faqja 5)

bën njeriun më të ndjeshëm ndaj vetes dhe ndaj botës. Pikërisht për këtë arsye poetja nuk ndërton deklarata të mëdha dashurie; ajo ndërton gjendje dhe lexuesi nuk ndeshet me retorikën e ndjenjës, por me përvojën e saj.

Një poezi si “A m’do?” mund të duket në pamje të parë si një pyetje e zakonshme intime. Mirëpo, gjatë leximit bëhet e qartë se ajo nuk kërkon përgjigje. Është një pyetje që i drejtohet po aq vetes sa edhe tjetrit. Në këtë libër dashuria nuk paraqitet kurrë si diçka e sigurt. Ajo mbetet gjithmonë në provë, gjithmonë e kërcënuar nga koha, nga largësia, nga ndryshimi dhe mbi të gjitha nga harresa. Kjo pasiguri e vazhdueshme e shpëton poezinë e Donikës nga sentimentalizmi. Ajo nuk ndërton iluzione; ndërton dilema. Nuk shpall të vërteta; shtron pyetje.

Një tjetër vlerë e këtij libri është mënyra se si autorja e koncepton kohën. Në shumë poezi koha nuk matet me vite apo me data, por me ndryshimet që lë brenda njeriut. Për këtë arsye cikli “T’fjetunat” zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e librit. Poezitë “E tashmja”, “Ditët”, “Netët”, “Çastet”, “Andrrat”, “Fjalët” dhe “Momenti” nuk përshkruajnë ngjarje të jashtme. Ato ndalen te çaste që në jetën e zakonshme mund të kalojnë pa u vënë re, por që në poezi fitojnë peshë ekzistenciale. Në këto poezi ndihet qartë pjekuria artistike e autores. Ajo nuk ka më nevojë për ngjarje dramatike që ta ndërtojë poezinë. Mjafton një fjalë, një shikim, një natë, një kujtim ose një heshtje për të krijuar një univers të tërë poetik. Kjo është shenjë e një autoreje që tashmë i beson plotësisht fuqisë së vargut të saj.

Një nga poezitë që më duket ndër më përfaqësueset e këtij cikli është “Fjalët”. Donika Dabishevc i njuh mirë kufirin e gjuhës. Ajo e di se fjala është mjeti i poetit, por njëkohësisht është edhe kufiri i tij. Për këtë arsye në shumë poezi krijohet përshtypja se heshtja flet më shumë sesa vetë ligjërimi. Nuk është rastësi që libri përfundon me ciklin “T’heshtunat”. Pas gjithë rrugëtimit poetik, autorja arrin në përfundimin se jo çdo përvojë mund të shprehet plotësisht.

Disa gjëra mbeten përgjithmonë në kufirin ndërmjet fjalës dhe heshtjes. Pikërisht aty lind poezia më e mirë. Ky raport ndërmjet fjalës dhe heshtjes është një nga shtyllat mbi të cilat ndërtohet “Grue prej zjermi”. Heshtja nuk është mungesë e komunikimit; ajo është vazhdimi i tij. Shpesh lexuesi ka ndjesinë se poezitë nuk mbarojnë në fund të faqes, por vazhdojnë të rezonojnë edhe pasi libri mbyllet. Kjo është një nga shenjat më të sigurta të një poezie që nuk jeton vetëm gjatë leximit, por mbetet gjatë në vetëdijen e lexuesit.

Nëse do të duhej të veçoja një poezi që e përmbledh frymën e të gjithë këtij vëllimi, pa dyshim do të ishte “Grue prej zjermi”, poezia që i jep edhe titullin librit. Në traditën poetike shqiptare figura e gruas është ndërtuar shpesh si simbol i sakrificës, i dhembjes, i amësisë ose i pritjes. Donika Dabishevc nuk e mohan këtë traditë, por nuk mbetet brenda saj. Gruaja e saj nuk është vetëm ajo që pret, as vetëm ajo që duron. Ajo është qenie që digjet për të mos u shuar. Pikërisht këtu

zjarri e humb kuptimin e zakonshëm të shkatërrimit dhe fiton një dimension krejt tjetër. Ai bëhet metaforë e energjisë së brendshme, e pasionit, e qëndresës

dhe e aftësisë për t’u ringritur.

Në këtë kuptim, “Grue prej zjermi” nuk është poezi që flet vetëm për gruan. Ajo flet për njeriun që kalon nëpër sprova



Shtëpia Botuese Littera sjell për lexuesit librin e ri me poezi të poetes dhe studiueses Donika Dabishevc “Grue prej zjermi”.

“Grue prej zjermi” e vendos dashninë në qendër të ligjërimin poetik, duke e konceptuar si përvojën më të thellë të qenies njerëzore dhe si hapësirën ku njeriu përballet me veten, me tjetrin dhe me kuptimin e ekzistencës.

Në këtë univers poetik, gruaja shfaqet si bartëse e lirisë, kujtesës, rebelimit dhe qëndresës shpirtërore, ndërsa poezia shndërrohet në një meditim mbi identitetin, kohën dhe etjen njerëzore për afri e kuptim.

Libri bart edhe frymën e një brezi të rritur mes luftërash, idealesh, tranzicionesh, shembjesh e zhgënjimesh. Një brezi që e ka përjetu historinë mbi lëkurën e vet dhe që vazhdon me kërkim kuptim, liri e dinjitet njerëzor.

Nga autorja:

“Pas “E gjithkohshmja Andërr”, që futet thellë n’mizorinë dhe tmerret e luftës, jam rikthi n’truallin tem t’natyrshëm poetik.

Te Donika që i këndon dashnisë. Te Donika që i këndon gruas. Te Donika që i këndon lirisë.

Sepse gjithmonë kam besu se dashnia asht ajo që e çon njeriun drejt thelbit t’qenies, aty ku trupi, mendimi e shpirti flasin t’najtën gjuhë. Aty ku bien maskat, shdavariten iluzionet dhe shpirti mbetet lakuriq përballë vetes, tjetrit e jetës. Aty ku e ndjejmë kohën ma thellë, përkohësinë ma randë e etjen tonë ma t’vjetër: me u pa, me u kuptu, e me u bashku me tjetrin me tan’ fuqinë.

“Grue prej zjermi” asht libër për gruen që dashunon me trup, me mendje e me shpirt. Për gruen që mban brenda vetes mall, epsh, butësi, mlllef, dhembshuni e rebelim.

Për gruen që nuk lejon me iu vu zingjirë e pranga mendore. Për atë që s’asht tkurrë e zvogëlu për askend. Që s’ka hy n’skema, n’kallëpe t’dëshirume e as s’ka pranue shpërblime që kurthojnë n’përlujë, n’nënshtim e n’heshtje. Për gruen që edhe kur digjet prej jetës vazhdon me shndrit. Me shndrit fort.

“Grue prej zjermi” asht libër për njerëzit që nuk pranojnë me u mpi shpirtnisht. Për ata që ende kërkojnë kuptim, thellësi e vërtetësi në një kohë ku gjithçka rrëshqet shpejt, konsumohet shpejt e harrohet edhe ma shpejt.

Për ata që ende besojnë se njeriu ka nevojë për dashni, për mendim e për poezi! “, thotë poetja Donika Dabishevc.

Mbi autoren:

DONIKA DABISHEVCI është poete, studiuese dhe botuese. Ka studiuar letërsinë shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku ka përfunduar edhe masterin për të vazhduar në Universitetin e Tiranës, ku në vitin 2013 doktoroi po në letërsi.

Ka botuar: “Krizantema të plasura”, proza poetike, Prishtinë, 1996, “Imazhe të brishta”, poezi, Faik Konica, Prishtinë, 2004, “Proza e poetizuar - F.Konica, M. Frashëri, E. Koliqi, M. Camaj, M. Hanxhari”, studim monografik, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015, “Kam me ardhë si deka”, poezi, OM, Prishtinë, 2015, “Dashnisë së një nate”, poezi, Bard Books, Prishtinë, 2020, “E gjithkohshmja Andërr”, poezi, Littera, Prishtinë, 2024, fituese e Çmimit si libri më i mirë me poezi, për vitin 2024 nga Ministria e Kulturës së Kosovës, dhe po ashtu si libri më i mirë me poezi gjatë Panairit të Librit në Prishtinë, 2024, “La tua robinja” Essemble, Romë, 2017, “Ke stasam kako smrtta”, Rezna, Shkup, 2023, “Mi venos kvazaū la morto”, Kava Pech, Çeki, 2023, “Tuttempa revō”, DEC, Kroaci, 2025.

Përvoja e saj profesionale shtrihet mes fushës së medias dhe asaj akademike.

Ka themeluar dhe menaxhon Portalin për Kulturë, Art dhe Letërsi ObserverKult, Shtëpinë Botuese Littera dhe Festivalin Poetik të Prishtinës.

Poezitë e saja tashmë janë përkthyer në 12 gjuhë. Ato flasin në gjuhën angleze, gjermane, frënge, italiane, suedeze, bullgare, rumune, turke, serbe, maqedonase, malazeze dhe esperanto.

Nga Observer Kult

dhe arrin të mos e humbasë vetveten. Zjarri nuk e djeg identitetin; e pastron atë. Ai nuk e shkatërron qenien; e kalit. Kjo është arsyeja pse titulli i librit nuk duhet parë si një metaforë dekorative, por si boshti simbolik mbi të cilin ndërtohet i gjithë vëllimi.

Po aq domethënëse është edhe poezia “E lirë”, e cila, sipas meje, nuk është vetëm mbyllja e ciklit të fundit, por edhe mbyllja filozofike e gjithë rrugëtimit poetik. Liria që shfaqet këtu nuk është një fitore spektakolare dhe as një çlirim i jashtëm. Ajo është një gjendje e fituar pas shumë përballjesh me vetveten. Pas dashurisë, mungesës, kujtesës, pritjes dhe heshtjes, poetja arrin në një pikë ku liria nuk varet më nga prania ose mungesa e tjetrit. Ajo lind nga pajtimi me veten. Pikërisht ky është një nga përfundimet më të bukura artistike të këtij libri.

Në planin gjuhësor, Donika Dabishevc vazhdon t’i qëndrojnë besnike gegërishtes. Mirëpo, do të ishte gabim ta shihnim këtë zgjedhje vetëm si çështje dialektore. Gëgnishtja në poezinë e saj nuk është as nostalgji dhe as ornament. Ajo është vetë mënyra e të menduarit poetik. Ritmi i vargut, muzikaliteti i ligjërimin dhe ngarkesa emocionale burojnë natyrshëm prej saj. Për këtë arsye lexuesi nuk ka ndjesinë se autorja po kërkon efekte gjuhësore; gjuha rrjedh si pjesë organike e përvojës poetike.

Kjo vërehet sidomos në përdorimin e fjalëve të shkurtra, të ndërprerjeve të befta dhe të ritmit të kursyer. Poezitë nuk mbështeten mbi fjali të gjata dhe as mbi shpjegime të tepërta. Donika Dabishevc i beson fuqisë së fjalës së vetme. Ka raste kur një fjalë, e vendosur në vendin e duhur, mban peshën që në një tekst tjetër do ta mbante një paragraf i tërë. Kjo ekonomi e ligjërimin është një nga cilësitë më të dukshme të pjekurisë së saj poetike.

Një tjetër aspekt që meriton vëmendje është mënyra se si ndërtohet arkitektura e librit. Sot nuk janë të pakta vëllimet poetike që ngjajnë më tepër me përmbledhje tekstesh të shkruara në kohë të ndryshme, pa një lidhje të brendshme mes tyre. “Grue prej zjermi” nuk i përket kësaj natyre. Që nga faqja e parë deri te e fundit ndihet se poezitë komunikojnë me njëra-tjetrën. Motivet e syrit, trupit, natës, ëndrrës, zjarrit, fjalës dhe heshtjes rikthehen vazhdimisht, por jo si përsëritje. Çdo rikthim u shton atyre një kuptim të ri. Kështu krijohet një rrjet simbolesh që e mban librin të bashkuar dhe i jep atij identitet të qartë estetik.

Në këtë pikë bëhet e natyrshme të shihet edhe vendi që zë ky vëllim në krijimtarinë poetike të Donika Dabishevcit. Tri librat e saj të fundit nuk lexohen si vepra të shkëputura, por si tri nyje të një procesi të vetëm krijues. Në “Kam me ardhë si deka”, qendra e universit poetik është dashuria, e jetuar si pasion, zjarr, trup dhe përmbysje e çdo norme. Në “E gjithkohshmja Andërr”, poezia zhvendoset drejt traumës kolektive, duke e shndërruar luftën në përvojë ontologjike të njeriut. Ndërsa “Grue prej zjermi” i rikthehet dashurisë, por tashmë nga një lartësi tjetër artistike e ekzistenciale: ajo nuk është më vetëm marrëdhënie mes dy qenieve, por hapësirë ku sprovohen identiteti, liria, trupi, kujtesa dhe vetë kuptimi i qenies.

Korrik, 2026

Dashuria, në çdo epokë do të gjejë gjithmonë rrugën e saj për të mbijetuar, edhe pas vdekjes

Ka kufij gjeografikë dhe ka kufij shpirtërorë. Ndonjëherë, kalimi i njërit do të thotë të gjurmosh tjetrin. Është maji i vitit 1990. Shqipëria është gati të zgjohet, e tronditur nga tronditjet e një revolucioni të afërt shoqëror që do të fshijë dekada diktature. Por në bulevardin Stalin të Tiranës, koha e Dalias është ndalur papritur, dhe brenda saj një jehonë e lashtë e thërret atë të përbushë fatin e saj, atë të kthimit në vendet e së kaluarës së saj për t'i thënë lamtumirë personit më të rëndësishëm në jetën e saj: gruas së burrit të saj.

Por si mundet një grua të vajtojë pikërisht personin që ne, në konceptin tonë modern perëndimor, do ta konsideronim rival? Kështu ne transportohemi në një histori që minon të gjitha siguritë tona rreth posedimit, xhelozisë dhe krenarisë, përmes rivendosjes së një perspektive të dyfishtë. Nga njëra anë, vështrimi i Nadias, një gruaje të re nga qyteti që e vëzhgon Dalian, gjyshen e burrit të saj, me të njëjtën kuriozitet si ne, duke i bërë të njëjtat pyetje dhe duke i dëgjuar historitë e saj me mosbesimin e dikujt që nuk ka përjetuar kurrë gjëra të tilla. Nga ana tjetër, ai i Dalias, bartëse e një mençurie të heshtur të farkëtuar në hijen e Kanunit, kodit të lashtë të maleve shqiptare që kërkonte bindje nga banorët e saj.

Historia është e mbushur me tema universale dhe të fuqishme. Midis tyre, gjejmë eksplorimin e gjendjes së grave në një shoqëri të ashpër patriarkale, ku fati i grave nuk ishte një e drejtë, por një zgjedhje në duart e burrave. Megjithatë, është pikërisht në kufijtë e një ekzistence në të cilën vullneti i lirë shkatërrohet nga ligji fisnor që lind një formë krejtësisht të papritur rebelimi: solidariteti absolut midis dy grave që mishërojnë dy arketipe të ndryshme. Mara, forca tokësore dhe amërore, dhe Dalia, hiri eterik i ngjashëm me atë të Zanës, nimfave që banojnë në pyjet malore dhe bëhen rojet e tyre. Dy gra, një trup. Fillimisht të detyruara të jetonin nën të njëjtën çati dhe të ndanin të njëjtin shtrat me të njëjtin burrë, Mara dhe Dalia nuk janë më rivale dhe bëhen pasqyra të njëra-tjetrës. Këtu qëndron forca e vërtetë e kësaj historie, aftësia e saj për të zbuluar fuqinë e lidhjes midis dy grave që kanë vendosur (sepse ishte zgjedhja e tyre) të mos jenë armike, por të qëndrojnë në solidaritet me njëra-tjetrën, për të rifituar lirinë e tyre së bashku. Si dy përrenj që rrjedhin nga i njëjti mal dhe më pas bashkohen për të krijuar një lumë të vetëm, të fortë dhe të pandalshëm, fatet e dy grave janë të ndërthurura në mënyrë të pazgjidhshme, dhe ky bashkim bëhet një manifestim i formës më të madhe të qëndrueshmërisë së shpirtit femëror: sublimimi i dhimbjes përmes solidaritetit. Së bashku, ato sfidojnë sistemin patriarkal duke ndihmuar njëra-tjetrën gjatë lindjeve të tyre të vetmuara në pyll dhe dëborë, duke iu përkushtuar kujdesit për të njëjtin burrë, dhe madje duke ndarë lakuriqësinë e tyre, duke larë njëra-tjetrën, në një skenë që lartëson bukurinë e trupit femëror brenda një bote që e shihte atë vetëm si një objekt munda.

Një tjetër temë e përsëritur është elementi natyror, i cili, megjithatë, nuk është thjesht një sfond kundër të cilit lëvizin personazhet, por një zgjatim i vërtetë i shpirtit të tyre. Lumenjtë që rrjedhin e ndahen, bora, era ulëritëse, qiejt e çarë nga rrufetë që sjellin ogur të kobshëm: e gjithë natyra merr pjesë në dramën njerëzore. Vetë Dalia, me flokët e saj të verdhë dhe ecjen solemne, na shfaqet si “një zanë e zbritur nga mali” që i ka mbijetuar stuhive të fatit. Të shoqërosh Dalian në udhëtimin e saj për në shtëpi, në rrëzë të malit Gjallica, do të thotë jo vetëm të marrësh pjesë në funeralin e Marës, por

Mbi romanin e Luan Ramës të prezantuar këto ditë në Festivalin e VI të muzikës klasike në Piemonte të Italisë

Romani “Gruaja e dëborës” në “Kodrinat e muzikës”

Nga Martina Sartori

Është një risi e re që një festival ndërkombëtar i muzikës klasike fton në gjirin e tij dhe një shkrimtar. Ndoshta pse muzikantët e instrumentistët e kanë pasion leximin, letërsinë dhe padyshim dhe e kundërta, pasioni i shkrimtarëve për muzikën, por në këtë rast, në një festival ndërkombëtar me instrumentistë të shquar dhe të ardhur nga bota, nga Franca, Gjermania, Kina, Japonia, Amerika, emra këta të njohur të skenës botërore, prezantimi i një romani nuk ishte pak nën tingujt e Mozart, Bethoven, Händel, Brahms, Vivaldi etj. Çdo vit ky festival ka një temë të caktuar, dhe kësaj rradhe tema ishin “rrënjët” e artistëve dhe krijuesve të botës të cilët kudo që shkojnë hedhin rrënjët e tyre që mpleksen njëkohësisht me identitetin e tyre. Një frymë e bukur e universale e këtyre qytetarëve të shquar të Europës dhe të botës. Romani i Luan Ramës është botuar para disa viteve nga ALBAS me titullin “Dalia” dhe më vonë është botuar në Paris (me titullin “Konkubina e maleve”), duke vazhduar në rumanisht (“E dashura e maleve”) dhe tashmë në italisht (me titullin “La sposa della neve” - “Gruaja e dëborës”) përkthyer nga Sadina Rama dhe me pashënie të kritikës letrare Martina Sartori, në Muzeun e Artit Modern në Torino.

edhe të festosh triumfin e qëndrueshmërisë dhe të dëshmosh, i habitur, dëshminë e një dashurie aq sublime sa sfidon jo vetëm ligjet e njeriut, por edhe ato të kohës. Funerali, pra, nuk është asgjë më pak se akti i fundit që përfundon udhëtimin e Dalias brenda vetes, një udhëtim sa gjeografik ashtu edhe shpirtëror.

Spiritualiteti që përshkon historinë i ka rrënjët e tij në një dimension thellësisht pagan ku magjia, misticizmi dhe legjendat e lashta popullore përzihen së bashku. Është një spiritualitet i shënuar nga elementë animistikë dhe natyralistë. Për shembull, takojmë Zylian, fallxhoren cigane që lexon fatin në tym dhe parashikon humbjen e Sadiut. Takojmë Rexhën, njeriun që nuk betohet për Zotin, por “për Diellin”, hyjninë e vetme që e shpëtoi nga stuhia. Ne transportohemi në një botë ku natyra është e shenjtë dhe e tmerrshme: mulliri i misrit bëhet vendi i një lindjeje heroike, ndërsa Kulla e Djallit dhe Shkallët e Mallkuara shënojnë kufijtë e një gjeografie magjike. Malet Gjallica dhe Pikëllima, jeta dhe dhimbja, mbikëqyrin fatet e personazheve.




Pastaj gjejmë Kullën e Mallkuar, një kujtesë për ndëshkimet e Kanunit, dhe Kukësin e lashtë, qytetin e fundosur që pushon nën ujërat e liqenit, një metaforë për një jetë të tërë që shtrihet në fund të kujtesës. Në këtë mjedis, rrufeja nuk është vetëm një

fenomen atmosferik, por një shoqërues udhëtimi, pjesë e një natyre të egër që Rexha e respekton më shumë se çdo hyjni institucionale.

Gjithashtu e rëndësishme është tema e marrëdhënies midis prindërve dhe fëmijëve dhe konflikti brezash që lind. Sadi, djali i Dalias, jetim nga babai i tij, bëhet personifikimi i fëmijërisë së vjedhur. Refuzimi i tij ndaj xhaxhait Rexha, i cili në shtratin e nënës së tij ka zënë vendin e babait të tij të ndjerë Zeka, është në të vërtetë britma e një shpirti që sheh gjakun e tij të përdhoret. Lufta e Sadiut nuk është për pushtet, por për ruajtjen e pastërtisë së tij duke rikuperuar kujtimet e babait të tij. Zeka, babai i tij, nuk jeton vetëm në kujtesën e tij, por është një hije që ecën mbi dëborë, duke i pëshpëritur këshilla dhe duke e shtyrë, që në fëmijëri, të sfidojë ligjin e Kanunit për të mbrojtur nderin e familjes së tij. Kështu, edhe Dalia lufton betejën e saj, duke pranuar makthin e martesës së re jo nga dëshira, por nga dashuria për fëmijën e saj. E akti i saj nuk është një akt dorëheqjeje, një akt i bërë nga dikush që i dorëzohet fatit të vet, por një zgjedhje e vetëdijshme, duke pranuar një jetë në një limbo emocionale ku kënaqësia bëhet një emocion mbytës dhe shtrati martesor shndërrohet në një fushë beteje heshtjesh dhe lotësh të përbashkëta. Kështu, sakrifica e nënës bëhet një forcë e vërtetë lëvizëse, madje duke sfiduar vdekjen.

Lexuesit që janë gati të hyjnë në këtë histori janë të ftuar të heqin të gjitha paragjykimet tuaja dhe ta lënë atë t'ju çojë në një udhëtim në kujtesë. Përmes kujtimeve dhe historive të rrëfyera, do të zbuloni se dashuria, në çdo epokë dhe në çdo gjendje, do të gjejë gjithmonë rrugën e saj për të mbijetuar, edhe pas vdekjes, sepse, në fund të fundit, kufiri midis të gjallëve dhe të vdekurve është jashtëzakonisht i hollë. Kjo është historia e një të mbijetuar që nuk e ka humbur aftësinë për të buzëqeshur dhe për të folur për dashurinë pavarësisht të gjitha fatkeqësive që jeta i ka sjellë. Dalia na mëson se mund t'i mbijetojmë Kanunit, luftës dhe humbjes pa humbur identitetin tonë. Ajo na rikthen vetëdijen se vende të caktuara mund të shkatërrohen, por pëshpëritjet dhe britmat e atyre që i përjetuan ato do të vazhdojnë të jehojnë për sa kohë që ka dikë, si Nadia dhe si ju, janë të gatshëm të dëgjojnë.



U MBAJT EDICIONI I DYTË I PANAIRIT TË LIBRIT

Festa e bukur e librit shqip në Preshevë

Synojmë ta kthejmë këtë panair në traditë

Nga Ardita Sinani,

Kryetare e Komunës së Preshevës

Sot, Presheva u bë për të dytin vit me Sradhë kryeqendra e librit dhe artit shqip, duke mirëpritur edicionin e dytë të Panairit të Librit me moton "Libri dhe tradita".

Ishte një nder dhe kënaqësi e veçantë që këtë ngjarje ta hapim në praninë e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij, z. Bajram Begaj. Prania e Tij i dha

këtij panairi një peshë të veçantë kombëtare dhe institucionale, duke dëshmuar edhe një herë kujdesin dhe vëmendjen e Republikës së Shqipërisë për Preshevën dhe Luginën.

Panairi i Librit nuk është vetëm një aktivitet kulturor. Ai është një investim në dijen, kulturën dhe identitetin tonë kombëtar.

Thonë se shtëpitë ndërtohen me gurë, por kombet ndërtohen me libra. Pikërisht për këtë arsye, sot nuk po hapim vetëm një panair. Sot po hapim një kapitull të ri për jetën kulturore të Preshevës dhe të gjithë Luginës.

Ky ishte mesazhi që përcollëm sot nga Presheva.

Libri është kujtesa jonë, është gjuha jonë, është historia jonë. Ai lidh brezat, ruan identitetin dhe na kujton se, pavarësisht sfidave me të cilat jemi përballur, rrënjët tona kanë qenë dhe mbeten më të forta se çdo pengesë.

Motoja e këtij panairi, "Libri dhe tradita", mishëron më së miri atë që duam të ndërtojmë. Tradita na tregon se kush jemi, ndërsa libri na mëson se çfarë mund të bëhemi. Kur këto dy vlera ecin së bashku, ndërtohet një e ardhme më e sigurt për brezat që vijnë.

Me pjesëmarrjen e rreth 30 shtëpive botuese, mijëra titujve librash dhe artistëve nga Presheva, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, Presheva dëshmoi edhe një herë se kultura dhe libri janë ura që bashkojnë shqiptarët kudo që jetojnë.

Shpreh mirënjohjen time të singertë për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, si dhe për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Serbi, të cilat edhe këtë vit qëndruan pranë nesh dhe besuan në këtë vizion.

Vitin e kaluar panairin e nderoi me praninë e tij ministri Blendi Gonxhja, ndërsa këtë vit patëm nderin të mirëpresim Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesinë e Tij, z. Bajram Begaj.

Prania e Presidentit Begaj në Preshevë ishte shumë më tepër se një vizitë zyrtare. Ajo ishte një mesazh i fuqishëm se Presheva dhe Lugina e Preshevës mbeten pjesë e pandashme e botës shqiptare dhe se kultura vazhdon të jetë ura më e fortë që na

bashkon.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës, si komunitet që çdo ditë përballlet me sfidën e ruajtjes së identitetit, gjuhës dhe traditës së vet kombëtare, vizitat e përfaqësuesve më të lartë të shtetit amë i përjetojnë gjithmonë si ngjarje të veçanta. Prandaj, prania e Presidentit Begaj në këtë panair kishte një domethënie të jashtëzakonshme për qytetarët tanë.

Qëllimi ynë nuk ka qenë të organizojmë vetëm një aktivitet dyditor. Synimi ynë është që Panairi i Librit në Preshevë të shndërrohet në një traditë të qëndrueshme, që do të rritet çdo vit, duke u bërë një pikë takimi për librin, artin, kulturën dhe krijuesit shqiptarë.

Sepse një qytet nuk bëhet i madh vetëm nga rrugët që ndërton. Ai bëhet i madh nga dija që kultivon, nga librat që lexon, nga kultura që ruan e nga brezat që edukon.

Që në fillim të mandatit tim kam premtuar se Lugina e Preshevës do të ketë më shumë Shqipëri dhe më shumë Kosovë në jetën e saj kulturore dhe institucionale. Sot, me mbështetjen e institucioneve të Republikës së Shqipërisë dhe të gjithë partnerëve tanë, ky vizion po merr formë konkrete.

Ne duam një Preshevë ku fëmijët rriten me librin në dorë, ku artistët kanë hapësirën e tyre për të krijuar dhe ku kultura nuk është një ngjarje dyditore, por një mënyrë jetese.

Sepse kur ruajmë librin, ruajmë gjuhën.

Kur ruajmë gjuhën, ruajmë identitetin.

Dhe kur ruajmë identitetin, ruajmë vetveten dhe substancën tonë kombëtare.

Faleminderit Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij, z. Bajram Begaj, për nderin që i bëri Preshevës me praninë e Tij. Faleminderit të gjitha institucioneve, shtëpive botuese, artistëve, krijuesve dhe çdo qytetari që u bë pjesë e këtij edicioni.

Ky panair dëshmoi edhe një herë se Presheva është qyteti i librit, i kulturës dhe i vlerave tona kombëtare. Dhe ky është vetëm fillimi i një tradite që do të vazhdojë e do të rritet vit pas viti.





RRETH 30 SHTËPI BOTUESE NGA TREVAT SHQIPFOLËSE MORËN PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT TË ZHVILLUAR NË PRESHEVË.

Me moton “Libri dhe tradita”, gjatë eventit do të ketë prezantime të mijëra titujve për të gjitha moshat dhe zhanret, si dhe ekspozitë me vepra të artistëve nga Presheva, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, shoqëruar me tinguj të muzikës tradicionale, shkruan “ATSH”.

Ky është edicioni i dytë i këtij panairi i cili organizohet nga Biblioteka “Mehmet Jusufi” në Preshevë dhe Shtëpia Botuese “Albas”, me mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit të Shqipërisë, Ambasadës shqiptare në Serbi, Këshillit Kombëtar Shqiptar dhe Komunës së Preshevës.

Ky panair konsiderohet si një hapësirë e rëndësishme takimi për botues, institucione kulturore, autorë dhe lexues, duke promovuar librin, leximin dhe trashëgiminë tonë kulturore.

Në edicionin e tij të dytë, Panairi i Librit në Preshevë po konsolidohet si një ngjarje me rëndësi të veçantë për promovimin e kulturës së librit shqip, duke forcuar bashkëpunimin kulturor dhe lidhjet ndërmjet institucioneve, botuesve, autorëve dhe lexuesve në të gjitha trevat shqipfolëse.

(Sipas ATSH)

Çmimi Special i Panairit Romanit “Brenga” të Pashko Camajt

Autori: çmimin ia kushtoj heroit real të romanit, Tonin Mirakajt

U nderua me “Çmimin e karrierës” shkrimtari Ylljet Aliçkaj

U nderua me “Çmimin e karrierës” shkrimtari Namik Dokle



ti më përgatite kryqin
ti bëre gozhdët
ti më bëre gjyqin

vetëm se gjaku është imi

Pilati lau duart

ishull i shkretë
rrethuar nga ujërat në vetminë e tij
shpesh fryjnë erëra të forta që vijnë
nga toka dhe nga deti
kështu është vendosur të jetë fati i tij

këndoi përmbi shelgun e gjelbër dhe
fluturoi

as që e vuri re ku isha unë
as që e vuri re që unë po e dëgjoja

këndoi dhe s’kam si ta di pse po këndonte

këndoi lauresha përmbi shelgun e gjelbër
dhe shkoi

ti mos vdis

kur bashkohet jugu jot dhe jugu im
qielli dhe toka janë bashkuar
atëherë ah unë dua të mbyll sytë
dhe të vdes
bashkimi i tokës me qiellin është jeta

ti mos vdis

Epitaf

sot mësuesja ime Suzana Xhepa shkoi në
parajsë
ishte e thjeshtë dhe gojë ëmbël
vetëm kështu shkohet në parajsë: e
thjeshtë dhe gojë ëmbël

Elbasan më 19 mars 2026

dikur dikur të gjithë do më harroni

dikur dikur të gjithë do ju harroj

dikur dikur do jem dhe unë i padukshëm
si Zoti

kalon ti të gjithë të ndjekin me sy

si të mos jem unë xheloz për ty

po të çoheshin dhe të vdekurit

patjetër që unë do vdisja prej xhelozisë

dola anëdetit

hingellima e një kali të egër
që erdhi nga pylli i Divjakës
më nxori nga perhumbja
tani nuk ka më Pirro i Epirit
as Aleksandri i Madh
as Gjergj Kastrioti
as unë nuk jam kalorës

si ngahera dola anëdetit

të lehta
të thjeshta

XHELAL TOSKU

Pilati lau duart

Poezi



rrëzon era
lulet e mollëve

kështu e paska kjo botë
gjithkund përgjon vdekja

freski e mëngjesit : kur shuhen yjet janë
lulet e qershive

sikur vdekja të kishte aromën e fry-
mëmarjes tënde
pa hezitim
doj vdisja në çast

lule qershie dhe freski mëngjesi

e tashmja bëhet e shkuar
e shkuara gjithmonë shkon
dhe jeta fillon tani

gjithmonë

është qielli dhe yjet
është kjo bote kaq e madhe
jam dhe une me jeten time kaq te vockel

më shkruan Ana që nga Vinjola
ba e ke dëgjuar Brian Kulbertson
dhe unë degjoj Brian Kulbertson
mjafton kaq
dhe më shkojnë lotët

të gjithë njerzit për të shprehur dashurinë
përdorin të njëjtën fjalë : të dua
gënjeshtarët e dreqit
të gjithë thonë të kam zemër
gënjeshtarët e dreqit
të gjithë thonë të kam shpirt
gënjeshtarët e dreqit
të gjithë thonë të dua shumë shumë
genjeshtaret e dreqit
të dua pa fund thonë të gjithë njerzit
gënjeshtarët e dreqit
unë nuk dua të jem gënjeshtar

çiftja e gjahtarit
dhe gjaku i një rose
ma ngjyen me të kuqe
gjithë liqenin

gjithë liqenin
dhe gjithë mëngjesin

nuk paska njeri
ta ndalojë gjuetinë
e rosave

unë e dita që jam asgjë
dhe humba nëpër net
si humbet asgjëja
duke parë një yll të shndritshëm
që është një gjë
që kur bie
nuk e ndalon dot askush

Poezi e vjedhur

në fillim lëkurëkuqët
thënë ndryshe : indianët
kishin tokat e tyre

shkuam ne lekurëbardhët
thënë ndryshe : europianët
dhe u çuam biblën tonë
dhe u thamë lutuni
dhe ata u lutën

tani indianët thënë ndryshe : lëkurëkuqet
u zhdukën me biblën tonë në dorë
ne europianet thënë ndryshe : lekurëbard-
hët
rrojmë në tokat e tyre

unë eci në çdo çast
ti në çdo çast fluturon
cili është horizonti
që nuk po e kapërcejmë dot

Shën Naumi Manastir
syhtëhuajmëshohinsitëhuajnështëpinëtime
nde z një qiri dhe digjem vetë
dikush duhet të dëgjojë lutjet
duhet dhe dikush të bëjë dritë

i kemi harruar kuajt
që në beteja ranë bashkë me ne
kuajt që na sollën deri këtu
i kemi harruar
një kalë nuk hingëllin kurrë kot

pak e nga pak
erdh dhe nata u bë e errët
pak e nga pak
erdh dhe deti u bë i zi
pak e nga pak
erdh dhe ti u bëre pikellimi im

unë besoj te fjalët tuaja

ti thoje gruaja është deti
s’di pse më vinte ta besoja

ti thoje deti është grua
sdi pse më vinte ta besoja

ti dhe unë ishim anë detit
ti dhe unë ishim tek deti

ti dhe unë kapur dorëpërdore
ti dhe unë mbështetur tek njëri-tjetri

netëve degjoj tani si zhaurin deti
netëve degjoj tani zhaurimën e butë të
detit

unë besoj të fjalet tuaja
unë besoj në ty

nata po bie mbi det
deti yjet e përmbysur dhe anijet
ti nuk dihet se kur do vish
dhe unë nuk gjej qetësi gjekundi

nëpër gishtërinjtë e mi
flokët e saj

kush e diti çfarë është dashuria

ah nëpër flokët e saj
gishtërinjte e mi

fjalët e mia të vogla
i merr era
vetëm unë e di
pse psherëtin netëve
pylli i katundit
tim

Në kujtim të poetit Zoi Dashi

njëmbasditeerdhiZoinëRrogozhinëtekunë
do pimë më tha
pimë i them
do dehem i më tha
dehemi i them
për inate të qenve më thotë
për qejfin tonë i them
u ndamë më dysh më thotë
kush i them
ne më thotë
ne dhe qent e parlamentit
ne dhe qent e qeverisë
ne dhe qent e bashkisë
po u ndamë i them
dhe pimë gjithë mbasditen
dhe u dehëm te dy
Zoi për inat të qenve
une për qejfin tim

dhe për qejfin e Zoit
në fund si për surprizë
më dhuroi romanin e vet
Jetë Qeni
dhe u ndamë

nuk e dija se do ndaheshim përgjithmonë

A B C

edhe kur dëbora ka mbetur në male
edhe kur stuhia humb rrugën nëpër pyje
edhe kur ylli rrëzohet e bie në humnera
edhekurshiratdheerëratshkojnetejnëfusha
më përtej se shokë
më përtej se miq
dera mbahet çelë natën

ti lulëzon si kopësht

zbukurimet tuaja
lulet tuaja

zbres poshtë
ngjitem lart

ti lulëzon si kopësht

nuk është vetem era që çohet në stuhi
është edhe shpirti . . . shpirtin tim vetëm ti
mund ta qetësosh

një gjest i vogel
një shtrëngim duarsh
një buzëqeshje
një shkundje flokësh
mbështëtja e kokës në supin tim
kaq
vetëm kaq
dhe ti vjen tek unë
dhe bëhesh perendi

perëndia ime

Corina Corina Corina
vetëm Corina
Corina natën Corina ditën
në çdo çast Corina
Corina në endrra Corina në jetë
Corina në çdo çast
Corina dhe askush tjetër
askush tjetër nuk është si Corina

si Corina që dua unë

në vetminë time
në netët e mija spërkatur me hënë dhe yje
në netët e mija me dimra të ftohtë
në netët e mija
që lagen në shi
askush nuk e di
që ti vjen dhe strukesh tek unë
me ato flokë
me ato buzë
me ato sy
besoj as Zoti vetë
as ti

Adriana Bes Corina

jeta e pëllumbave është në qiell
toka është për pak

si fëmijë i njerzimit
si i gjithë njerzimi

unë ndjek me sy fluturimin

të ngjitesh lart është si një perkedhelje

kalon ti
të gjithë të ndjekin me sy

si të mos jem unë
xheloz për ty

po të çoheshin dhe te vdekurit

patjetër që do vdisja
prej xhelozisë

ti ke zbritur nga qielli

goja jote hyjnore
edhe kur flet
edhe kur hesht
edhe kur qesh
edhe kur këndon

gjallëron trëndafilat në kopshtin tim

me një trëndafil në dorë
ti zgjon mëngjesin tek une

dhe je kaq e bukur

me një trëndafil në dorë

nëpër katund shkoj kuturu
në gjumë të paskam thirrur me emër
ngatërroj datat dhe ditët e javës
në rrugë bëj kujdes mos njerzit më shohin
lëvizjen e buzëve
do thonë ka rreshqitur flet me vete
askush nuk e di që pëshpëris emrin tënd

ti di gjë çfarë mund të kem

përgjatë gjithë jetës rrethuar me vetmi
humba aftësinë për të folur
të vetmen fjalë që shqiptoj tani është : të
dua
dhe po ta them vetëm ty

nuk shkoj më tek deti

nuk e shoh dot detin

nuk më shkohet tek deti

si tëshkoj tek deti

pa ty

asnjë lule artificiale
nuk e pret erën
që vjen nga fushat
që zbret nga malet
dhe nga pyjet

ti je si një jasemin

unë të kam puthur duart

hodha sytë nga kambanorja
e kishës
kambana bosh

sa do këtë qenë ora kur u ndamë

ti ike

dhe une si kambana bosh

një herë e një kohë
unë e zmadhoja Amerikën
e bëja sa Walt Whitman

Amerika po më kokën e vet
si atherë edhe tani

dora jote me vija të imta
është dashuria ime

dora jote
qëndron në dorën time

unë vdes për dorën ende
me vija të imta

fjalët nuk na duhen

kur të vish ndiz dritën

ti dhe unë si në fillimet e njerëzimit

kur të ikesh fik dritën

si njerzit i tremben vdekjes

si njerzit nuk kanë frikë ikjen

kur të ikësh fik dritën

unë do doja të vdisja

sot si deti në dimër

nuk e di se si më mbajnë brinjët

trishtili im i vogël

ti nuk vjen si njeri dhe ikën si vrasës

ti vjen si trishtil dhe ikën si trishtil

unë vij me ty dhe mesoj si këndohet

unë nuk kam jetë
nuk di pse ma dhanë
jeta nuk është e imja
nuk di pse do ma marrin

unë të dua vetëm ty

vetëm ty dhe asgjë tjetër

të dua të dua të dua
dhe dua ta them prap : të dua
dhe prap dua ta përsëris : të dua

në këtë botë të genjëstërt
them të vërtetën çdo çast

të dua

çdo lule margarita
është e brishtë

po brishtësia vdes shumë shpejt

tek vyshket
tek thahet

çdo lule margarita këtë e di

dhe trishtimin e ndajmë bashkë

ah syte e saj
Zoti im
unë e dua këtë grua

ah zëri i saj
nëse bëj mekat
më thuaj

ah e qeshura e saj
Zoti im
ti vetë e ke krijuar

ti dhe deti
deti dhe ti
dhe kaltërsi pa fund

O Corine e bukur
O Corine e bukur
kjo rërë e arte nën këmbët tuaja
është prej shkëmbinjsh të gerryer
të thërrmuar

O dhe unë e di

O Corine e bukur

une e gjeta yllin tim

unë e zbulova yllin tim

unë ia di dhe emrin

Corina

pas kaq shekujsh
unë kam takuar Kleopatren
kam mbajtur në duart e mija duart e saj
Mark Antonin e kishte harruar
Cezari nuk i kujtohej fare
gjithçka ndodhi ne prani
të Adrianes
dhe të Bes Camajt

gji i vogël deti era e detit
tutje shtrihet botë e madhe
po mua më mjafton vetëm ti

ti në krahët e mi

kush të beri ty kaq të bukur

shpirti im struket në trupin tim

i verbuar prej teje

trishtili im i vogël unë degjoj zërin tënd

ti e degjon zërin tim

çfare ka bota me ne

PARMBRAMË BUJTA NGA TI

Andej nga i bjen pullazi yt,
del sheti shpirti jem
pa më pyet.

Veç fytyra jote,
e kanga e gjinkallave,
më pshtuen prej natës si korb,
që deshti me m’a nxanë frymën.

Ka me më ardh’ deka,
e nuk kam me iu frigue,
se trupin larg e kam,
por shpirti jem çdo natë,
vjen me bujt nga ti.

AGU

Shoh si tretem nëpër kohë
Dhe grimcat lypi me ngjit.
Me veten teme të thermueme
Kishe mujt me ba një grue të lumtun.

...por prapë, un’ knaqem tue t’dasht.

Të shoh si tretesh nëpër kohë
Dhe nuk e di ç’kërkon.
Me veten tande të thërmuem
Kisha dasht me ba një burrë të lumtun.

...prapë, un’ knaqem tue t’dasht.

Të preka, me e dijtë në je njeri
a skulpturë.
Tanë natën e lume të sodita
si vepër arti në qiell të hapun.

...knaqem tue t’dasht.

E pashë, isha aty, andaj dëshmoj
si drita agoi prej syve tu
dhe u ba ditë...

...tue t’dasht...

E BIJA E FILANIT

A e sheh që vjen prendvera?

E bija e filanit mbledh lule
Në kopsht,
E ama qan për tradhëtinë
E të shoqit.

Zukasin bletët pas shpie,
Simjet kena me nxjerrë mjaltë.
Kena me pas edhe qiell me yjza.

E bija e filanit ka me i numrue
Në muejin maj:
Lulet, yjet, andrrat ...

I tregova të bijës së filanit
që ti u bane veç një
andërr e bukur e shpirtit tem
dhe ajo u shkri në gaz me fjalën
“andërr”


Un’...qava.

KOHA E LULEVE

E dashuroj,
i thashë një pakoje me faculeta
te kryet e krevatit,
dhe u çudita me vete si nuk ndjeva
pikë trishtimi,
as gjamën e të pamundunes në jetë.

Duart akull!
Gjithë ditën kam pas temperaturë
dhe kollë.

Kam gatue, pi kafe
La tessa, pi kafe
Ba not, pi kafe
Isha më Meshë, pi kafe
Pashë koncert, pi kafe
Rilexova Remarkun, pi kafe.



Në darkë,
rroka në buzë heshtjen në dhomë
dhe e pyeta veten “a u lodhe?”.

Marrëzisht dashuroj
heshtjen dhe vetminë në shtëpinë teme,
por për të parën herë deshta me i nda me ty...

Mendova edhe për parrizin,
Këto kohë nuk më duket ma interesant
aq shumë përsosmëni...

E dashuroj,
dhe nuk pikëllohem ma që s’e kam.
Ndoshta do i ishim mërzit shoqi - shoqit
me kohën dhe mbase do i kishim kthye
shpinën njëni-tjetrit pasi të banim dashni.

Kurrë ma parë s’e kisha ndëgjue me kaq
vëmendje zanin tem teksa lexoj këtë poezi.
Ka tingull prej fëmije, melodinë e andrrës
dhe në korda mban kryq-ndjeshmëninë
teme.

E dashuroj...pi ven’
E mendoj, pi ven’
Lutem për të, pi ven’
Po shkruaj këtë poezi, pi ven’...
Mblodha lule në park, piva ven’...
Nata, nëse s’asht për dashni,
asht për me shkruar dhe me pi ven’.

Kam me të shkruar në faculeta
nji letër tjetër që kurrë ma nuk do t’a nis...

ENIGMA

Ishte koha e enigmave
Askush nuk fliste haptas me shoqin.

E paqartë ishte nëse njëni e dashuronte
tjetrin apo nëse xhelozia ishte në ajër.

Dynjaja shkonte në ballo
Çmendunie.

Rashë në dyshek plot shtatë vjet.
Askush s’e kishte vu re mungesën teme
Përveç atij, praninë e të cilit s’e dija...

Ishte koha e enigmave.
Sa të fshehta mbante
nangjigjeja jeme?

Në kërkim të thellë të vetes
Nuk gjeta përgjigje,
Veç një grumbull pyetjesh të klonueme
Më silleshin rreth e rrotull.
Edhe netët ma kishin zili
Në mbylljen time në vetmi.

Dhe të pashë ty një ditë dimni,
Ndoshta jo për me të pas gjithmonë
Por për me kuptue filozofinë e pa shkak
Të lumtunisë,
për me veshë prapë tessa me ngjyra
e me lanë zakonin e trishtimit në shpirt.

Ishte koha e enigmave.
E vetmja gja që dija ishte mosdija
dhe se si mund të dashurohej njeriu
Në një çast me të panjohunin.

LUMNIA

Dje ia mbylla sytë një grueje
Që dha shpirt,
Dhe duert ja bana bashkë.
Lajmërova të birin që më tha:

“Shkoi? Ma në fund!”
Nuk u shokova,
Tashma dhimba asht gja e rrallë
Te njerzit dhe ndjeshmënia po ashtu.
Mendova: “Sa mirë që s’kam fëmi”.

Pas darke dola rrugicave
të Vjenës dhe kam mendue,
Se sa i lum’ asht trupi yt
Që e mban shpirtin tand...

Ky qytet,
më shpëton nga plaga
E modernitetit që nuk më
shkon për shtat.

E prapë...
Ashtu nëpër rrugica
anash rrugës vetëm jam ul,
E kam mendue,
Se sa i lum’ asht balli yt
Që i ka sytë e tu...
Njaj kapak që shkrepet
dhe e përfaq’ dritën e synit tand
I lum’ asht, o Zot, sa i lum’...

Nji burrë tek të shtatëdhetat i binte
violinës aty ma andej,
E prapë kam mendue me vete,
Se sa i lum asht zani që
prekë buzën tande,
Dhe gjumi... oh, gjumi...
nuk asht ma pak i lum’
Që pushon mbi tuat qepalla.

Veç t’a dish,
zemra jeme që ndjen’ për ty,
Nuk asht ma pak e lume.

Ma pak e lume s’asht,
Për këtë natë të heshtun...

POEMA E NATËS SË SHKUEME

Për të parën herë
Ndiej që më dhimset jeta.

Me dekën kam ba gjithnjë lojna.
E kam dijtë që ajo
Vjen veç nëse njeriu asht i lumtun.

Ceremoni solemne!
I lypa falje vetes teme
Që kisha pas gjithmonë
frikë nga dashnia.
Që të mbetessa e lirë,
I pata vu zemrës një gurë.
Ai erdh’ një ditë si hajni
Dhe më zuni mat.

Drita e kandilit e din,
Ikona e Zojës dhe vetë ai,
(sa i thellë asht syn’ i tij...)
Që e humba betejën e gurit dhe murit
Dhe kam frikë të shihem në pasqyrë,
Se më padit syni i dhathtë
Ku mshefet ftyra e tij.

Andej detit rrah zemra e tij.
Ai merr frymë,
Flutrojnë flokët e mij.
Kam frikë me e mendue,
Se mos ia prishi gjumin...

Zhurma e frigoriferit...
Sa e akullt asht loja e lules
“Më do, s’më do”.
(a më do ai?)
I njajti qiell na i mbulon thinjat,
E njajta tokë na i varros friknat.

Terr...!
Në mur ban dritë syni i tij.
Perendi,
qerpiku i tij m’a shkrep fatin e jetës?
Deka dhe dashnia
janë baraz për njerinë,
“Mos u tut”, -
e ndëgjova se më tha shpirti,
Kur më zuni teksa flisja me veten
(apo me të?)

Qetësi!

Ky pallat ka vetëm njerëz të kulturuem,
Akademikë, bankierë, mjekë, një Zoti e di...
Janë të qetë, urryeshëm të qetë,
Më mundon kaq rregull dhe qetësi.

Sikur të çmendesha me të,
Me të qeshunën e tij,
Nuk gjej njeri të ngjashëm me vetin
Përveç shpirtin e tij të lirë e rebel
(s’e njoh, por e ndiej).

Kjo natë e pasosme...!

Andej detit flen ai.
Flen përnjimend?
E len mendimi jem për të,
me vu gjumë në sy?

Në darkë e mendova përballë,
Të pëlqejnë spaghetti-t shpirt?
Vera, e mirë?

...ky filli i padukshëm i ndjesisë...
Kam ndërtue një telefon të ri,
Unë të mendoj dhe ti buzëqesh
Unë të shkruaj dhe ti tund kryet.
Komunikim-ndjesi.

Nuk jam idealiste
Qeshi se nuk due me kja...

Më pëlqen me fluturue në naltësi,
Në jetën tjetër duhet të kem’ qenë zogë.

Fryn murla,
Varrezat të jenë mirë?
Herën e fundit pashë një kryq të thyem
Të jenë njallë të dekunit?

Prapë m’u kujtue deka,
Ajo nuk vjen sa jam pa ty.
Kam me të tregu një përrallë të shejtë
për përjetësinë.

Eja pështete kryet në Danub.
A nuk të kanë fol kurrë
për skuqjen e diellit mbi lumë?

Sa shumë gjana na i mëson
Veç dashnia...
Kurrë ma parë s’më asht dhimbt jeta.
As për shëndetin s’isha ba kurrë merak
As për ushqimin, analizat i urrej
(si spitalin dhe uniformën),
as se mos më shtyp metroja
Kur eci cokatun, përhumbun e hutuëm.
Dje harrova veten në market,
Më futen në magazinë
Në kartopeceta që ishin stok
shkruejta diçka për ty.
Kam me t’a dhanë sonde në andërr,
Mos e harro kund si e ke zakon
Si çanten bjen fjala...
(harro ç’ka të duesh,
veç mos harro si asht kur dashuron)

Jo çdo gja shkon me rregullën e treshit,
shpirt
Nji frikë për me dashurue plus një frikë me
vuejt,
Bajnë baraz me një vetmi.

(vetmia më kujton trupin e gjyshës së dekun
dhe një rrëshajë të ngordhun që ’em atë e
vrau.
“Tani do jesh mirë” - më tha, -
gjarpni s’ta lidhë ma fatin tand”.)

Shpejt ka me ardh Pashka...
Mos më len’ kelkun vetun me e pi...
mbulue m’i ka nata supet.
Plagën më len’ me t’a prekë
Si Shen Toma,
T’a di se je ala njeri.
Dy vetmi bashkë,
Bajnë baraz me një dashni.

O Perendi,
Banem andrrën e tij,
Aktin e fundit të dramës

...mandej le të mos vijë,
Kurrë të mos vijë,
Se tutem,

nëse jam e lumtun me të,
vjen e më merr deka...

DITA PAS SHIUT

Pas ditës së shiut
Mbeti aroma e barit të lagun
Gjethi si syni pas lotit
Qielli i kthjellët
Dhe luleshtrydhet në kopshtin tonë
Kuq si gjaku,
Të ngjashme me faqet e mia
Sa herë të sjelli ndërmend në msheftësi.

Shinat pushuen
Dashnia jeme.

Gjithshka duket ma e pastër
Dhe ndrin
Shkalla
Oborri
Asfalti...

Në balli tem
ndrijnë
veç sytë e tu ...

DUE DIKAND...

Due dikand me të cilin të harrohna në paqe
dhe pa zhurmë,
Dikand me të cilin mbasi të na mbarojë
dashnia
mos të mallkojmë kohën kur dashnia
ishte në lulimin e saj.

Due dikand me të cilin paqësisht me thanë
“ A e mban mend atë kohë”...
Se edhe pse dashnia nuk ka me qenë ma,
gjithmonë ka me lanë
gjurmët e padukshme të gishtërinjëve,
zanat nëpër veshë, kujtimet e pavaruna
që sjellin tanë jetën buzëqeshje tinzare
në cep të buzëve, e dritën që mbetet në sy.

Gjithmonë kam mendue që dashnia
edhe pse mbaron, prapë nuk mbaron kurrë...

Due dikand me të cilin të qeshem me lot,
Që më mban’ në prehen dhe në shpinë.
Dikand me të cilin me u dashtë për pak
mandej me e fikë dashuninë,
para se të na fikë ajo ne buzëqeshjen.

Due dikand të marrë si veten,
Që ma kupton çmenduninë.

Dikand me të cilin nuk kam me fol për
plot gjashtë muej për një keqkuptim a
krenari,
Qe nuk kam me ndejt tu pa mos po shkruen,
as nuk kam me qa pas perdes ngjyrë blu,
Se do i ruhem edhe vetes se mos më heton...

Dikand që në kulmin e dashnisë ta quej idjot
dhe me çdo fjalë të mundshme të çuditshme
t’ia shpreh dashninë.

Dikand që ta dëboj në nerva e sipër
dhe prapë mos të ikin prej shpisë.

Due dikand që mbasi mos të dashurohna
ma,
të përshëndetna në paqe të plotë
në një ditë me shi, mbramje letrare a për
bamirësi...

Dikand me të cilin mos të shkojmë
në gjyq për me nda librat që i bashkuem
kur ishim bashkë,
As dhomën me guzhinë me kredi
As të qeshunat as lotët
As netët pa gjumë
As rrëfimet në orët e vona
As fajet.
Due dikand,
me të cilin me më lind prapë dashnia
pasi të më ketë mbarue...

ARBEN VELO

Fustani i Penelopës

Tregim

“Dua të ndahem nga burri im”, tha Penelopa dhe i zgjati kërkesëpadinë gjyqtarit. Gjyqtari i seksionit familjar ngriti kokën ngadalë dhe e pa gjatë. “Si e keni emrin?” pyeti ai. “Penelopë.” “Penelopë?” Gjyqtari ndaloi një çast. “Ju mos jeni ajo...?” “Unë jam ajo që po kërkon zgjidhjen e martesës me ish-burrin tim”, ia ndërpreu ajo, duke i këputur fillin e pyetjes. “Përse e kërkon këtë zgjidhje?” “Ai iku. Më la këtu si një kërcure. Më gënjeu. Dhe të gjitha këto janë shumë pak.” “Mendohuni edhe një herë”, tha gjyqtari. “Jeni ende e re. Mund të jeni duke u nxituar.” E tha më shumë me veten sesa me gruan që kishte përballë. “Të nxitohem?” Penelopa e pa drejt në sy. “E dini ju sa kam pritur? E dini sa kam vuajtur? E dini çfarë do të thotë të presësh? Po çfarë do të thotë të vuash?” “Zonjë, ju lutem...” “Si më luteni? Unë e mora nga larg dhe erdha këtu me të. Ndërsa ai iku. Iku dhe më la. Ndoshta shkoi pas të tjerave në atë ishullin e mallkuar, ku u nguroftë përgjithmonë.” Gjyqtari u çudit nga shpërthimi i saj i papritur. “Zonjë, ju i përkisni një kohe që...” “Unë nuk i përkas askujt”, tha Penelopa. “Dua të ndahem nga burri im.” Ajo e pa gjyqtarin drejt në sy. “Atëherë ejani përsëri. Do t’ju caktoj datën e seancës. Duhet të jetë edhe Odiseu. Duhet të marrë njoftim për procesin. Nëse mungon, duhet të ketë një përfaqësues ligjor.” Penelopa heshti. Për herë të parë pas shumë vitesh, emri i tij u dëgjua jo si kujtim, por si një pengesë ligjore.

Fustani

Po i vidhej gjithë familjes. Shkaku ishte ai fustan. Mbyllej në atë dhomë, mes perdeve të rënda që vareshin si forma të çuditshme, si jaka luftëtarësh të vjetër. Pasi largoheshin të gjithë, ulej mbi makinën qepëse dhe niste punën. Zhurma e saj përhapej nëpër shtëpi. Një tingull i njëtrajtshëm, i ngjashëm me goditjet e fshehta të një tezgjahu, që herë e qetësonte dhe herë e kthente përsëri në mendimet e saj. Aty brenda ishte gjithçka. Kukullat. Fotografitë e tij. Lulet.

Dhuratat e dërguara nga njerëz që, kush e di përse, kërkonin të afroheshin me trupin e saj, duke besuar se një dhuratë e bukur mund të hapte një derë që ajo e mbante mbyllur. Por më shumë se çdo gjë tjetër, ajo priste zilen e derës. Sa herë binte, Penelopa dridhej. Fshehte copën e fustanit ende të papërfunduar, ose, nëse nuk kishte kohë, e çmblidhte shpejt me duar dhe rrinte para saj duke menduar se çfarë forme duhej të merrte. Pastaj niste përsëri nga e para. “O Zot, deri kur kështu?” Kaq gjatë pret njeriu për një njeri tjetër? Po kandidatët? Ata kishin kohë që nuk ishin më të njëjtët. Të lodhur nga pritja, të jargosur nga dëshira për një përgjigje, me flokë të gjatë a të shkurtër, të dehur nga vetja dhe nga shpresat e tyre, rrinin në shtëpitë e tyre dhe prisnin radhën. Padurimi i tyre kishte marrë zë. Telefonat binin pa pushim. “Edhe sa?” “Kur do të mbarojë fustani juaj, Penelopë, që të vijmë?” Dhe pyetja që dikur vinte me respekt, tani vinte pa durim.

“Ti duhet të zgjedhësh.” Edhe fjala kishte ndryshuar. Nuk ishte më “Ju”. Ishte bërë “Ti”. Por fustani ende nuk merrte formë. Jo atë formë që do ta bënte fitimtar dhe shpëtimtar përballë gjithë

asaj zhurme, gjithë atyre pritjeve, gjithë atyre zërave që kërkonin një fund. Penelopa vazhdonte të qepte. Dhe sa më shumë afrohej fundi, aq më shumë i dukej se diçka ende mungonte.

Vendimi

Vendimin e gjyqit e mori në një nga ato ditë maji, kur zhurma e zogjve përzihej çuditshëm me krismat e armëve. Seanca ishte zhvilluar në mungesë të Odiseut. Pas disa njoftimeve të pasuksesshme dhe kërkimeve pa përgjigje, gjykata e kishte shpallur të pagjetshëm. Sekretari shtyu regjistrin drejt saj.

“Ju jeni Penelopa?” “Po.” Ajo e tha emrin pa krenari, pa trishtim. Thjesht si dikush që kishte kaluar aq shumë vite duke e dëgjuar atë emër, sa tani mezi e njihte. “Ju lutem, firmosni këtu.” Penelopa mori stilolapsin. Në korridor, ende varej njoftimi për seancën. Një letër e bardhë, e gozhduar në mur, ku emri i Odiseut ishte shkruar me të njëjtën bojë si emri i çdo njeriu tjetër. Asgjë heroike. Asgjë legjendare. Vetëm një dosje. Vetëm një numër. Vetëm një proces. Ajo firmosi. Sekretari e pa për një çast. “Sipas ligjit,” tha ai, “duhej të prisnit edhe pak.”

“Kam pritur mjaft.” “Duhej të provoheshin edhe rrugë të tjera.” “Nuk kanë mbetur.” Sekretari uli zërin. “Madje... edhe ai fustani...” Penelopa ngriti kokën. “Çfarë dini ju për fustanin tim?” Sekretari buzëqeshi me siklet. “Nuk di vetëm unë.” Ajo heshti. “E di gjithë qyteti.” Për herë të parë, Penelopa ndjeu se dera e dhomës së saj nuk kishte qenë kurrë e mbyllur. Çdo trokitje. Çdo zhurmë makine. Çdo natë pa dritë. Çdo copë pëlhure, ishin bërë pjesë e jetës së të tjerëve. “Mos vallë...” tha sekretari me zë të ulët, “... po e qepni për një burrë tjetër?” Penelopa e pa drejt. “Jo.” “Atëherë për kë?”

Ajo nuk u përgjigj. Sepse, në të vërtetë, nuk e dinte më. Mori vendimin e gjykatës, e palosi me kujdes dhe doli. Jashtë frynte një erë e lehtë. Për herë të parë pas shumë vitesh, ajo ndjeu se nuk ishte divorcuar vetëm nga Odiseu. Ishte ndarë edhe nga pritja.



Libri “Dal në portë e hyj në dritë...”, i Martin Cukallës

Legjendat e Butrintit në një vëllim poetik

Nga Ylli Pepo

Mbaj mend, kur isha një nxenës shkollë, vëllai i nënës time, Ilo Pando, ndër regjisorët e parë të filmit ne Shqiperi, sapo kish mbaruar, së bashku me kineastin bullgar Georgi Arnaudov, një dokumentar me titullin “Kënga e Rozafës”. Në premierën e filmit më mori edhe mua.

Ishte filmi i parë që trajtonte legjendat shqiptare. Që nga Rozafa në Veri, zbriste drejt Jugut, ndalte në Durrah, kalonte në Apoloni e ndalej gjatë në Buthros, ku kamera gjente një pasuri të rrallë legjendash, që trazonin jo thjesht një vend, por tërë botën antike që nga Kolkida e Medea e deri tek Troja, Hënori e Juda Iskarioti.

Pas shumë e shumë vitesh, i takoj përsëri ata në librin “Dal ne porte e hyj ne drite...” të Martin Cukalles, që vjershërimin nuk e ka profesion, por shumë më tepër: pasion e dashuri të madhe, që nuk i rresht prej 60 e kusur vjetësh.

Nga sa kuptohet, ai do të sjellë poetikisht e filozofikisht një kohë, kur janë shkruar poemat e mëdha “Iliada”, “Odisea” apo “Eneida”. Libri permбан te vjershuara pese legjenda me titujt: “Vrasja e Luanit”, “Varri i Medeas”, “Butrinti-Troja e re e Eneut”, “Vdekja e Hyut Pan” dhe e pesta me nje nentitull te cuditshem “Juda Iskarioti kerkon vendlindjen...(e pamundur te shkruhet prej meje)”

Mund të them me bindje se ky vëllim jo voluminoz (që i shkon kohës sonë të shpejtësive të mëdha) sjell plot lizem një periudhë nga më të përgjakurat e historisë së njerëzimit.

Raportet e njeriut me “tjetrin”, me natyrën apo mbijetesa, mes intrigash e udhëtimesh legjendare vinë bukur, plot ngjyra që të ngjallin përfytyrime të gjalla, thua se po shikon një film të nivelit sipëror nga pasuria e madhe e mjeteve shprehës, por edhe nga përshkrimet më të imta të ndenjave e pasioneve apo pasigurive të një kohe që ka mbetur në thellësitë më të errta të pusit të mijëvjeçarëve. E autori ka guximin por edhe zotësinë që ta nxjerrë në dritë, plot shkëlqim e lëng jete.

Poeti hyn gjithkund në enigmat, merret me këngët, baladat, legjendat mitike, bisedat erotike, ritet, rrëfenjat, këngët, betejat, çastet intime në shtrat, mortet e thashethemet, jo të mëhallës, por mes popujve të tërë. siç është rasti i Juda Iskariotit, që nuk dëshiron as ta zbulojë e as ta poetizojë.

Hyn në humnerat e mendimeve e shpjegon parandjenjat e instiktit, imazhet nën tingujt e vështrimit poetik të jetës.

Mbi të gjitha në jetën e popujve barbarë, siç i quanin helenët tërë ata që nuk ishin “të tyre”. Ndër ta, edhe popujt mbi Elladë, ilirët e lashtë e fiset e tyre të shumtë.

Ai pasqyron me art një periudhë pa kohë, në ag të njerëzimit. Ka larë me dritë, kthjellshëm si uji i burimit ngjarje personazhe, pejsazhe, udhëtime, lufta dhe dashuri të ndaluara, të lindura mes perëndeshave dhe qënieve humane.

Ka veshur me një lizem të paskaj epizmin heroik e magjik të një kohe të largët, plot lufta të ashpra dhe të egra.

Libri ka një pasuri të rrallë, shpesh

edhe të tepëruar, të mjeteve shprehëse, të figurave letrare ku spikasin metaforat e gjetura, krahasimet, hiperbolat e qëlluara, antitezat, pasuritë e rralla frazeologjike e gjuhësore të shqipes letrare por edhe asaj krahinore. Sa për ilustrim, ja një strofë, e zgjedhur jo me kast, nga “Varri i Medeas”, f. 21:

çdo gjë tretet nëpër Dhe
e humbet siç humbet mjegulla;
gurë për gurë nëpër lumë
llum e shkurë bëhet guri;
ujë ndë ujë dhe shkrin bora
nënë valë e nën të kaltër,
në burim është shushurima
tretet edhe ajo në ajër.
ndryshe fjala, rrënjë ze
dhe baret shekull më shekull.

Me këtë pasuri e shkëlqim poetik e filozofik është mbushur i gjithë libri.

Gjetje origjinale e Cukallës është edhe stili i përdorur, krejt i veçantë për një libër të kohës sonë, ku spikat mënyra e vjershërimit të poetit tonë të madh De Rada.

Autori jo pa qëllim ka sjellë vargje e teknika “alla de Rada”, duke e veshur kështu më kollaj epikën e madhe me lirizmin e rrallë deradian.

Shpesh nuk mungojnë spjegimet në prozë, në fund të faqeve poetike, për të ndriçuar e sqaruar më mirë, paqartësi e dilema historike, që lidhen me vargjet e poemave në libër.

Ato vinë si dëshmi nga burime te shumta, që autori i ka kërkuar e qëmtuar, i ka studiuar në thellësi, edhe me dyshimet e dilemat që i ja kërkon profesioni i tij parak, ingjineria e nëntokës, ku bazë janë shkencat ekzakte. Veçanërisht është ndalur tek Luixhi Ugolini, që punoi në Butrint për vite të tëra. Apo edhe tek studiuesi enciklopedik e shkrimtari filozof Moikom Zeqo që, shumë kohë më pas, shkroi hollësisht për legjendat e Butrintit.

Libri “Dal në derë e hyj në dritë” është një risi e padiskutueshme në mbarë letërsinë tonë. Atë mund ta quash pa frikë “Butrintiada”, një shembull kokëfortë se çfarë force ka pasioni, dija dhe talenti i vërtetë.

Martin Cukalla u lind në Progonat të Tepelenës në vitin 1943. Ka diplomuar në inxhinierinë e minierave, ka punuar në minierat Memaliaj, Bulqizë, Spaç si dhe në Ministrinë e Industrisë e të Minierave, Prefekturën Durrës dhe në Institutin e Minierave. Deri tani ka botuar: Poezi Paguaj Yjet, 1995; Zgjimi, 2001; Dridhen qerpikët, 2003; Magji marsi akuarel, 2004; Në shtëpinë e detin, 2006; Simfonia e erës, 2007; (Simfonia vantului në gjuhën rumune në vitin 2008, në Bukuresht); Refrene qyteti, 2008; Planeti im, 2009; Pi një kafe me mua gëzimi im, 2011; Po flas për plagë, 2012; Përrenjtë e Prillit, 2015; Hyj në Portë e dal në Dritë, 2023.

Prozë: Kosova konstruksion, 2005; Bjeshka e namun, 2010; Edhe 12 orë Kryeministër, 2012; Thjesht: Jeta, 2013

Skenare filmash dokumentare: Një Princeshë Evropiane, 2025, Medicea dhe sinagoga 2025, Të tjerat janë heshtje, 2026.

MARTIN CUKALLA

Dal në portë e hyj në Dritë

Dal në portë e hyj në Dritë

Dallgë mbi dallgë e bëhet deti...
Fjalë pas fjale e del një këngë...
Lumë kur kënga jetën mbart!
Lumë kur fjala është prej zemre-
dallgë e diell dhe... të dhemb!

Kaltëron prej skait qielli.
Flutron pëllumb i bardhë.
Buzëqesh diku De Rada
dhe më thotë: Merre në sup!

Rend e shkas, e shkas e rend...
Bëj ta kap, dot nuk e ze,
nëpër gishtat që më dridhen
veç një pendë të bardhë ma le.

Ja kështu vij në Butrint,¹
dëgjoj dallgët, vështroj retë;
trazoj ujrart në liqen,
vrapoj kodrës nëpër gurë.

Në këshjellë dëgjoj ca zëra:
britma e klithma, sikur luftë;
mjegulla që vjen prej detit
m'i fsheh tinëz luftëtarët.

Shtrihem barit përmbi vesë,
lartë yjet prushërojnë...
Bëj të fle, gjumi s'më ze.
Zëri i Lisave paska ndrruar,
zëri i Lisave qënka Zë!

Një hare më rrodhi kurmit.²
Pashë si u ngritën gurët!
Botë e moçme m'u ndërtua
si agim mbi tokë e vreshta.

Kalëronte nëpër det
uji i lashtë që e rreh era
dhe anijet shtyn nga bregu
përmbi dallgë e përmbi shkurë.

U pataksa e hodha sytë
për nga sheshi përtej shkallësh:
Veshtur në të bardha vashat
thonin këngë të moçme.

Madhështorë arbërorët
më të ndershëm bij të dheut,
më të mirët ndër njerëzit,^{*5}
kishin zenë pamjen e vrenjtur.

Nuku qenë në sheshe lufrash.
Bubullinin zëra Zotash
anë e mbanë qiellit
me zjarmi në sy e zemër!

U tromaksa e renda natës.
Renda?! Po për ku unë renda!?
Dal ne Portë e hyj në Dritë
Eshtë Legjendë! Eshtë legjendë!,-
më tha zëri i Lisit....

Varri i Medeas

Kodrat dhe deti përballë,
dita m'i kishte gëzuar
në të kaltrën e vet.
dhe me puthjet e vashës
gotë e verës ish mbaruar
dhe dielli më kish lënë.
lisi tringëllinte kitarën
në hënëzën e mbrëmjes.
dhe pata më të mirën ëndërr
për fund të ketij moti:

*

1 Butrinti është qendër banimi prehistorike.

2 varg i huajtur nga Milosao i J.De Radës

“Këtu prehet Medea
bëri jetë sa mijëra vjet
dhe nuk është në vdekje ende...
gjethëron lisi për hije
mbi të blertin shpat të malit,
aty është hije e Medeas-
dritëargjenta vesë dielli.

çdo gjë tretet nëpër Dhe
e humbet siç humbet mjegulla;
gurë për gurë nëpër lumë
llum e shkurë bëhet guri;
ujë ndë ujë dhe shkrin bora
nënë valë e nën të kaltër,
në burim është shushurima
tretet dhe ajo në ajër.
ndryshe fjala, rrënjë ze
dhe baret shekull më shekull.
yjt në qiell vendin zunë;
kraharorin e djersitur
mali thante nëpër erë;
era vet ndë gjeth të lisit
pëshpërit dhe butë dhe ëmbël:
Medheie, Medheie, Medheie ...
Nënë e Re sa të ka Hijë
shtrat i ri që bëre vatër!
*

“desha prag e desha vatër
ku të flakëronte prushi
e ku kotja t'më fanitte
arat plot nga gruri zënë!
m'a kish ënda t'i kem pranë
ditt e zëna këngë e ëndërra
për ca punëra plot magji
që për mua ishin hire...”

ulur përtej në terrinë
përballë detit është Medea.
gërshetare fjalë e saj
me puhinë e malit vjen
mbi të shkretën jetë të saj
dritë hënë shtjen e shtjen
deri sa të iki nata...

“bregut, Deti Jomikpritës
ia thosh këngës pleqërishte,
unë dëgjoja. befas Argo
nga të largëtat vënde erdhi
nëpër shtigjet plot mistere
Unë e pashë me sy të dliërë
sikur pashë kreun e zotave
mbledhur tok gjith luftëtarët
që kish bota anë e kënd
Iasen ... Iasen!,- më flit era
Iasen ... Iasen!,- fola unë,
zëri më dridhej në buzë
dhe në gji zemra m'u drodh!
Iasen zbritte nga ania.
I ndritëte shpata në dorë
dhe sytë i shkrepëtinin
sikur të qenë të Zotit
flokët e zinj i qenë përhapur
përmbi supet dielldegur
dhe buzëqeshja i vraponte
pas zërit. miqtë e vet e dëgjonin
mua helmi që më ra ndë gjak
më mallkoi e më verboi:
pashë ndë pellg hënën e re
me kurorë të diellit
dhe trimin e ëndrrave
që papritur vjen prej gjahut
edhe të godet ndë zemër
shigjet e syrit të tij
*

në mendime mjegull, mjegull
dhe e trishtë dhe e heshtur
nga deti vështron Medea
si në ankth. përtej Hënës
befas befas
këputet një yll i ndritur
edhe lëshohet ndë ujra...
lartë yjet drithmërojnë

sikur i zuri tërmeti,
Medea mu shua sysh.
I nemitur mbeta unë
ndë trungun e Lisit;
s'di se sa kohë kaloi:
qenë shuar zjarret në stane,
qenë urtuar qen e ujqër,
bota qe e tërë në gjumë!
vetem deti merrte frymë...

ja ku rishmë para meje
vjen Medea hënë e zbehtë
qarkuar kurorë drite.
si e rrahur prej murrërit
drithëroi zëri i saj:
“-te Erioptë dhe Medustë
shkova qetësova ëndrrat
që u trazojnë buzëqeshjet ...”

‘mos!, -ulurita befas unë
sa ushtoi mali përballë,-
mos bëj mëkat përmbi mëkat!
të mallkuan perënditë
të mallkuan njerzit
dhe çdo mëmë që lind një foshnjë
rishmë të mallkon!
ti je mëmë që vrave bijtë
në ca çaste zemërimi!
s’ka hakmarrje më të rëndë
se sa krimi që ke bërë!
një mëkat përmbi mëkat
është tepër...”
*

heshti gjatë. rënkonte deti
si me vaje i ngarkuar
ndë shtëpitë e Kaonisë...
pastaj tha me zë të shuar:
“nuk kanë lot të vdekurit
tu zbutin të gjallëve dhimbjet!

unë nuk pata lotë
as e gjallë dhe as e vdekur:
kujt t’ia zbutja dhimbjet?
nënë e babë që më deshën
i lashë me mëri në zemër;
copë copë e nëpër lumë
eshtrat e vëllait ndanë
edhe dhimbjen çikë çikë;
dashurinë që pata strehë,
të fshehtën e ëndërrave,
kur u gdhi e ra mëngjezi
lumi e mori për leckë
për të fshirë helme...”

heshti rishme gjatë...gjatë,
ngashërim në sup të natës
ishte frymëmarrja e saj.
kishte ndalur vallja e yjeve,
hija e grivër përmbi gurë
bënte lutje për të kthjelltën.
nëpër ajërin që flinte
shkanë mërmërimat:

“dita ndrit në dritë të vet!
natës më dha kumtin Hyu
rridhte lëng i trupit tim
nëpër ëndërrën që pashë:
trupit befas kisha gjëndërr
në kapak të zi krejt veshur
pa m’u dhimbur krejt e hoqa!

nuk më dhëmbi plaga fare
nëpër mishra çapëlyer
krejt të freskëta i kish buzët
veç i pastër e i freskët
si një curr që del nga shkëmbi.

më mbet trupi eshk e thatë
ika tinës sikur s’qeshë
hijeshi që ndrit shtëpinë
pata Hyun që më ruajti
edhe hënë në dritëbardhë
që më ruajti zemrën...”
*

“më kish rënë mbi kokë Lisi,
erë e marrë që e rrëzoi
gjethet i përhap
si të ishin të vërtetat...
shihmi pëllëmbët e duarve
këtu janë të shkruarat
e vërteta është Një
Një e s’ka të dytë:
dita kishte ngritur natën
dhe më rrinte nëpër gjunjë
vreytur e plagosur.
hyri ndë odë lasoni
sytë nuk i zinin vend
përmbi sytë e m’i.
-unë të dua,-tha,- shtërngesa

*bën të marr një tjetër grua
që të jem në front si mbret
edhe djemtë që kemi bashkë
nëpër botë me trastë në sup
të mos bredhin varfanjakë...*

akulli më ra në zemër
terri mëndjen ma mbuloi
gjunjët mu prenë të shkretët
rashë ndë këmbët e tija
ai më ktheu kurrizin
dhe s’e pashë më...

*
dhe urrejtja dhe mëria
janë në robërim të zemrës!
era brisk e zemërimit
ma përzuri dashurinë
sikur kurrë të mos kish qenë!
të gjithë ikën, m’u larguan
si të isha ëndërrliga.
përmbi gjunjët e gremisur
të dërmuar ngashërimeve
Eriopi dhe Medusi
m’u bënë shtrat i ngushëllimit...

nëpër terr dhe u kthjellova
s’mund ta lija Iasonin
t’i gëzohej shtratit tjetër
dhe të më përqeshte shtegun
më të shtrenjtë që më pat jeta:
dashurinë për Iasonin!
këngën do ia bëja lotë
buzëqeshjen do ia ngrija
zemrën do ta kish për jetë
turpëruar e lënduar...
I kish rënë mbi kokë Lisi
gjethet e tij u përhapnë
Medea buzëqeshi
ishte e hidhur buzëqeshja
dhe shumë e trishtuar
më foli me zë të dridhur:

“aty...aty është rrënja
pse unë vetvarrosa veten
në atë shkëmbin përtej!
përrallat e Euripidit
u tërhoqën zbrazdësirës
sikur mbartnin fshehtësitë
që përfundi mbajnë dertet.
ato fjalë që në skenë fliten
më bënë të neveritëshme,
ato fjalë veç u shkruan
sepse unë isha barbare
dhe sepse unë isha grua
edhe mbretërve u duhej
për të mbledhur të korrat
nëpër luftrat e Fronit...
unë të pyes ty: ata që më quajnë barbare
morën apo dhanë t’i mbaja ngashërimet?
unë vetë: dhashë apo mora
kur u arratisa në Jolk?

më quajtën magjistare
nuk isha
unë njihja natyrën në rrënjë e në degë
syri më kapte dritat që vinin nga fshehtësitë
dhe veshi m’i dëgjonte
zërat e pemëve dhe kafshëve:
nuk janë klithma a fëshfërima ere!
Unë zbuta macen
dhe shtëpinë e njerëzve e bëra me vatër
ku nuk guxonte të hynte kurkush
veç frymës së zotave dhe mikut...

lufta përherë është e egër
bën atin të varrosë birin!
Im Atë varrosi djalin e vet
dhe unë nuk isha t’i mbaja ngashërimet e tij
isha në krahët e vrasësit!
nuk mora vesh kurrë
çfarë mbeti për tu djegur nga im Vëlla
a iu bënë bashkë të gjitha Kockat
ku ngriu vështrimi i tim Mëje
kur mbi turrën e druve
nuk pa shtatin e dllirë të të Birit
po një thes me diçka brenda...

unë marroke ëndërrtare
gjeta yll, ruajta yll.
ai u tret në një shtrat tjetër
dhe asgjënë pata në dorë...

kush ma diti?! kurrë s’m’u ditën!
ndaj bëra atë që bëra
por i ruajta bijtë e mij
veç për shpirtin tim t’i kisha
tek Prasaibët Kaonë
subetninë e tyre bënë
ay janë ende



Poeti Martin Cukalla dhe kineasti Ylli Pepo

i ruaj nga ëndërrat
që buzëqeshjet makth i bëjnë...
s’kam kërkënd që më ter lotin
dhe as lotë të m’i ter era
fjalën time e merr deti
re e bën i ftohti i Hyut,
ikën tutje për në lindje
edhe zbut inatin e dherave
që i lashë e më s’i pashë...”
*

duke folur nata ikën
ra në det Ylli i Mëngjezit
rrahin krahët nëpër fletë
zogj të rrallë e të çuditshëm
unë vështroj me sytë në mjegull
si Medea hyn në shkëmb
Hyu qetas dërgon flakë
dhe qep gurët
dhe E Thëna në gjeth të Lisit
shkon me flladin që ngre Deti...

Butrinti-Troja e re e Eneut3

“Bej të fle, zemra s’më le
gjethi i ri mbuloi lisat
bora po tretet ndë male
bën të vijë e s’vjen bilbili
zemëruar retë ndë qiell
s’di pse s’hedhin
breshër rishmë.

gur dhe gur dhe u bënë muret
po shtëpia nuk ka vatër
ku të ndizet druri i lisit
dhe të piqet bukë e grurit
kur s’ka prag të fluturojë
një e qeshurë prej gruaje
mbi një të qarë fëmije.

deti shkundet, cohë e kaltër
bëhet bushtër. Ngrihet qiellit
dallgë e ujit bëhet shkumë
dhe përpin nëpër humnera
gjithë anijet hijengrysur
që guxojnë t’i ecin sipër!
S’është uji, është deti
që bën dashuri me erën!...

Ti çka bën që tryeza e shtëpisë
Të mos rrijë përherë e zbehtë?
Tek kujton vallen e lashtë
tek kujton këngën e dheut
që e zunë burrat e luftës
kur mirr zjarr vetë xhamadani,
bëje vatrënë me zonjë!

trari i jetës bën çatinë
ku dridhmon sot vaji i mëmës,
mbahet burri n’sup’n e vet
n’supin tjetër nuk ngre varre
fat’n e bardhë të derës madhe

3 *...Arkeologu italian Luigi Ugolini shprehet me bindje gati providenciale se ashtu si Shlimani që duke lexuar “Iliadën” e Homerit arriti të zbulojë Trojën edhe vetë ai, duke u bazuar te “Eneida” e Virgjilit zbuloi Butrintin. Përfundimi është i njejtë me legjendën: Butrinti është Troja e re e Eneut.

ëndërrën që ta sjell zemra
me një vashëzë dritë si dita
që agon për ngazëllim
e ndërton me hije t’vet!

ke një vatër
ke dhe rrënjë
dhe mbi krye qiell yt
ta përkund lumin e fatit...”

I.
aty unjet mbrëmjes qielli
për të ndezur yjtë e vetë.
nga gjëmbi del trëndafili
nga burimet dalin retë.
majave dëborë e bardhë
qëndron maleve kurorë.
gjelbërosh është bari i njomë
maja maja delet hanë.
blegërijnë sikur këngë
tufa qengjash tërë vitin.

mbi një shkëmb përtej një brinje
ngrirë kapronjtë të habitur
horizontin larg vështrojnë.
edhe era ndrojtje paska
të vrapojë si e marrë
gjethet lisit t’ia fërkojë
që të thuhet këngë e moçme.
atë këngë që e end fyelli
nënë frymën e Ankizit.

*ajo nuk u varros nën gërmadha!
bashkë me të vdekurit e asaj lufte
engjëjt e qiellit i nderove bujarisht
dhe ata në gjunjë këto çaste sublime
po i kërkojnë Hyut të të blatojë
në këtë natë madhështore
kur po gjallon me ajrin e Trojës së re!
nuk ishte vdekje ajo që le pas,
ishte provë mundimi e dhimbje
dhe Troja jote do jetë përmendore-
kujtesë për njerëzit që u mjafton hareja
të krrejnë hijeshinë që fle nën ullinjë e jetës...*

*ti e dhe provën me trimërinë në shpatë
dhe përkushtimin në udhëtim.
është bukur kur ati i jep birit jetën;
më bukur është kur biri i jep jetën atit
siç ti nga kurmi i plagëve
zgjove jetën e një mbreti të lavdishëm.*

*këtu në koriet e Buthros
e në këtë ditë të paharruara
Troja e re është tani në ëndrrën tënde,
Troja e re do të zgjohet nën këmbët e tua
bri liqenit ku shtozavallet kanë vallzuar
tërë natën e lume aq hareshëm
sa yjet i bënë vesë të shërosh ti plagët.*

*Buthro nuk është plagë
është shërim i plagëve
ku nuk ka mbretëri
e të pret si mbret me buzëqeshje
që ta ndërtosh botën tende të re
këtu barabar
këtu ku bije dielli çdo mbrëmje...”*

Fundviti i studimeve në Beograd dhe afrimi me Jakovin

Sa herë mbeteshim të dy, sidomos kur shkonim në kursin e jugosllavishtes, Jakovi më nxiste të flisja e të tregoja për veten time. E kishte kuptuar sa e lidhur isha me familjen, e dinte sa shpesh shkoja në postë për të biseduar me ta në telefon dhe më ngacmonte, duke më prekur te malli për ta, te kujtimi i tyre.

Qeshte kur më binin lot nga sytë duke kujtuar vëllezërit e vegjël, por sidomos kur kujtoja mëmën time, të cilën nuk e quaja "Nëna", siç e quante ai, por "Mama", sepse kështu i thërrisnim të gjithë. "Mama këtu, Mama atje". Mamaja ime ishte një nënë shumë e dhembshur dhe një mikpritëse e rrallë, jo vetëm për kushërinjtë e kushërirat, por edhe për komshinjtë apo për "mysafirët" e rastit. Ishte njeri e shpirt njeriu, të cilën, sa herë e kujtoj, më shkojnë lotët.

Atë mëngjes, Beogradi u gdhi i bardhë, me një shtresë të dendur dëbore mbi rrugë.

E soditëm nga dritarja e fjetores atë bukur të heshtur. U gëzuam dhe vrapuam të hanim mëngjes e të shkonim në fakultet. Kur zbritëm shkallët e konviktit dhe dolëm në rrugë, qëndruam pak aty, të befasuar nga peizazhi aq i bukur i rrugës, i çative, i parvazeve, i makinave, i pemëve etj., të mbuluara krejt me një shtresë të bardhë e të rëndë dëbore.

Papritur ndjeva të ftohtë dhe një top bore që më ra në fytyrë e u shkërmoq mbi flokë. Pastaj rrëshqiti ngadalë në qafë, duke më mërdhirë gushën e më pas gjithë shpinën.

– S'ka të lahesh te Mama sot! Lahu me borë! – thoshte e qeshte Jakovi me gjithë zemër; gajasej, duke më bërë pjesë të lojës me topa bore, që m'i hidhte në sy, në faqe e në flokë, e pastaj ua vërviste edhe të tjerëve aty afër. Edhe unë fillova të qeshja, e kuqe flakë, dhe u përkula të rrëmbeja borë e të bëja me të topa, për t'ia hedhur atij dhe të tjerëve, që ndërkohë ishin futur në lojë.

Qeshëm e luajtëm ashtu për një kohë të gjatë, të gjithë ata që u ndodhën aty ose u bashkuan me ne, të skuqur nga loja dhe bora, në atë skenë gëzimi, ku unë ndoshta isha skuqur më tepër se të gjithë.

Ishte një ndodhi shumë e bukur ajo lojë për mua dhe do të mbetet e tillë derisa të jem gjallë. Bora e hedhur nëpër flokë e në fytyrë, si për të më larë me ujë bore, ishin preket dhe afrimet e para me Jakovin, ashtu si edhe ajo skuqe e imja, që fshihej e justifikohesh me të ftohtin dhe me efektin që sjell bora.

Por çdo "prekje" ishte aq gjë e re për mua, aq gjë e bukur, e panjohur dhe e pafajshme, sa e tillë ishte edhe "përskuqja" ime, e cila më dukej sikur vihej re nga të gjithë, e sidomos prej tij.

Sikur ajo skuqe fliste më tepër se aq...

Gjatë kësaj kohe kishte filluar korrespondenca me familjet tona, si dhe me shoqet e shokët në atdhe. Unë merrja shumë letra. Më shkruanin të gjithë me radhë: prindërit, motra, kunati, vëllezërit, xhaxhai etj., etj., ndonëse, siç u kisha thënë, unë u drejtohesha të gjithëve me një letër të vetme, duke i përmendur me radhë, nga gjyshja e deri te vëllai im i vogël.


Në shtrat, vonë në mbrëmje, rrija me sy mbyllur dhe i shihja në mendje, të gjithë bashkë në darkë, me lugët e çorbës përmetare, gatuar me gjithë lezet, me kërcëka dhjami të skuqur, me gjalpë e djathë Përmeti përsipër.

Dhe ashtu, sikur i shihja teksa rrinin e dëgjonin babanë, atë gjigant gati dymetrosh me flokë të bardhë, kur lexonte ngadalë letrën time. Ata rrinin e prisnin në heshtje të përmendshin në letër...

Këto nuk ishin thjesht ëndrra të mia, por ashtu siç ma tregonin vetë, njëri pas tjetrit, në letrat që më dërgonin.

Ndërsa për babanë do të më duhej ndoshta një roman për ta përshkruar.

Tefi Tako, kështu quhej babai, kishte filuar të bëhej "i famshëm" edhe në Tiranë, por tashmë "fama" e tij kishte marrë tjetër kah. Nga "fama" si ish-mësues në Përmet e në medresenë "Stambolli", papritur, me një dekret të Mbretit Zog për mësuesit kudo që ndodheshin, kishte dalë në pension të parakohshëm për kushtet e asaj kohe, duke përfutur një shumë ekonomike mjaft të mirë, me të cilën mund të



jetonte ose të ngrinte një punë.

Dhe ashtu bëri edhe im atë, ai njeri me energji të pashoqe, që, ndonëse me një dorë, jo vetëm bënte gjithçka me të, por iu fut edhe biznesit. Ai e investoi atë "pasuri" të vogël, duke ndërtuar i pari, historikisht, dy dyqane dhe një magazinë, si edhe më pas dy shtëpi, që janë ende sot te rruga e "Shkollës së Kuqe", ku banojnë djemtë e tij dhe motra ime.

Ai u bë ndoshta "importuesi" i parë i djathit dhe i verës së famshme përmetare në Tiranë. Aq i suksesshëm u bë ai biznes, sa babai u shndërrua në një nga tregtarët më të njohur të asaj kohe dhe hapi edhe një dyqan-lokal pranë ish-barit "Vollga" (afër Bashkisë së Tiranës së sotme). Sa ishte gjallë, ai arriti të ndërtonte edhe dy shtëpi, njërën prej të cilave shteti ia shtetëzoi pas luftës.

Siç po thosha, të gjitha ato lajme se si i prisnin ata letrat e mia i merrja edhe nga mama, e cila m'i rrëfente më pas gjerë e gjatë, kur kthehesha në shtëpi gjatë pushimeve të verës. Madje më tregonte se si mbledhte herë pas here ish-shoqet e Pedagogjikes, që vinin tek ajo, dhe u fliste për mua, sidomos kur u dërgoja të fala në çdo letër.

Ndërsa Jakovit i shkruante vetëm i ati nga Tirana dhe vëllai nga Parisi, i cili i dërgonte ndonjë kartolinë herë pas here.

Ai bëhej kureshtar-ndoshta ishte delli i tij prej shkrimtari, siç do të dëshmohej më pas-dhe më pyeste vazhdimisht për të gjithë ata që më donin po aq sa i doja unë dhe që më shkruanin aq shpesh.

Dhe unë i tregoja. I tregoja për të gjithë; i tregoja edhe për shoqet e mia. Ai dëgjonte dhe sytë e tij të butë bëheshin edhe më të tillë, duke marrë një hijeshi dhembshurie që mua më mallëngjente, sikur t'i kishte vetë ai ata vëllezër, atë motër, atë baba e atë mëmë.

Sa e sa detaje të tyre, të prindërve, të të

afërmve e të ish-shoqeve të mia, i gjeja më pas në personazhet e veprave të tij. Dhe ndieja një kënaqësi të parëfyeshme t'i tregoja pa u lodhur.

Një ditë, kur po niseshim për në kurs, na shpërndanë postën. Më dhanë edhe mua një letër.

– Nga e ke? – më pyeti Jakovi, kur u nisëm. – Nga shoqet e klasës, – iu përgjigja dhe e futa letrën në xhepin e çantës.

Ishte nga ato çantat me zinxhir sipër e anash, që mbanin libra e fletore në hapësirën kryesore, ndërsa në xhep shami, lekë, kalema e ç'të kishte njeriu. Rrugës ndieja sikur çanta po më rrëshqiste dhe e rregulloja nën sqetull. Një herë madje e mora në dorë, sepse më ra përtokë. Kur e ngrita, pashë se xhepi i saj ishte hapur. Nuk vura re asgjë që të më tërhiqte vëmendjen. Isha me shoqet. Jakovi nuk e di se ku kishte humbur.

Kur mbaruam mësimin dhe po ktheheshim në konvikt, ai m'u afrua. Sa i gëzuar ishte!mSa i qeshte fytyra, buzët, krahët, duart! Qeshte e qeshte me gjithë shpirt. Unë nuk po e kuptoja ç'kishte ndodhur, kur ai papritur më nxori letrën, të cilën unë ende nuk e kisha lexuar:

– Aaa, tani i mora vesh ato zonat tuaja të preferuara, – qeshte ai. – Edhe atë zonën tënde të preferuar tani e di...

Ia rrëmbeva letrën nga dora dhe u largova me vrap, për t'u futur mes shoqeve.

Bashkë me to hyra në konvikt e më pas në mensë. Ai u ul përballë meje. Fytyra i qeshte ende. Ndonjëherë ulte sytë, sikur lëpinte buzët dhe përpiquej të bëhej serioz. Unë po pëlcisja nga kureshtja se çfarë më kishin shkruar shoqet e klasës.

Pa mbaruar mirë darkën, dola nga mensa, ngjita shkallët dhe hyra në fjetore. U ula, duke e mbështetur shpinën te hekuri në fund të

shtratit, dhe fillova të lexoj. Sapo e mbarova, u shtriva dhe fillova të kujtoj.

Ishte fundi i ditëve në shkollën e mesme, që atëherë quhej Shkolla Pedagogjike, ose thjesht Pedagogjikja, aq e njohur ishte bërë.

Para provimeve të maturës, drejtoria vendosi të organizonte një piknik. U caktua edhe vendi. Sa u gëzuam të gjitha, sidomos ne maturantet, që e kishim vitin e fundit në atë shkollë dhe bisedonim dhjetëra herë mes nesh për ndarjen e ardhshme, si dhe për jetën që na priste më pas.

Ishim njëzet e një maturante, shumë të lidhura me njëra-tjetrën. Kishim hyrë të gjitha bashkë që në klasën e parë (sot do t'i korrespondonte klasës së pestë), më shumë se tri-dhjetë vajza. Vitet kaluan dhe ja, kishim arritur në përfundim të mësimeve në atë shkollë, të cilën e donim shumë dhe me të cilën ishim aq të lidhura. Unë, të paktën, ashtu e përjetoja me dhimbje atë ndarje, dhe mendoj se edhe shumica e vajzave maturante e kanë përjetuar po kështu.

Gjithë ato vite pjesëmarrjeje në mësime e provime, në aktivitete të ndryshme shkollore, ekskursione, madje edhe në demonstrata të ndryshme, përfshirë ato patriotike, me shumë pak përjashtime, na kishin lidhur edhe më shumë me njëra-tjetrën. Dhe ja, tani ishim vetëm njëzet e një, më shoqe se kurrë, që shqetësoheshim për njëra-tjetrën, për ecurinë dhe provimet e fundit, dhe ndihmonim njëra-tjetrën që ta merrnim të gjitha diplomën sa më mirë.

Edhe pedagogët, duke na parë aq të lidhura me njëra-tjetrën, duke dalluar te ne gëzimin e jetës, shpresat për të ardhmen, gjallërinë e moshës nëntëmbëdhjetëvjeçare dhe ëndrrat tona, na çmonin e na respektonin. Nuk kurseheshin të na ndihmonin me konsultime, libra e gjithçka tjetër që mund t'u kërkonim. Dhe ashtu u rritëm e u zhvilluam edhe në saje të asaj shkolle të mbarë, të disiplinuar dhe me mësues shumë të mirë.

Ajo ditë dhe ai piknik i fundit së bashku ishte edhe kulmi i jetës sonë shkollore. Me entuziazmin tonë dhe etjen për të ditur, kishim mbërritur në ditët e fundit të asaj periudhe të bukur.

Nga të gjitha ato vajza, shtatë prej nesh ishim edhe më të lidhura, gati sikur jetonim me njëra-tjetrën. Aq shumë rrinim bashkë, aq shumë studionim, flisnim e gajaseshim për gjërat tona femërore, madje edhe për intimitetet rinore apo çdo ndjenjë e ëndërr që kishte shpërthyer në vajzërinë tonë. Edhe bankat në klasë i kishim pranë e pranë dhe ashtu qëndronim, në shkollë e jashtë saj, përherë së bashku.

E kështu, atë ditë pikniku, luajtëm, u hodhëm sa mundëm, u gëzuam dhe gjetëm edhe çastin për t'u ulur vetëm ne të shtatat. Gjetëm një përrua të vogël aty afër dhe fre skuam këmbët e duart, qafën e fytyrën. Brodhëm buzë atij përroi, sa poshtë e përpjetë, dhe arritëm te një kodrinë e mbuluar me bar të blertë e të pashkelur, që sikur na ftonte të shtriheshim mbi të, me sytë drejt qiellit të kaltër.

Aty u ulëm, pranë e pranë njëra-tjetrës. Njëra thërriste:Shikoni atë kodër, sa e blertë është! -Tjetra:-Ej, shihni pak atë shkëmbin e bardhë mbi përrua!-Një e tretë: -Vështroni, vështroni ç'bukuri ka ajo ara atje përtej dhe si zverdhon gruri në të! Një tjetër: -Po ato delet në atë lëndinë përtej përroit? Po qengjat që rrinë pranë, a nuk janë mrekulli!-

Flisnim gati me një frymë, derisa u lodhëm duke admiruar bukuritë e peizazhit dhe u kthyem në bisedat tona kokë më kokë, në ato çu-çu-çu-të me zë të ulët, duke qeshur e gëzuar në mënyrë të përmbyajtur.

Ah, harrova! Recituum vargje nga "Bagëti e bujqësi" dhe "Anës lumenjve", e në fund u shtrimë në formë rrethi, me kokat pranë njëra-tjetrës, dhe nisëm të bënim lojëra të ndryshme me fjalë.

E kur s'e prisnim, Bali thirri: –O goca, a jeni mendu se çfarë do bajmë, sa t'i marrim diplomat?– Po, mund të fillojmë punë! –ia ktheu Meli. – Po edhe studimet mund t'i vazhdojmë! –ia priti Agimja. –Mua do të më pëlqente shumë kështu, –thashë unë, duke qenë në të njëjtin mendim me Gimjen. –Po si, çfarë kështu? –më ngacmoi Bali. –Po ja, pra, të vazhdojmë studimet! –fola, duke vështruar buzagaz përqeshjen dashamirëse në sytë e saj, sikur përpiqeshin të thonin: –Aha... po, studimet... –Po tjetër, tjetër?- vijoi me zë Gimja. –Po ja,

mund edhe të fejojemi! –ia priti Arta, si të mos duronte dot. –Uuuu! –u hodh sikur mezi priste Gimja. –Hajde t’i ndajmë zonat për secilën, e sakën se dikush e shkel!

–Hë, pra, këtu e kisha llafin, –çfoli Bali, –se po na dukej sikur do të bëheshim të gjitha dhaskalica e shkencëtare, tani që mosha po na troket te porta... –Mirë e ka! –ia mbajtën me një zë Drita e Zenia, duke na bërë të gjithave të qeshnim përsëri. –E po, ç’mund të themi, kur akoma s’na ka trokitur kush te porta! –u hodh e ngacmoi përsëri bisedën Gimja. –Ja, unë e di, –tha Safoja, më e hedhura midis nesh. –Gimja me siguri do të martohet me ndonjë doktor! Kjo është zona e saj. –Kurse ti, –ia ktheu Gimja, –do të pleksesh me ndonjë avokat a profesor. –Kushedi, pse jo! S’e ke keq, –ia ktheu Safoja. –S’do të ishte keq, vërtet! Ama Meli sigurisht e ka zonën me ndonjë artist...-

Qeshëm përsëri të gjitha, duke kthyer kokën nga ajo.

– Po Dhurata? –thirri Bali, duke qeshur e duke më ngacmuar me sy. –Në ç’zonë do të na shkojë kjo çupë, si thoni?-

Ajo kishte një të qeshur të këndshme e të çiltër. –Dhurata...– u hodhën njëzëri tri nga ne, –e po Dhurata dihet, me poet, shkrimtar a filozof, me ç’tjetër mund të plekset! –Aaaa, zonën e filozofit lërrjani Zenës dhe Dritës! Jepi Dhuratës ndonjë inxhinier a ndonjë nëpunës të lartë e hijerëndë! –e mbylli, midis të qeshurash, Safoja.

E kështu, duke folur e duke përcaktuar secila “zonat” për njëra-tjetrën, përfunduam si përherë në të qeshura, duke mbajtur ijët me dorë. Të gjitha këto m’u kujtuan, kur lexova letrën e Safos e të Balit. Kuptohet, edhe thumbi i tyre...

Prandaj dhe Jakovi qeshte e fliste, fliste e qeshte për zonat e preferuara! Paska pasur të drejtë. Po si vajti e qëlloi pikërisht kjo letër në duart e tij. Oh, sa maraz më erdhi, që kjo letër kishte përfunduar në duart e tij! Ç’të bëja pas kësaj?! Si ta shihja në sy Jakovin?

Dhe të nesërmen, si dhe ditë të tëra me radhë, bëja çmos që të mos mbetesh vetëm me të. Ai e kuptonte, buzëqeshte e nuk bënte përpjekje për të më shkëputur nga rrethi ku ndodhesha, por sa herë sytë e mi takonin vështrimin e tij, ai vinte buzën në gaz dhe sytë i qeshnin e i dukeshin edhe më të butë, edhe më të ëmbël... më të afërt...

Ndieja sikur po më merrej fryma dhe bëja çmos t’u vidhesha vështrimeve të tij, si dhe ndjenjës sime që po rritej...

Ndonjëherë, kur ai më shihte vetëm në mensë a në korridor, më avitej si fshehtas e më fliste në vesh e më kujtonte atë “zonën” e preferuar, ndërsa unë, pa e ditur ç’të bëja, ikja e largohesha ku të mundja.

Ndoshta është ndonjë nga këto ditë ky shënim, hedhur nga ai, por që unë e lexova shumë më vonë, në një ditar të tij: “Dh dhe J janë dy studentë. Që të dy të sjellshëm dhe sentimentalë. Një mbrëmje, në sallën e mësim-it, qëlluan të dy përballë. Ishin duke lexuar në gjuhën e huaj, kur Dh-ja vihet në siklet, se nuk kishte fjalor. J-ja kishte dhe që të dy kishin për të përkthyer leksionet në lëndët e tyre. J-ja e vë fjalorin e tij në mes. Dh-ja pret ta përdorë më parë J-ja. Edhe J-ja pret ta përdorë më parë Dh-ja. Të dy qëndrojnë e presin njëri-tjetrin, me gishtërinjtë ngulur në fjalët që s’i kuptojnë. Përkthimi nuk u shkoi mirë që të dyve, ndërsa fjalori rrinte gjithnjë në mes, pa e prekur kush. Asnjëri nuk zgjaste duart. Atëherë J-ja qeshi e tha: –Po shkoj të kërkoj një fjalor tjetër”.

–Ke marrë ndonjë letër tjetër nga shoqet? –më pyeti ai një ditë në mensë, teksa u ul pranë meje.

–E pse pyet? –ia ktheva dhe ndjeva se u skuq. –Më duket se do të gjesht shkak për të vazhduar të qeshësh, siç bëre ditën që më “vodhe” letrën. –Më çudit ajo letër, të them të drejtën! –foli butë, pa u ngacmuar e paksa serioz, por me buzëqeshje. –S’më kishte rënë rasti të dëgjoja një intimitet të tillë vajzash. –S’e besoj se jemi ne të parat, që e kemi bërë atë që lexove apo edhe që qeshim në parashikimin e fatit të njëra-tjetrës, –thashë ngadalë. –Sigurisht që jo! –foli ai. –Por më bëri përshtypje kërkesa me këmbëngulje dhe përcaktim, që njeriun e ëndrrës ta lidhni me profesionin e tij.

–Po pse jo, Jakov? Unë mendoj se gjëja më e bukur do të ishte që dashuria të lindte aty ku ëndrrat, për të bërë më të mirën në profesion, të mund të përputheshin. Më mirë, me pro-

fesionin... –po flisja si në kllapi dhe papritur më hipi humori t’ia ktheja me të qeshur. –Se kushedi pastaj si do të kishte vajtur, si do të ishte gajasur me ne, sikur të ishim shprehur me emra për njerëz konkretë...

Vështrova atë dhe pashë se ishte si i menduar, por duke buzëqeshur.

–Po pse, –vazhdova me të njëjtin zë, –ty, për shembull, s’të ka rënë rasti të mendosh ndonjëherë për njeriun që do të lidhësh...? –e pyeta duke e vështuar.

Ai vazhdonte të buzëqeshte. –Se ato të shokëve të tu s’kam ku t’i gjej, nuk di ku ti i fsheh...– fola përsëri. –Por më trego ti vetë, diçka!

Dhe ai më tregoi për një vajzë, si dhe për një tjetër, që nga karakteri ishin më shumë si djem sesa si vajza. Më foli gjatë. Foli seri-ozisht e me sy të menduar e të butë, si përherë kur i bëheshin të menduar.

Këto vajza i gjeta më pas, në dorëshkrimin, në faqet e në kapitujt e romanit “Lulja e kripës”.

Një ditë po kthehesha në konvikt, me një rrjetë me ca gjëra që sapo kisha blerë.

–Ç’i ke ato? –më pyeti Valentina. –Kam blerë nja dy kilogramë sheqer e dua t’i dërgoj në shtëpi. Janë kallaballëk e s’u del ai që u japin me triska! –iu përgjigja. –Ehu dhe ti, ç’harxhon kohën kot! –ma ktheu ajo. –E po s’ke faj ti, –i thashë, –vetëm prindërit dhe motrën në shkollë ke. Pa mendo mua! Në shtëpinë time, së pari, janë herë dy a herë tri, që s’e shtynjë dot ditën pa kafe. Pa është gjyshja ime e mrekulueshme, që e dua fort. Pa është një kushërirë e parë e babait, që jeton me ne, se është krejt e vetme. Një vajzë që ka, është martuar e jeton në Amerikë. E ti e di sa mundësi ka ajo, që të takojë të bijën dhe mbesat... Është edhe halla e mamasë, e ajo një e dy ikën nga fshati e vjen e gjen strehë te ne. Pa janë vëllezërit e mi, që po rriten. Pastaj, kush nuk e do sheqerin? –qesha unë në fund. –Kështu që ja, mendova t’i gëzoj, meqë niset nesër për Tiranë një mik i kunatit.

–E po edhe ti, me gjithë ato probleme që ke, të shkon mendja te sheqeri për familjen, –më tha edhe Kthansipi, sa unë u ndjeva keq, sikur të kisha bërë ndonjë gabim e s’fola më, por u ngjita lart në fjetore.

Pas ngrënies, kur po dilnim nga mensa, më ndaloi Jakovi e më pyeti: –A ka mundësi, që ata dy kilogramë sheqer të bëhen tre? –Edhe ti e paske marrë vesh punën e sheqerit? –pyeta me të qeshur. –E dëgjova në mensë. Dikush po të komentonte. Për mirë, sigurisht! –Po ku ta gjejë më pas babai familjen tënde? –e pyeta me vështrim. –Shiko, është shumë e kollajtë,–, ma ktheu Jakovi, –prandaj dhe po ta kërkoj këtë favor. Mu te kisha ortodokse jetojnë disa familje... S’është shumë larg. Atje të pyesë për Nasi Xoxën dhe ia tregojnë menjëherë! –përfundoi. –E po mirë, –ia ktheva. –S’qenka e vështirë. Edhe im atë aty pranë e ka dyqanin.-

Jakovi shkoi në një dyqan afër dhe bleu sheqer. E kështu e nisa pakon me sheqer e hallvasi për Tiranë.

Aty, afër konviktit tonë, përballë, në një qoshe, një shqiptar nga Kosova kishte hapur një dyqan të vogël me karamele, bozë e ëmbël-sira. Ai mbante edhe hallvasi, e herë-herë atje blinin edhe ne studentët. Atij i bëhej shumë qejfi, se na fliste shqip dhe ne ia kthenim.

Pas ca ditësh, babai më dërgoi një lajmërim për një bisedë telefonike. Nuk mund të mos them se sa shumë më mallëngjenin ato biseda telefonike! Shumë!

Kur folam me të, ai më falënderoi për sheqerin dhe më tha se e kishte mbaruar edhe atë porosinë për shokun tim. Mua më erdhi si zor, që në atë bisedë të shkurtër, ai u kujtua më shumë te porosia e përmbushur e Jakovit, sesa tek pyetjet e mia për të shtëpisë.

Më vonë, ai më shkroi në letër gjerë e gjatë, si ua kishte gjetur shtëpinë prindërve të Jakovit dhe si ishte njohur me ta, të cilët, nisur nga mbiemri, i kishin folur babait për atë kru-shqinë e vjetër të mbesës së tyre me doktorin, kushëririn e tim eti. Atë histori, të cilën Jakovi ma kishte përmendur në traget, kur ishim njohur.

Por çudi për mua ishte se edhe babai i Jakovit i kishte shkruar gjithashtu të birit gjerë e gjatë për njohjen me babanë “e asaj shoqes sate”, e se si tani, madje, kthente rrugën e i shkonte në dyqan, si për ta pyetur për ndonjë letër nga Beogradi apo edhe për të blerë ndonjë shishe verë a raki.

Kështu, për habinë time të papritur, famil-



ja e tij që afruar me timen. Nga të dyja anët e kishin parë me simpati e mirësjellje njëri-tjetrin. Edhe babai, tashti, kur mbyllte dyqanin për të shkuar diku, kishte filluar të kthehej në shtëpinë e tyre, ku bënin pak muhabet e pinte edhe ndonjë kafe. Dhe që atë ditë, kur bisedonte me mua në telefon, për çudi, më pyeste edhe për Jakovin, si me qëllim që t’i njoftonte edhe prindërit e tij.

–Më vjen keq për ta, –më shkruante në një letër, –se janë me dy djem e jetojnë vetëm. Aq më tepër, që janë edhe të kaluar në moshë!-

Më vinte çudi se si të mitë, por edhe të Jakovit, po i jepnin atë vëmendje miqësisë sime me Jakovin dhe se si një rastësi e çastit (sheqeri!) u bë edhe shkas që baballarët tanë të takoheshin herë pas here, me pretekstin për të marrë e dhënë lajme nga fëmijët e tyre në Beograd.

Dhe me këtë pretekst dukej qartë që dy familjeve po u pëlqente miqësia jonë në Beograd, sa filloi dhe u pëlqeu edhe ajo miqësi midis tyre. Tashmë ata ishin takuar edhe si familje, e jo vetëm babai i tij me babanë tim.

Por koha ime, sigurisht, ishte më e kufizuar, se më duhej të studioja statikën, të plotësoja boshllëqet e fizikës për të arritur të tjerët apo të humbisja në ushtrime për të zgjidhur integrale e derivate, që deri atëherë s’ua kisha dëgjuar ndonjëherë emrat e më duhej të isha përherë vetëm, ose të kërkoja ndihmë te një shoqëri që s’kishin të bënë fare me të. Por, në fakt, problemi im ishte vizatimi. Ushtrimet në vizatim as më vjen t’i kujtoj, aq shumë përpiquesha dhe po aq shumë ndieja se s’do t’ia dilja dot kurrë. Dhe kështu shqetësohesha shumë, kur e shihja veten se sa të pamundur e kisha atë lëndë. Dhe ky shqetësim thellohej çdo ditë, kur vija re se, as me vizatimet e lira e as me ato që i bëja me ndihmën e shoqeve (siç na i kërkonin çdo javë), kuptoja se vërtet nuk ia thosha dhe as isha e prerë për të bërë me sukses ato detyra që kishin të bënin me atë lëndë. E të mendosh se shpesh, me gjithë faktin se “vinin dorë” shokë apo shoqe, prapëseprapë në to jo vetëm që nuk kishte “art” (vizatimi i lirë është i tillë), por as si vizatime teknike, që ishin materialet kryesore në atë lëndë, ato nuk shkonin siç duhej.

–E di si dukesh ti, Dhurata? –më thoshin shoqet jugosllave. –Si ato vajzat që i fejojnë me djem që s’i njohin, sikur u japin burrë me zor, e zënë ndonjë qoshe e qajnë ditë e natë! –Po, ashtu ndihem vërtet! –ua ktheja. –S’e kam dashur kurrë këtë drejtim vizatimi!-

Ndërsa vizatimi teknik, ku përdornim tri vizore të zakonshme si dhe një format të madh në formën e T-së së madhe, nuk më dukej dhe aq i pamundur.

Një mbrëmje hëngra darkë shpejt dhe u futa në vendin e studimit me njëfarë ankthi, ku më duhej të kryeja një detyrë vizatimi jo të thjeshtë për të nesërmen. Papritur dëgjova zërat e shoqeve të mia:

Despina: -Më duket se Dhuratën e ka zënë qymyri. Si shumë po rri me Jakovin. Kthansipi:

-Jam e bindur, por jo vetëm Dhuratën! Mua më duket se simpatia e tyre është reciproke. Shpresa: -Po, vajza, edhe mua kështu më duket! Jakovi shkon nga shkon, veç kur e gjen afër saj. Despina: -S’e di! Ia hodha fjalën Jakovit, por ai nuk ma zgjati. Iku pa folur, disi i bezdisur prej fjalëve. Por, në fakt, është djalë vërtet simpatik. Kthansipi: -Ikim, se u bë natë, e të mos mbajmë shoqet në gojë. Të mirën ua duam të dyve! Despina seç po thoshte me zë më të ulët, kur Shpresa ia ktheu: -E po ngandonjëherë, vajza, kështu nisin gjërat. -Shpejtoni të ikim! –ua preu Valentina me zë më të largët dhe zërat e tyre pas pak u shuan...

I shihja me mendje, se si Kthansipi shkonte në shtëpinë e saj, ndërsa të tjerat, duke çuquritur, futeshin nëpër fjetoret e katit të dytë dhe të tretë.

Mbeta vetëm. Me mua mbetën vizatimet, ankthi im për to, si dhe jehona e fjalëve që dëgjova më parë.

-Edhe këto më duhen! –pëshpërita me vete e fillova të përlohem. –E paskemi dreqosur këtë punë, siç duket, duke ndenjur bashkë. Por ne shoqëri kemi, e ç’të keqe ka këtu?-po mundohesha që qetësoja veten, por edhe ta justifikoja. Por duke e ndier se, në fakt, kishte “diçka” që po përpiquesha t’ia fshihja vetes e nuk po mundja, diçka që më fliste të ktheja vëmendjen në atë që po fillonte të ndieja kur mendoja për të.

Por, aty për aty, më vinte ngrohtë në zemër, që tashmë, edhe në sytë e të tjerëve, nuk ishte “iniciativë” vetëm e imja të rrija me të, por edhe e tij. Dhe se të tjerët kishin filluar ta shihnin këtë jo vetëm si një shoqëri të thjeshtë.

–Por ai është vërtet simpatik...– filluan të më vinin në mend fjalët e Despinës. Po, kështu kishte thënë për të: -Është shumë simpatik,-kurse për mua asnjë fjalë.

Nuk mundja më të vazhdoja punën: “disi i bezdisur, shumë simpatik, e ka zënë qymyri...” – më oshtinin veshët. I mblodha fletët e vizatimit, vizoret, lapsat, i vura nën sqetull dhe u ngjita lart në fjetore. Në dhomë gjeta Behijen. Vështimisht e natës dhe u shtriva. Përpiquesha të mbaja sytë mbyllur, të numëroja, të sillja në mend njerëzit e shtëpisë, ndonjë ngjarje të gëzuar, por nuk ia arrija dot.

-E ka zënë qymyri... është shumë simpatik... disi i bezdisur...– më vinin vazhdimisht në mendje, duke kërkuar t’i prapësoja këto fjalë në kujtesën time.

-Mos ia shto vetes problemet, mjaft kam hallet e studimit, – vazhdoja pastaj. – Nga nxënës në tabelë nderi, tani studente me probleme...”.

Pastaj përsëri m’u kujtuan fjalët e Despinës. U përpoqa të zemërohesha me të, pastaj me Jakovin dhe ia arrita disi qëllimit, e kështu, më në fund, më mundi gjumi.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Kopshtin pas shtëpisë, babai e mbillte veçse Krrush. Më të shumtën e bënte raki kurse çka mbetej e hanim ne. Ende pa filluar vjelja, detyra e nënës ishte ta ruante se mos e hanim pa karar, apo shpërdoronim, si thoshte babai. Edhe pse im atë nuk ia kursente spërkatjet, shpesh rrushi kalbej sa fillonte pjekja, ndaj niste vjelja pa hyrë shtatori. Mua më pëlqente të kaloja kohë mes vreshtit ku vetja më dukej si ata shkrimtarët e famshëm të cilët shkonin në det apo në mal për të krijuar.

“Nëse vonohet vjelja apo fillon vapa e murrme, -thosh babai, - prite kur rrushi të bjerë përtokë e të mbetemi pa pikën e rakisë!” E kujt i bëhej vonë se nuk do të zienim raki, kur atë e pinte veç ai e ndonjë mik i tij kur shkelte për vizitë! E urreja rakinë, pasi më dukej se ajo ishte mollë sherri mes ne të gjithëve e tij nesh. I vetmi argëtim për mua, atje mes vreshtash, ishte Egla, e reja e Sofies, fqinjës sonë më të hershme. Kopshtet tona shihnin nga njëri-tjetri. Egla kishte veç katër muaj nuse në atë shtëpi por hynte e dilte e zhdërvjellët, sikur të ishte rritur aty. Flokët plot onde e të lyer me këna i tundeshin bashkë me vithet, si të kishin në mes një hendek. Lodronte me ajrin si një shtojzovalle. Jo pak herë kishim këmbyer edhe ndonjë fjalë përsëritëse te gardhi. Kishte një të folur pak hundore çka tregonte se nuk ishte nga anët tona. Aq bukuri rrezatonte, sa kur më afrohej, më shumë belbëzoja e skuqesha se sa thoja ndonjë fjalë të mençur. Përgjatë gushtit e shihja shpesh të vilte gjithë mundim fikun e bardhë që kishin kufitar me ne, ndaj një ditë i ofrova ndihmë. S’di pse trembesha, se mos binte, pasi sipas nënës sime hija e fikut ishte e rëndë dhe rrëzimi prej andej kish’ pasoja fatale për jetën.

Edhe pse ishte shumë e bukur, ajo ishte martuar me Sandrin, një djalë sa i ngathët aq edhe i ngurtë si shtyllë elektrike, a thua e e zinte gjumi në këmbë. Kaq vite fqinj nuk ia kisha dëgjuar kurrë zërin sa u binda se ishte memec. Për çdo ditë e shihja nga barku Eglën, se mos po i rritej, pasi zakoni e donte që fill pas dasme, të vinte fëmija.

Kështu që, ditën që pranoi ndihmën time, kapërceva gardhin dhe iu afrova fikut me një trajstë bezeje në krah. Edhe atë ditë si herë të tjera ajo u mbështet te druri i fikut, duke i kthyer shpinën shtëpisë së saj e nisi të lodronte me duart duke këputur gjethe fiku, dhe qeshte me vete.

-A të vjel shumë? – e pyeta duke ia ngulur pa turp sytë fytyrës së saj të bukur.

-Jo, jo, zbrit tani se vjelim neser përsëri, - ma priti.

Më pas hyra në shtëpinë e saj për të larë duart. I elektrizuar i gjithi nga mendimi se isha vetëm për vetëm me të, harrova për çfarë hyra, dhe nisa të kontrolloja me sy rreth e qark për njerëz tjerë. Më mbushi një gotë lëng trëndafil të ftohtë e më ftoi të ulesha pranë saj. Më hodhi krahun në qafë e më foli kaq ëmbël sa gati po dehesh. Në ditët që pasuan, kjo filloi të përsëritet sa herë nënë Sofia largohej nga shtëpia dhe Sandri ishte në punë. Herë më pyeste për mësimet, për profesionin që doja të zgjidhja kur të rritem apo nëse pëlqeja ndonjë vajzë në shkollë a në lagje.

Digjesha nga dëshira për t’i treguar gjithë të fshehtat e mia pasi në një farë mënyre doja të dukesh më i rritur e më i fortë se sa isha vërtet! Më kuptonte më mirë se moshataret e mia. I shoqi punonte roje nate te “frigoriferët e tregtisë”, 24 orë në tri ditë e në ditët pushim vetëm flinte. Nga sa kuptova, në katër muaj martesë, gjithë gjithë kiwhin kaluar një muaj bashkë.

Ajo më tregonte për familjen e vet, për ëndrrat e saj si piktura dhe fëmijët. Herë-herë qeshte me të madhe me shakatë e mia si të më kishte moshatar e herë më shtrëngonte pas vetes si fëmijë

-Sa ti, kam vëllanë.-më tha teksa iu afrau dritares së kuzhinës që binte në kopësht. Më pas iu mekën fjalët e mbushi sytë me lot. Ndoshta e kishte marrë malli për të vetët. Ndoshta edhe mua ndaj më afronte!

Si u përhumb pak çaste, më tregoi se ishte grindur me të vjehrrën. Filloi të mallkonte



ditën që ishte martuar me të birin, dhe shkak të asaj martese të dështuar quante të ëmën. Diçka kisha dëgjuar nga ime më, që nënë Sofia e kishte zgjedhur vet nusen e të birit nga një fotografi e mbesës së saj. Nuk i kuptoja shumë këto gjërat e grave, as arsyen pse për sherrin me të vjehrrën mallkonte të birin, por di që as mua nuk më pëlqente nënë Sofia. Më dukej grindavece, e ftohtë dhe qeshte pak. Njerëzit që qeshin pak më kanë lënë përshtypjen se janë me zemër guri. Kur ia thashë këto, Egla u ndje e çliruar aq sa më puthi e më shtrëngoi fort pas vetes. Ishte puthja ime e parë nga një femër, e për më tepër aq e bukur sa Egla!

Martesa e saj dukej më së shumti se ishte bërë me të vjehrrën.

-A dilni në pastičeri me Sandrin, ndonjëherë? - e pyeta

-Ndonjë të diel, kur kthehem nga varri i të atit.

Kur volëm rrushin i kërkova leje prinderve, që të mbushja një kanistër për nënë Sofinë. Ankthi i mos prekjes së rrushit kishte kaluar, kurse vjeshta me zhveshjen e vreshtit e fillimin e shkollës po i jepte fund qëndrimit tim në kopësht. Nëna ime gjithmonë e kishte zemrën të bardhë ndaj pa një pa dy e mbushi plot, por fjala e fundit pritej nga babai. Ndryshe nga ajo, ai nuk e gjente gjuhën me asnjë prej fqinjëve, pasi i ishte mbushur mendja top se ata shtynin kufijtë. Për ato të shkreta ndizte sherrin, e nuk fliste me gjysmën e lagjes. Nënë Sofia nuk shquhej për këtë, por tim eti nuk ia hiqte kush nga mendja se sëmundjet e hardhive na vinin prej saj! Gjithë akuzat e babait për fqinjët më dukeshin absurde, por kujt ia mbante ta kundërshtojë.

Madje, vazhdoi të mendoj se babai do të lumturohej, nëse ne do t’i urrenim të gjithë ata që urrente ai. Si për ta bindur, i thashë babait se nusja e Sandrit e pëlqente shumë rrushin, por ata nuk kishin mbjellë. Kaq u desh që ai të më mbante një leksion të gjatë për njeriun punëtor dhe të mirat e këtij virtyti për t’u ushqyer në jetë.

Rrushi ishte shkaku për të shkuar tek Egla kur të ishte vetëm.

Nuk e ndaja dot në më pëlqente ta shihja, prej bukurisë së saj, apo prej shpengimit që e karakterizonte. Herë më dukej se isha i vetmi njeri të cilit ajo mund t’i hapej për mërzitë e jetës së saj. Po ndiheshq si shpëtimtar!

Isha vetëm 14 vjeç, por me shtat të gjatë e rregullt e ndonëse nuk më kishin dalë qimet në fytyrë, më dukej vetja i burrëruar para saj.

Pasi ruajta nënë Sofien të dalë nga shtëpia, i trokita nga deriçka e kopshtit. Në të u shfaq Egla si zanë me një këmishë të kuqe sateni! Flokët ngjyrë karrotë e me onde të mëdha lëshuar mbi supe, gjoksi gjysmëzbuluar, shalët pothuaj lakuriq, i shkonin shumë përndejes së fytyrës. Nuk di nëse arrita t’i shpjegoj arsyen pse kisha shkuar, por diçka belbëzoja siç ndodhte rëndom kur gjendesha para saj. Ndryshe nga ç’prisja, Egla mori shportën, e si më falënderoi bashkë me një” ditën e mirë “e mbylli derën.

“Ndoshta do të jetë Sandri pushim!” justifikova Eglën sapo kapërceva gardhin e kopshtit. Pamja e Eglës, me të cilën u shfaq para meje, dukej sikur sa kiehte dalë nga ndonjë betejë. Nuk ishte as ditë pushimi për të shoqin. I dhashë një mendje të ftohtë atij dyshimi e u riktheva në kopshtin tim. Hapa ditarin e fillova të shkruaj. Fillimvjeshta ishte pa ndonjë ndryshim të dukshëm në temperatura nga vera. Ndërkohë, nuk i ndaja sytë nga kopshti i nënë Sofisë. Një çast, një kërcitje dere bëri të përqëndrohem ku dallova dikë që me të shpejtë përshkoi kopshtin, kapërceu një gëmushë e u hodh nga kopshti i Matajve! Dallova djalin e tyre të vogël, Metin, ai që ishte martuar me një grua sa një fuçi. Pa kthyer kokën as majtas as djathtas, ai u zhdruk si hije.

-Çfarë e ka Meti nënë Sofinë? – Pyeta prindërit, të cilët të ulur në verandë, po gjerbnin në heshtje kafën e pasdites.

-“ Lakra në kopësht” shpotiti babai me ato batutat e tij të hidhëta. - Matajt janë muslimanë si ne, kurse këta të Sofisë, ortodoksë.

Ndasia e parë vinte nga feja pastaj nga gjaku sipas babait tim. Atë çast vetja m’u duk një idiot i tërë.

-Pse pyete? – m’u kthye nëna, sikur donte ti vërë kufi kuriozitetit tim.

-Kot, kot. - nxitova t’i përgjigjem - Ngaqë kanë shtëpitë ngjit e ngjit .

Nëna ime mërzhitej po të flitej për të tjerë në mungesë. Edhe nëse ndodhte, ajo thoshte vetëm fjalët të mira. Mua me të vërtetë m’u duk e çuditshme prania e Metit te shtëpia e Eglës, por këtë dyshim nuk ia tregova nënës pasi trembesha nga reagimi i saj. Ajo “asgjëja” e babait më ndezi dyshimet. Nëna kishte kuptuar, apo dinte diçka më shumë nga sa unë folja, ndaj dhe priti çastin që babai u largua, për të më porositur se kurioziteti nuk bënte për burrat, e tani isha bërë i tillë.

-Çfarë e sheh e dëgjon rreth fqinjëve, të vdesin me ty. Ata kemi në të mirë e në të keq. Nuk kemi dalë të rregullojmë punët e tyre, por ti respektojmë e pranojmë si janë, - e mbylli ajo ligjëratën..

Heshtja ime ishte një lloj pohimi e premtimi njëherazi, por të hidhja herë pas here sytë fshehurazi nga deriçka e kopshtit të Eglës mu kthye në ves.

-Dhe mjaft ndjenje në kopësht, me ato shkrimet e tua, se do të çmendesh! – u përpoq të sigurohej nëna që e kisha marrë si duhet mësimin. Burrat nuk merren me poezi. Mësoji ca zanate pas babait, se do të duhen në jetë.

Se pse të shkruaje nuk ishte punë burrash, vetëm nëna e dinte.

-Kush leu, mendt e veta pëlqeu, ndaj rri larg familjes së tyre, hë për hë. – vazhdoi sërish ime më, duke parë nga shtëpia e Eglës.

U turbullova ca, ndaj sa mbaroi ligjëratën nëna, ia mbatha në shtrat i mërzhitur. Gjumi im u përpëliti mes gulçesh tërë natën.

Të nesërmen dola herët në kopësht, duke i kthyer shpinën deriçkës së Eglës. I kisha premtuar vetes që do të sillesha sikur ajo nuk ekzistonte. Më mbërtheu një ndjenjë e fotë xhelozie për të birin e Matajve. Mu bë një lëmsh në stomak sa një maçok. E çuditshme pasi për Sandrin nuk e kisha një ndjesi të tillë. Mes këtyre mendimesh dëgjoj pas shpine zërin e Eglës të më thërrasë. Më ftonte në shtëpi, të zhvendoste një bibliotekë nga një dhomë në tjetrën. Nuk u mëdysha fare si të mos isha betuar. Si këlysh i bindur ndoqa veç instiktin. Pothuaj fluturova nga fjalët e saj. Me sa kuptova, Egla ishte ndjerë në faj për ditën më parë, pasi biblioteka u harrua.

Kishte gatuar revani e më gostiti duke më pyetur për shkrimet e mia. E shihja dhe fantazoja Eglën e një dite më parë. Gjaku më hipi në kokë aq shumë sa kur po largohesha ndala një hop në prag dhe vrullshëm pa marrë parasysh pasojat e reagimin e saj, u zgjata majë gishtash, mbylla sytë dhe e putha.



Çuditërisht ajo nuk më kundërshtoi. Nuk di sa ndjenja ashtu duke ndjerë lagështinë e buzëve të Eglës por trupi m'u rrënqeth e zemra sa nuk më doli vendit. Aroma e asaj puthjeje më dehu të gjithin. Sa nevojë kisha patur për të! Sa shumë e kisha ëndërruar! A thua të ishte kjo dashuria që thurnin vargje poetët e mëdhenj? Ndoshta pas kësaj puthjeje mund të quheshim të dashur. Do të isha mashkulli saj, do të kujdesesha ta bëj të lumtur. Akoma më e bukur bëhej kur qeshte. Do t'i shprehja dashurinë me fjalë shpirti e ato përjetimet e netëve të mia, ndoshta do të bëheshin realitet tashmë. Në shtratin e saj fantazova veten në vend të Sandrit.

Të nesërmen e gjeta në kopësht duke ngashëryer! Ndoshta ishte grindur sërish me të vjehrrën, ndaj bëra të kapërcej gardhin por ajo refuzoi me dorë. Egla më ngjante si njeri me hënë, me gjendjet e saj qaj e qesh, afro e largo.

Për një javë rresht ra heshtja në kopshtin fqinj, gjersa një të enjte dalliova sërish Metin të përvidhet nga kopshti i Eglës për në të vetin. Shkolla kishte filluar, por unë drekave e gjeja veten mes vreshtash. Më shtohej malli kur nuk e shihja e nuk i dëgjoja zërin po aq sa më hipte gjaku në kokë kur nuk ma varte. Më vinte ti futesha në shtëpi, ta puthja e ndukja. Bëhesha burrë pranë saj.

Pikërisht kur fillova të zbeh shpresat , mes lotësh, ajo më fton në shtëpinë e saj. Më tërhoqi prej dore në dhomën e saj, më zhveshi e nuk di më ç'ndodhi prej marrisë që më zuri... Më kish marrë virgjërinë, e unë nuk e kundërshtova për asnjë çast.

-Pse nuk ndahesh nga Sandri, - i thashë duke u veshur. - Ai nuk bën për ty.

Mes lotësh, ajo më tregoi se, ai nuk e përkëdhelte kurrë. Vizitat në shtëpinë e Eglës u bënë të shpeshta aq sa, e shpërfilla praninë e Metit që nuk mungonte çdo javë të dilte nga deriçka e kopshtit duke vrapuar. Kurrë nuk i rashë në sy për të pasi më dukej se do ta humbisja

Një pasdite nënë Sofia me një ngjyrë të çuditshme në fytyrë m'u afrua, duke më parë drejt në sy sikur donte të m'i lexojë ato. Më përkëdheli flokët e më pyeti:


-A vjen shpesh tek shtëpia jonë, ti mor bir, pasi nusja thotë që të ka si vëllanë e vet?!

Më dha një dorë biskota” Pranvera”, e pasi më dëgjoi gjer në fund mori frymë thellë. Duhet të jem skuqur nga fjalët e mua që ishin fund e krye gënjeshtër, por nënë Sofinë duket se e lehtësova. E si mund t'i thosha se bëja dashuri me nusen e të birit, ndaj iu përgjigja shkurt, për të mos tradhëtuar vehten.

Të nesërmen, Egla, që përtej gardhit, më tregoi se dikush i kishte shtënë në vesh të vjehrrës se një burrë futej në shtëpinë e tyre nga deriçka e kopshtit. Diçka nuk shkonte, pasi unë nuk isha burrë, por një katërmëdhjetë vjeçar. Megjithatë bëmë një pakt: të ndaleshim për pak kohë, derisa të harrohej kjo.

Sandri ndërroi punë ndaj çdo pasdite ishte në shtëpi. Malli po më gërryente për Eglën, ndaj një natë vonë vendosa të afrohem te dritarja e dhomës së saj të gjumit, rreth mesnatës. Këtë çast ndjeva deriçkën të hapej. U bëra hi nga frika se mos më merrnin për hajdut. U bëra njësh me murin duke pritur të mbyllej ajo derë. Por pas një hopi hija e një njeriu që nga flokët kuptova se ishte Egla shkoi e u fshih në rrëzë të fikut e po priste. U mata të dal duke menduar se Egla ishte grindur me të shtëpisë e po qante si zakonisht. Por ç'të shoh... Ajo ishte aty me Metin, cullak, duke bërë dashuri përtokë si të marrë. Përnjëherë mendja shkoi te Sandri e u përpoqa të zhbiroj përmes dritës së abazhurit brenda dhomës së gjumit. Nga drita e abazhurit te shtrati e pashë të flinte për shtatë palë qejfe. Rreth orës katër të mëngjesit Egla u fut në shtëpi.

U xhelozova keqas për Metin. E dija që Eglës i duhej një burrë prej vërteti e ndoshta unë nuk isha ende i tillë megjithë fjalët e nënës. Më pikonte në shpirt palumturia e saj por kurrë s'e mora vesh se përse nuk e ndante të shoqin e të martohej me Metin. Me



të kalonte gjithë mbrëmjet dhe rrallë, shumë rrallë, më ftonte mua ditën. Kjo më thoshte që Metin e donte më shumë.

Një mëngjes herët sirenat e ambulancës zgjuan lagjen kur i zunë derën nënë Sofisë. Nuk e kuptova se për kë erdhi, por kur trokita në deriçkën e kopshtit ajo ishte e hapur dhe nuk gjeta askënd brenda.

E përgjova gjatë kopshtin e Eglës për të mësuar se ç'kishte ngjarë. Nuk pipëtiu kush për një javë gjersa pashë nënë Sofinë me një sëpatë që godiste pemën e fikut.

-Egla duhet të jetë me Sandrin në spital ? - mendova pas zërave se ky i fundit ishte helmuar me ilaç gjumi! Sandri pasi doli nga spitali kalonte i vetëm orë të tëra në kopësht. Egla nuk dukej asgjëkundi.

-More vesh or burrë, e reja e nënë Sofies kalonte natën në shtëpinë e oficerëve pasi i jepte valium të shoqit në ushqim?

Ja gjeti dhe vet kuçedrën e uruara! Dësh ja mbylli derën të shkretës pa ju shëruar mirë plaga e të shoqit, tregoi nëna , babait teksa i lante këmbët!

Ende nuk po u besoja veshëve nga ato që dëgjoja!

-Çfarë, çfarë?! – briti babai.

Dhe nëna nisi të tregonte gjithë dyshimet e saj, që nga djali i vogël i Matajve deri tek përdredhjet e vitheve kur kalo te para burrave. Nuk po i besoja veshëve me këtë ndryshim të nënës.

Shkonte dhe ky yni ca si tepër në shtëpinë e tyre , e vulosi nëna rrëfimin!

-Çthua moj grua, ky yni është ende fëmijë!

M'u prenë gjunjët aty fshehur pas dere. Më vrau besimi i tij. Goja mu tha e fryma po më mbahej. Përfytyrova Eglën cullak mes aq shumë burrave në hotelin e oficerëve. M'u shemb mbi kokë gjithë bota që kishq ngritur rreth saj. Për herë të parë, nënë Sofia nuk mu duk aq e keqe sa thoshte Egla. Nëna më gjeti zhgërryer në zhavorrin e rrugës me kokën ulur. Dukej sikur vazhdoi fillin e bisedës me babain.

-Ia pashë tymin asaj femre, që kur solli vdekjen e Zoit sa vuri këmbë në atë shtëpi.

Nuk e kam kuptuar asnjëherë se ç'lidhje kishte vdekja e xha Zoit me ardhjen e Eglës, por s'e ngava më tutje bisedën se isha tym për vete. .Dukej se ajo kërkonte arsye për ta dënuar duke qenë në rregull me Zotin. E dija që i trembej gjykimit të tij.

-Këmbëters sa hyri! Mjerë nëna që e ka! Mos bëftë hajër, se desh mori në qafë djalin!

Lagjja gumëzhiu gjatë për tradhëtitë e Eglës, por mua më merrte shumë malli për të po aq sa e urreja njëherazi.

Babai i preu hardhitë si të vjetëruara, e mbolli kalema të rinj, ku unë shkrova edhe tregimin e parë me titullin “Tradhëtarja”. Shokët e klasës e kopjuan me shkrim dore dhe e shpërndanë, duke më parë si njeri të ditur në lidhje me çështjet e zemrës.

Nusja e re e Sandrit nuk më përshëndeti kurrë.

Shënime për vëllimin
‘Gruaja që endej hijeve’
të Irena Dragotit

Bota femërore e një tregimtareje

Nga Fatbardh Amursi

Kur isha nxënës merresha me gazetën e murit, ku afishoheshin poezitë e shokëve dhe shoqeve të shkollës. Vazhdova ta bëja këtë dhe kur u bëra mësues. Ende dhe sot sa herë më jepet rasti të lexoj poezi apo libër të ndonjë nxënësi, pavarësisht nderimit apo mosmirënjohjes, më thërret ndjenja e detyrës. Një gjë e ushtruar gjatë kthehet në shprehje. Edhe Irena është një ish nxënëse, të cilën e takova në Elbasan në promovimin e librit të Ben Blushit. Më tha se kishte botuar një libër me tregime. Ia kisha lexuar poezitë dhe kur u njoha me tregimet më shoqëroi ndjesia se ato i ka shkruar një autore që vjen nga poezia. Mjafton të përmend disa tituj: “Gruaja që endej hijeve”, “Askush nuk fliste për fatin”, “Atje ku fundosen mëkatet.”

Libri nis që nga shtëpia me pjergullë, kopshti i fqinjës ku degët e fikut kapërcejnë gardhin, lagjia ku ndodhin skena erotike të ndezura nga pasionet njëherësh dhe thashethemet, më tej fshati ku shfaqen personazhe mbresëlënëse, edhe më tej qytete të mëdha ku fati i provincialit ndryshon rrjedhë deri tek botë e madhe ku një skulpturë apo plazh nudo shihen si normalitet në sytë e skulptorit. “Imagjinova për një çast gjithë plazhin nudo e të palëvizur, duke pozuar për mua në një skulpturë kolektive. Çfarë realiteti të larmishëm do të përmbante një fragment i vetëm. Zhveshjet e mia netëve dukeshin si fshehje nga bota, sikur përpiqesha t’u hedh hi syve të botës për atë pjesë të vetes që nuk do t’ia tregosh askujt. Fundja, kujt i bëhej vonë për mungesën e lirisë tënde të brendshme.” Raportet e zhveshjes së vetes si fshehje ndaj botës, jo vetëm në skenat erotike, por dhe aty ku personazhët rrëfejnë të vërteta tronditës, mbajnë gjallë vëmendjen e lexuesit. Rrëfimet janë të singerta, larg trukeve për të bërë përshtypje.

Më shumë nga mësuesja ata që kanë ndikim tek rrëfimtari janë: gjyshja, babai, nënë, fqinja, cilido që ngrihet mbi ambientin, duke u përballur me realitete poshtëruese. “E kujt i bëhej vonë se nuk do të prodhonim raki, kur atë e pinte veç babai e ndonjë mik i tij kur shkelte për vizitë?! E urreja rakinë, pasi më dukej se ajo ishte mollë sherri mes ne të gjithëve e babait.” Mospajtueshmëria me urrejtjen thellohet, kur: “Babi nuk e gjente gjuhën me asnjë prej fqinjëve, pasi mendonte se ata i shtynin kufijtë. Madje, mendoj se babai do të lumturohej, nëse ne do t’i urrenim të gjithë ata që urrente ai.” Edhe në një shoqëri moderne: pranoresh nëse urren dhe ti të gjithë ata që urren tutori apo prijësi yt. Urrejtja mbahet gjallë nga ata, që nuk e gjejnë gjuhën me të tjerët.

Kështu nis libri për t’i hapur rrugë temës së madhe të dashurisë, që nis pikërisht me gardhin e fqinjës, ku fiku i bardhë bëhet si urë lidhëse midis djalit dhe nuses së bukur. “Gjithë gushtin e shihja shpesh të vilte me mundim fikun e bardhë që kishin në kufi me ne, ndaj një ditë i ofrova ndihmë. S’di pse trembesha, se mos binte, pasi sipas nënës sime hija e fikut ishte e rëndë dhe rrëzimi prej andej sillte gjithmonë pasoja fatale për jetën.” Mos gruaja e bukur për shkak të kësaj lidhje të fshehtë do endej hijeve? “Megjithëse ishte grua shumë e bukur, ajo ishte martuar me Sandrin, një djalë ca i ngathët e i dobët si shtyllë elektrike, që kur e shihje dukej se e zinte gjumi në këmbë. Kaq vite komshi nuk ia kisha dëgjuar kurrë zërin, sa u binda se duhet të ishte memec.” Aq dede ishte Sandër mafishtja, sa nusen ia kishte zgjedhur nënë

Sofia, e cila e kishte parë rastësisht nga një fotografi e mbesës së saj. Sofia qeshte pak, kundrejt nuses së bukur që po e kërkonte lumturinë hijeve. “Njerëzit që qeshin pak më kanë lënë përshtypjen se janë me zemër guri. Kur ia thashë këto, Egla u ndje e çliruar, aq sa më puthi e më shtrëngoi fort pas vetes. Ishte puthja ime e parë nga një femër, e për më tepër aq e bukur sa Egla.

-A dilni në pastičeri me Sandrin, ndonjëherë?-e pyeta.

-Ndonjë të diel, kur kthehem nga varri i të atit.” Nuk është i rastit ky kontrast, ku ëmbëlsira pas ardhjes nga varresa, të jepi shijen e hallvës. Lehtësisht e kuptueshme, që nusja e bukur ishte bërë qari i njeriut, që s’ e meritonte. Kështu që fiku i bardhë do joshte të tjerët.

Në tregimin në vazhdim kujton fjalët e gjyshes se Zoti i vë shenjë së ligës. “Ligësia i ishte bërë tipar tek sytë e picërruara, buzët e holla e të përveshura dhe mjekra e kthyer si lugë...Mësuese Marjetën e zbutnin veç ditët e festave. E shihja në delir krah drejtuesve të rrethit.” Mësimet e gjyshet binin ndesh nga ata të mësueses së marksizmit. Një nga kuadrot e rrethit ishte dhe Tomorri, i cili favoret seksuale i përfntonte për shkak të ofiqit. “Që kur ishte pranuar anëtar partie, Tomorrin e kishte frikë gjithë fshati. Ai ndante gjithçka; të drejtat e shkollimit, vendet e mira të punës e madje dhe ushqimet për dasma e vdekje. Pasditeve, i lyer me livando e me flokët lëpirë pas ballit, ai parakalonte nëpër rrugët e fshatit, dhe shpesh kthehej në shtëpitë e fshatarëve, për ndonjë gotë. Kalonte orë të tëra mbrëmjeve e ndonjëherë gjer në mesnatë, aty ku i pëlqente ndonjë nga femrat e familjes. Pa e shtënë në dorë, nuk shkulej, thoshin. Më së shumti kapardisej në vatrën e kulturës, kur ia behnin hallexhinjtë, për ndihmë...

-Sa herë të të vërsëllej,-foli ai,-do të dalësh tek ai sopi në të djathtë të lesës tënde, përndryshe tët atë e pret burgu.” Ky ishte njeriu që terrorizonte, pavarësisht se në drama e filma pasqyrohej si një babaxhan.

“-Rozë, qenka mbytur Tomorri te kanali kullues! Ç’t’i ketë ndodhur vallë?! - pyeti më tepër veten e ëma se të bijën.-Do jetë bërë pishman grua, për të këqijat që ka bërë.-ia priti me romuz i ati.-Ose ka qenë kaq i pirë e i ka rrëshqitur këmba duke rënë pa dashje. Kohët e fundit pinte shumë!”

Për të neutralizuar neverinë që të krijon i ligu, i cili përngjan me dimrin që i ha ditët pranverës, vjen tregimi “Ketrat”. “Kur ua hidhja me tepricë apo kur ngopeshin, i merrnin e hapnin gropa për t’i fshehur. U keqardha kur lexova se nuk e mbanin mend vendin ku fshihnin ushqimin, por kujtonin burimin ku e merrnin.

-Kjo ndoshta do t’ju humbasë instinktet e kërkimit të ushqimit e do të vuajnë urie, u përpoq të më bindë im shoq. Kurrë nuk do ta harroj ditën e parë pas vendimit për t’mos i ushqyer më!

Diku kisha lexuar se edhe dashuria e tepërt “vret”, kurse mirënjohja e tepërt bëhet barrë. Madje, mendoja se çdo gjë me tepricë është e dëmshme.”

Në tregime has personazhe, që urrehen për shkak të krenarisë, sikurse të vuajnë mëkatet e të tjerëve, ngaqë e kanë ndërtuar shtëpinë pranë rrënojave të një kishe, “pikërisht në një gropë të tillë, sa duket se nga çasti në çast do të fundoset nën të”. Kjo bën, që, aty ku fundosen mëkatet, gruaja të endet hijeve dhe të mos flitet më për fatin e saj.

Kur një roman i afrohet përvjetorit të pesëdhjetë, dikush pyet veten se çfarë ka ruajtur dhe çfarë ka braktisur nga premtimet e tij origjinale: çfarë mbetet gjallë dhe çfarë (ndoshta) ka vdekur gjatë rrugës. Mund të duket si një pyetje e pahijshme, por jo krejtësisht e pakuptimtë për një roman si *Emri i Trëndafilin*, botuar nga Umberto Eco në vitin 1980 dhe menjëherë objekt debati të ashpër. A ishte një vepër e hapur - pyeste veten atëherë - apo një vepër e mbyllur? A i pasqyronte saktë linjat e zhvillimit që Evropa mesjetare i bindej? A i dha përparësi komedisë në të gjitha nuancat e saj, apo në vend të kësaj kënaqi një shije të caktuar për katastrofën? Cila në fund të fundit mbizotëroi: libri i dytë i imagjinuar i *Poetikës*, i atribuuar Aristotelit, apo libri Gjonian i *Apokalipsit* (i *Zbulesës*)?

I tillë ishte pritja që mori, me shkallë të ndryshme të zemërimit. Por, së bashku me pyetje të ngjashme - nga ekspertët - pati, fillimisht ngadalë, pastaj si një ortek, një sukses publik dhe një qëndrueshmëri kohore të pakrahasueshme në peizazhin letrar të shekullit të njëzetë. Dhjetëra miliona kopje u shitën, kjo është e sigurt; është adaptuar në filma, seriale televizive, videologjia dhe botime në Braille; dhe madje edhe sot ka nga ata që i transformojnë nuancat e saj të errëta në opera (maestro Francesco Filidei me libretistët e tij, 2025), dhe nga ata që e transformojnë atë në romane grafike të shkëlqyera (Milo Manara dhe vajza, 2023-2025). *Emri i Trëndafilin*, mund të thuhet, ka mbuluar të gjithë spektrin shprehës: gutenbergian, ekstra-gutenbergian dhe post-gutenbergian. Por pikërisht, në prag të plakjes, çfarë mbetet gjallë dhe çfarë është bërë e errët ose disi e pakapshme për sytë e lexuesve bashkëkohorë?

Risia që solli në skenën italiane konsistonte në bashkëjetesën e kualifikuar, por shumë tërheqëse të niveleve të shumëfishta kompozicionale. Kishte romanin historik të ndërtuar në mënyrë të pasur, por kishte edhe romanin detektiv me një *stil zbulues*, pastaj tregimin e shkurtër me temë filozofike: debati midis realistëve dhe nominalistëve, ngritja e disiplinave semiologjike; kishte metanarrativën, domethënë një reflektim të nivelit të dytë, si të thuash, mbi mënyrat e dijes: skema e rreme apokaliptike, shkalla, rrjeti si mjete përmes të cilave mund të mbështetesh në realitet. Kishte një bazë tinëzare alegorike, kështu që heretiku Fra Dolcino flitej, por mund të kuptohej edhe si Renato Curcio dhe Brigadat e Kuqe; iu dha hapësirë inkuizitorit Bernardo Gui, duke aluduar në strategjitë represive të përdorura kundër lëvizjeve subversive ose protestuese si ajo që zunë rrënjë në Bolonjë në periudhën trevjeçare 1977-1979; dhe së fundmi kishte një mënyrë të plotë, post-moderne, të cilën një lexues ekspert mund ta shikonte me një dozë shtesë kënaqësie estetike dhe intelektuale.

Le të përpiqemi të përgjigjemi, megjithëse ngushtë. Midis të gjitha këtyre niveleve ose përbërësve, fabula padyshim mbetet e gjallë. Këtu, në fabul, kemi një lloj a priori tekstual, një gjenerator që nuk pushon kurrë së prodhuari magji dhe shqetësim. Dhe është e kuptueshme, materiali narrativ që Eco përgatiti për romanin është rregulluar dhe ripunuar në mënyrë efektive: shtatë ditë (duke iu referuar si shtatë ditëve të krijimit të përmendura në *Zanafillë*, ashtu edhe shtatë vulave, shtatë borive dhe shtatë shenjave të gdhendura në tekstin Gjonian të *Apokalipsit*), nga ana tjetër të ndara sipas orëve liturgjike të sundimit Benediktin. Shtatë është numri i murgjve që vdiqën, ose nga vetëvrasja si Adelmo da Otranto dhe Jorge da Burgos, ose nga atentati si Venantius i Salvemecit, Berengario da Arundel, Severino da Sant'Emmerano, Malachi da Hildesheim dhe Abbo da Fossanova. Një ritëm në thelb binar në vend të kësaj ndërpret sequencat



narrative: zbulimi i secilit trup çon në një fazë të re në hetim. Meqenëse episodi tragjik shpesh vendoset në fillim të çdo dite (ose kapitulli), hetimi zhvillohet pa probleme në faqet në vijim. Por mund të ketë edhe pauza, përmbysje, me anë të të cilave një pauzë e gjatë në hetim - e plotësuar nga ngjarje që lidhen me misionin politik të Uilliamit dhe përvojat personale të të riut Adso - vulozet në fund të kapitullit me zbulimin e një trupi tjetër, duke prishur ose ndërlikuar kështu pistat dhe dyshimet e përcaktuara më parë. Ashtu si me shtojcat e njohura të shekullit të nëntëmbëdhjetë, e gjithë kjo i lejon autorit të ruajë tension të lartë narrativ, duke balancuar kalimin nga një kapitull në tjetrin të romanit voluminoz me *kthesa dhe ngjarje të papritura të përshtatshme dhe efektive*.

Po kështu, dhe për një gamë të gjerë lexuesish, tërheqja historike e romanit mbetet. *Ngjarjet në "Emri i Trëndafilin"* zhvillohen në një manastir (pa emër) në Kluniak në Italinë veriore,


në vitin 1327 të Zotit tonë; dhe rendi i ditës, në një klimë rënije, janë konfliktet midis dy autoriteteve perandorake dhe papnore (Ludvigu i Bavarisë dhe Gjoni XXII i Avinjoni). Në sfond shfaqen lëvizje heretike, mosmarrëveshje mbi varfërinë e Krishtit dhe fraksionet minoritare françeskane. Eco, megjithatë, është një intelektual shumë i mprehtë, shumë i ditur në studimet historike dhe filozofike për të na paraqitur një imazh të shurdhër të një Mesjete irracionale, asketike, ose një të ndezur nga fanatizmi intolerant. Në Mesjetë, përkundrazi, ai kënaqet duke gjurmuar farat e një moderniteti laik dhe të sekularizuar. Për të, Mesjeta nuk është sinonim i barbarizmit pa dallim, siç na kanë shtrembëruar disi Rilindja dhe Iluminizmi i mëvonshëm që na kanë bërë të besojmë; por as nuk është epoka heroike, e bashkuar fort rreth një ideali të transcendencës që një romantizëm i caktuar konservator na e ka përshkruar.

Midis dy opsioneve kundërshtarë, semiologu piemontez duket se vendoset në mes, duke na ofruar në fund një afresk me ngjyra të gjalla, rezultat mbi të gjitha i një pune të duruar sqarimi didaktik: një qëndrim që duhet ta ketë kënaqur shumë turmën e dendur të lexuesve të zakonshëm që u mblodhën rreth romanit për dekada të tëra. Dikush mund të debatojë për një farë rrafshimi funksional, që synon të përfaqësojë më të mirën e intelektualizmit evropian midis shekujve 12 dhe 15 (Ockham, Roger Bacon, Marsilio Ficino, Meister Eckhart). Dhe dikush mund të debatojë për mbylljen e vetëmjaftueshme që solli me vete Mesjeta e vonë e Eco-s: asnjë humanizëm, asnjë perspektivë e Rilindjes (diskursi tërësisht laik dhe sekular që Eco do të ndiqte në romanin e tij të vitit 2000 *Baudolino* do të jetë mjaft i ndryshëm). Sidoqoftë, korniza historiografike e përgatitur për rastin është e fortë dhe e besueshme; një burim kënaqësie për lexuesit e djeshëm dhe të nesërm; nëse jo një pikë rimëkëmbjeje për një epokë para-moderne që nga tani e tutje do të ketë një zhvillim të gjatë, ndoshta në një tonalitë më të theksuar gotik dhe *fantazi të errët*.

Nëse, shkurt, do të më pyesnin sot se si një roman si *"Emri i Trëndafilin"* vazhdon të lulëzojë, padyshim do të thoja se kjo është për shkak të këtyre dy aspekteve të lidhura strategjiksht: *fabulës* dhe vendosjes. Një *fabul* jo veçanërisht origjinale, por efektive dhe interesante; dhe një sfondi historik të detajuar, me zbukurime narrative dhe elementë didaktikë, si të librave shkollorë, që i shoqërojnë ato me shumë autoritet. Më lejoni të shpjegoj: në mënyrë që pas narratorit-protagonist Adso - pothuajse gjithmonë i munguar vetëdija e plotë për atë që po ndodh; dhe pas William of Baskerville, një superhero intelektual, por i prirur ndaj disfatave të mëdha - pas të gjitha këtyre, ne mund të identifikojmë qartë figurën implicite të Umberto Eco-s, ekspertit të padiskutueshëm dhe demiurgut të madh të Mesjetës. Mesjeta tërheq, nuk pushon kurrë së magjepsuri, dhe akoma më mirë kur na paraqitet përmes fjalëve të mençura të një autori të ditur dhe të zhgënjyer.

Megjithatë, në dritën e këtyre dy aspekteve, dy elementë të tjerë duket se janë humbur, ose duket se e kanë humbur rëndësinë e tyre gjatë këtyre dekadave të fundit: dua të them elementin alegorik-bashkëkohor, i cili na flet për *atë kohë* në mënyrë që t'i referohet bashkëkohësisë së shkrimit (le të mos harrojmë se Eco deklaroi se filloi ta shkruante romanin në mars të vitit 1978, domethënë, në të njëjtat ditë me rrëmbimin e Moros), dhe konfigurimin specifik postmodern të historisë.

Sa i përket aspektit të parë, domethënë anës qytetare-kontekstuale të *Emrit të Trëndafilin*, do të mjaftonte të kujtonim disa pasazhe - në atë kohë shumë të qarta, aluduese dhe tani pa kuptim ndërsa lexojmë - që e bëjnë të qartë orientimin e dyfishtë të rrëfimit. Këto pasazhe pothuajse gjithmonë mund të gjurmohen deri te një ish-dolcinian i penduar si Remigio da Varagine; dhe ato janë të dobishme për të na prezantuar me një *aspekt* të dyfishtë kontekstual: nga njëra anë, lëvizja e vitit '77 në Bolonjë, me kërkesat e saj (Bakhtiniane) në lidhje me festivalet e rrugës, dhe komedinë popullore si një forcë përmbysëse: «Ta thashë,» thotë Remigio në këtë drejtim, «ishte një karnaval i madh, dhe në karnaval i bën gjërat mbrapsht.» Nga ana tjetër, një *facies* specifikisht terroriste, e ngjashme me Brigadat e Kuqe, e cila deklarohet në formula të qarta si më poshtë, gjithmonë të atribuueshme Remigio-s: «ne dogjëm dhe plaçkitëm sepse kishim zgjedhur varfërinë si ligj universal dhe kishim të drejtën të përvetësonim pasurinë e paligjshme të të tjerëve, dhe *donim të godisnim në zemër të*





rrjetit të lakmisë që shtrihet nga famullia në famulli, por ne kurrë nuk plaçkitëm për të zotëruar, as nuk vramë për të plaçkitur, ne vramë për të ndëshkuar, për të pastruar, për të pastruar të papastërtin përmes gjakut”.

Nuk ka dyshim që Eco arriti në fraza të tilla rastësisht. Fanatizmi i Remigio-s i referohet drejtpërdrejt ideologjisë së Brigadave të Kuqe. As nuk mund të harrojmë rëndësinë kontestuale të një figure historike si Bernardo Gui, kampioni i procedurave inkuizitore - domethënë, procedurave që zhdukin të gjitha shenjat e drejtësisë pozitive, pikërisht në momentin që ato kërkojnë të imponojnë drejtësi dhe të vërtetë. Mekanizmat që synojnë të shtypin grupet autonome rinore situacioniste aktive në Italinë qendrore, Bolonjë, por edhe në Romë, nuk duken shumë të ndryshme në ditët kur u konceptua romani. Po flasim për mbylljen *me forcë* të institucioneve të bazuara në lëvizje si Radio Alice, serinë e arrestimeve pa prova për udhëheqësit e protestave (hetimi i 7 prillit, e ashtuquajtura teorema e Calogero-s që pasoi). *Emri i Trëndafil* na flet për të gjitha këto - aludon për të gjitha këto. Por pikërisht kjo aludon, lë të kuptohet. Eco sigurisht që donte të na fliste për klimën e ashpër që po rëndonte mbi Italinë në fund të viteve 1970, por ai donte ta bënte këtë në një mënyrë të rezervuar. Të paktën, mjaftueshëm për të mbrojtur veten nga çdo kritikë ideologjike e interesuar, nga çfarëdo bindjeje politike që mund të vijë. Pozicioni i saj - edhe në këtë rast - është i ndërmjetëm: sigurisht që nuk mban anën e përmbyësve të etur për gjak, të dhunshëmve; por në emër të garancive ligjore të sanksionuara në ligj, nuk mban anën e shtypësve perandorakë. As me Dolcinon, as me Inkuizicionin e Shenjtë: ky do të dukej slogani më i rëndësishëm. Një slogan delikat, i rrezikshëm, por edhe shumë më i fshehur sesa dukej në një tekst të Leonardo Sciascias si *Çështja Moro*: dhe për shkak se është e mbrojtur, e fshehur, humbet aq më lehtë, sa më shumë vite kalojnë midis ngjarjeve që alegorizon.

Zbehja e kuptimeve fillimisht alegorike dhe kontestuale me kalimin e kohës është, në fund të fundit, një fenomen i njohur në traditën e romanit, dhe ndoshta edhe më shumë në traditën e romanit historik. Në këtë mënyrë, *Emri i Trëndafil* humbet një konotacion qytetar aspak dytësor, por qëllimi i tij i përgjithshëm ende nuk vihet në dyshim. Që të ndodhë një «shtrembërim»,

ose më saktë, një thjeshtëzim rrënjësor i dizajnit origjinal, duhet të humbasë edhe një parim tjetër, vërtet strukturues në këtë drejtim: parimi parodik, përndryshe i përkufizueshëm si postmodern, intertekstual me shaka. Një parim që drejton romanin që nga hapja e tij në stilin Manzonian («Natyrisht, një dorëshkrim») deri te aludimi i zgjuar Vitgensteinian që mbyll rreshtin, shënon: «ajo që nuk mund të teorizohet duhet të rrëfehet». dhe që na lejon të lidhim në mënyrë shumë të paskrupullt rreshtat e parë të *Prologut*, «Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë», të marrë nga Ungjilli i Gjonit, me hapjen e ditës së parë, «Ishte një mëngjes i bukur në fund të nëntorit», në stilin e shumë romaneve të skicuara nga Snoopy në stripat komikë nga amerikani Charles M. Schulz. Një parodi e gjerë dhe depërtuese, ndonjëherë e qartë dhe ndonjëherë e nënkuptuar, e cila shkurtimisht na lejon të kondensohemi në emrin e William of Baskerville - një personazh emblematic - si figura e nderuar e William of Ockham ashtu edhe romani *The Hound of the Baskervilles* nga Arthur Conan Doyle.

Nuk është vetëm çështje citatesh, syri drejtuar një lexuesi që e di dhe kënaqet duke u matur. Ka më shumë të bëjë me mbështetjen e asaj që njihet tashmë, për sa i përket emrit të saj, por më tepër me një rikthim të vazhdueshëm të zhanreve dhe modeleve të suksesshme: roman historik, roman policor, roman gotik, kont filozofik, etj.; por ky rikthim ndodh gjithmonë në dritën e ironisë, të lojës metatekstuale, sipas një procedure thelbësisht intelektuale dhe të dorës së dytë.

Është pikërisht kjo - natyra specifike e postmodernizmit italian - që është humbur në dekadat e fundit. Dhe jo sepse postmodernizmi e humbi shpejt betejën e tij; përkundrazi, ai triumfoi në mënyrë dërrmuese në çdo nivel. Ne e shohim këtë qartë në kohën tonë, ku «zhanret», veçanërisht «zhanret» dytësore të modernitetit, janë imponuar pa hezitim, nga letërsia policore te *romanca* (familjare, romanca, fantazia). Megjithatë, ato e kanë braktisur plotësisht strategjinë ironike, intelektualiste me të cilën ishin rishfaqur - me Econ dhe përmes Eco-s - në një mjedis postmodern.

Përkthimi: ExLibris

Botim i ri nga Ombra GVG

Caryl Lewis

MJALTE I HIDHUR

Përktheu: Sidita Dano Hoxhiq

Caryl Lewis [1978], një nga shkrimtarët më të njohura sot në Uells, është autore e shumë romaneve për të rritur dhe fëmijë dhe fituese e çmimeve më të rëndësishme letrare. Romani i saj Marta, Xheku dhe Sianko, 2004, është realizuar film dhe ka fituar gjashtë çmime BAFTA uellsiane dhe çmimin Spirit of the Festival në Festivalin e Medias në Sëlltik, 2010.

Lewis është edhe skenariste e filmave të suksesshëm Hinterland dhe Hidden. Ajo ka pasion bletët, argjendarinë dhe jeton në Uells.

“Një farë në bërthamën e një molle është një kopsht frutor i padukshëm”... kështu thotë një proverb i vjetër uellsian.

Hana ka jetuar gjithë jetën në Berlan Deg. Bashkëshorti i saj erdhi të jetonte në pemëtore mbasi u martuan së bashku. Ndërsa ai prehet i shtrirë në mes të dhomës, sepse është nata e funeralit, mbas pesëdhjetë viteve martesë, një jetë e tërë kujtimesh, treten përballë pamundësisë për të pranuar qetësinë e tij të përfjetshme.

Ai ishte shkrimtar dhe bletërritës njëkohësisht. Ishte një njeri i jashtëzakonshëm që kishte arritur ta kuptonte botën rretheqark, përmes gjuhës së bletëve. Para se të vdiste, ai i ka lënë Hanës njëmbëdhjetë letra, po aq sa është numri i kornizave të hojeve brenda në një koshere bletësh.

Secila prej letrave, është një analizë e ngjarjeve dhe situatave të ndryshme të martesës së tyre.

Në mëngjesin e funeralit, Sejdi, motra më e vogël e Hanës, me të cilën prej kohësh nuk kishte marrëdhënie, kthehet në shtëpi për ceremoninë mortore.

Ndërsa Hana i hap dhe fillon të lexojë letrat njëra pas tjetrës, zbulon një sekret tronditës që do ta detyrojë Hanën të rishqyrtojë të gjithë bashkëjetesën e saj.

Mjalti i hidhur është një roman që bashkon tri gra që nuk e kanë njohur kurrë karakterin e njëra-tjetrës dhe shumë të ndryshme në sjelljet e tyre, në një Eden të thyer. Ky roman analizon mënyrën se si secila prej tyre përpiket ta rindërtojë jetën sipas kushteve, lidhjeve dhe zgjedhjeve personale.

PARALELET

CARYL LEWIS

...një rrëfim i ndjeshëm dhe lirik, për dashurinë, humbjen dhe rigjetjen e jetës...

MJALTI I HIDHUR

roman



OMBRA GVG

Në historinë e letërsisë ruse ka dy kryeqëbërës. Njëri është personazh letrar, ndërsa tjetri është krejtësisht real. Dhe, nëse Salieri të paktën vuante nga brejtjet e ndërgjegjes në dramë, vrasësi i Pushkinit, Zhorzh Dantesi, duket se nuk u mundua aspak prej tyre. Për shumë vite e kemi përfytyruar si një francez të pashëm e të lëmuar, një aventurier mendjelehtë, që e shkatërroi gjeninë krejt rastësisht. Por realiteti është shumë më i frikshëm dhe më i mbrapshtë.

Një nga sekretet më pikante që rrethojnë figurën e Dantesit ishte lidhja e tij me të dërguarin holandez, baronin Lui Hekern. Në vitin 1836, diplomati 42-vjeçar, i cili nuk ishte martuar kurrë, birësoi oficerin 24-vjeçar. Dhe kjo, ndonëse babai biologjik i Zhorzhit ishte gjallë e shëndoshë.

Shoqëria e lartë e Peterburgut, që e kishte fort për zemër thashethemin, nxori menjëherë përfundimet e veta. Princi Trubeckoi shkruante hapur: «Nuk di si ta them: jetonte ai me Hekernin apo Hekerni me të... Nga sa duket, në marrëdhëniet me Hekernin ai luante vetëm një rol pasiv».

Kjo lidhje skandaloze i siguroi aventurierit të ri jo vetëm një mbiemër, por edhe hyrjen në shoqërinë e lartë, para dhe lidhje. Pikërisht Hekerni, «burri i rritur», u dashurua me oficerin e pashëm dhe e bëri «birin e tij të adoptuar», në mënyrë që ky të mund të shkëlqente në oborrin perandorak.

«Me kënaqësi të madhe e bëra këtë lajm publik»

Ironia e fatit qëndron në faktin se vetë Pushkini, pa e ditur, përhapte për vrasësin e tij thashethemin më poshtërues për një burrë. Në ditarin e vet, poeti shkruante: «Unë isha i pari që mora vesh se Dantesi jepej pas mëkatit sodomit dhe, me kënaqësi të madhe, e bëra këtë lajm publik. Këtë e mora vesh nga vajzat e

Vrasësi i Pushkinit: fakte tronditëse për të cilat tekstet shkollore heshtin

bordellos ku ai shkonte...».

Po, duke hedhur dritë mbi lidhjen e shthurur të francezit, vetë poeti, pa dashje, u shërbente atyre që po e shkatërronin, duke lënë të kuptohej, me nënkuptime pikante, natyra e vërtetë e marrëdhënies. Vetëm më vonë bashkëkohësit kuptuan se e gjithë kjo histori ishte veç maja e ajsbergut. Birësimi i Dantesit ishte kryer duke shkelur tri pika të legjislacionit francez. Hekerni kishte po aq nevojë për Dantesin, sa edhe Dantesi për të.

Martesa cinike me të kumatën e Pushkinit

Në prag të vitit fatal 1837 shpërtheu skandali. Për ta mbyllur çështjen dhe për të larguar nga vetja dyshimet për lidhjen me gruan e Pushkinit, Dantesi bëri një veprim që të trondit me cinizmin e vet. Ai i kërkoi dorën Jekaterina Gonçarovës, motrës së madhe të Natalisë, gruas së poetit. Shpotitësit e salloneve mondane e quajtën menjëherë vajzën e gjerë «bishti i fshesës», duke aluduar për pamjen e saj, që ishte larg idealeve të bukurisë.

Qëllimi i vërtetë i kësaj martese ishte i neveritshëm: duke u bërë zyrtarisht kunati i Pushkinit, Dantesi fitonte një arsye të ligjshme për të hyrë në shtëpinë e Gonçarovëve dhe për të vazhduar

flirtin me Natalinë. Një qytet nisën të qarkullonin zëra se martesa me «motrën e shëmtuar» ishte vetëm një mbulesë për lidhjen me bukuroshen më të madhe të Peterburgut. Pushkinit ia thoshin këtë thuajse hapur, dhe pikërisht ky tërbim, bashkë me ndjenjën e turpits publik, e shtynë drejt duelit fatal.

Pleqëria e lumtur e vrasësit

Por fakti më tronditës për Dantesin gjendet përtej kufijve të kësaj drame: jeta e tij jashtëzakonisht e suksesshme pas vrasjes. Menjëherë pas duelit, baroni u çgradua dhe u dëbua. Sipas ligjeve ushtarake të kohës, atë e kërcënonte dënimi me vdekje, por u treguan të mëshirshëm me të. I trembur për vdekje, ai iku nga Rusia me aq ngut, sa arriti të përshkonte 800 versta në vetëm katër ditë.

Pasi u kthye në Francë, Dantesi bëri një karrierë të shkëlqyer politike. U bë anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, deputet, kryetar i qytetit të lindjes dhe mik i ngushtë i perandorit Napoleon III. Më 27 mars 1852 u emërua senator i përjetshëm i Perandorisë së Dytë, post të cilin e mbajti deri në vitin 1870.

Për më tepër, ky njeri, që i kishte lyer duart me gjakun e një gjeniu,

punoi si agent i ambasadës ruse. Deri në vitet 1880, ai i përcillte Peterburgut informacione tejet të çmuara. Vitet e fundit të jetës i kaloi në kështjellën e familjes, i rrethuar nga fëmijët dhe nipërit, dhe vdiq në moshën 83-vjeçare.


Monument për vetveten

Dantesi nuk ndiente kurrfarë faji. Deri në fund të jetës mburrej se pikërisht dëbimi për shkak të vrasjes i kishte mundësuar të bënte karrierë. Sipas nipit të tij, Lui Metmanit: «Gjyshi ishte krejtësisht i kënaqur me fatin e vet... dhe thoshte jo rrallë se karrierën e tij të shkëlqyer politike ia detyronte vetëm largimit të detyruar nga Rusia për shkak të duelit».

Ai mendonte se «dielli i poezisë ruse» kishte përfunduar për t'i hapur udhë mirëqenies së tij personale. Gjeniu vdiq që vrasësi të jetonte në rehati. Për gati dy shekuj, e vërteta është mbuluar me mite, por një gjë mbetet e pandryshuar: përpara nesh nuk qëndronte një dashnor i zjarrtë, as një viktimë e rrethanave, por një aventurier gjakftohtë dhe llogaritës, biografia e të cilit është ende e aftë të tronditë.

Sipas portalit “Russkaja semerka”

Përkthimi; ExLibris



Dy portrete të Zhorzh Dantesit, vrasësit të Pushkinit: në kohën e duelit dhe në moshën e pleqërisë



Në një pjesë të prozës romantike bashkëkohore, dashuria konceptohet si një hapësirë e përkohshme largimi nga përditshmëria, ku tensionet e jetës së zakonshme zhvendosen në hije. Trilogjia e Talia Hibbert-it ndjek një drejtim tjetër. Në *Jetoje jetën Kloe Braun*, *Ogur nga qielli Dani Braun* dhe *Sillu si të ka hije Eva Braun*, dashuria nuk shfaqet si shpëtim i thjeshtë nga vështirësitë, por si mënyrë për t'i parë ato më qartë. Personazhet nuk bëhen të rëndësishëm për lexuesin sepse i tejkalojnë dhimbjet apo frikërat e tyre; përkundrazi, ato fitojnë thellësi pikërisht sepse romani i lejon të ekzistojnë brenda këtyre përvojave.

Talia Hibbert është një nga zërat më të rëndësishëm të romancës bashkëkohore britanike sepse i jep zhanrit një frymë të re dhe humor rinor. Në qendër të veprës së saj janë gra me ngjyrë, personazhe me sëmundje kronike, njerëz me spektrin autik, dhe njerëz që zakonisht letërsia romantike i ka anashkaluar. Megjithatë, rëndësia e Hibbert-it nuk qëndron thjesht te përfaqësimi. Ajo nuk i përdor këto identitete si tema të veçuara sociale, por i integron në vetë strukturën emocionale të romanit.

Trilogjia Braun mund të lexohet si një reflektim mbi mënyrat e ndryshme se si gratë përpigjen të rifitojnë kontrollin mbi jetën e tyre. **Kloe** përfaqëson dëshirën për të jetuar pas një periudhe të gjatë frike dhe kufizimi fizik. **Dani** përfaqëson mendjen analitike por që e ka më të vështirë të pranojë nevojën emocionale. **Eva**, nga ana tjetër, shfaqet si energji e shpërndarë, e cila vendos në pikëpyetje idenë se pjekuria duhet të duket gjithmonë si rregull, disiplinë dhe vetëkontroll.

Në *Jetoje jetën Kloe Braun*, romani ndërtohet rreth një elementi të thjeshtë rrëfimor: lista e Kloe-s për të "jetuar jetën". Në pamje të parë, kjo listë duket si një mjet komik dhe praktik për të shtyrë ngjarjen përpara. Por në të

Talia Hibbert, *Jetoje jetën Kloe Braun*,
Ogur nga qielli Dani Braun, *Sillu si të ka hije Eva Braun*, Trilogji (BOTIMET TOENA)

Dëshira dhe e drejta për lumturi: një lexim i trilogjisë së motrave Braun

Nga Anja Levanaj,
studente e masterit Letërsi Krahasuese në King's College London

vërtetë ajo funksionon si metaforë e dëshirës për kontroll. Kloe, e kufizuar nga dhimbja kronike dhe nga frika e një jete të paparashikueshme, përpigjet ta kthejë lumturinë në projekt, në plan, në diçka që mund të organizohet. Këtu qëndron ironia e hollë e romanit: sa më shumë që ajo përpigjet ta menaxhojë jetën, aq më shumë jeta e detyron të pranojë rastësinë.

Hibbert nuk e paraqet dhimbjen si diçka që dashuria duhet ta zhdukë. Përkundrazi, dashuria lind në prani të dhimbjes, jo pas shërimit të saj. Në figurën e Kloe-s, të jetosh nuk do të thotë ta mposhtësh trupin, por të mos lejosh që ai të bëhet përkufizimi i vetëm i ekzistencës.

Në *Ogur nga qielli Dani Braun*, vëmendja zhvendoset nga trupi drejt fjalëve, shenjave dhe keqkuptimit emocional. Një "ogur" është diçka që duhet interpretuar, një shenjë që premton ose paralajmëron. Dani është një personazh që mendon shpejt, flet me zgjuarsia dhe e përdor ironinë si mjet mbrojtjeje. Ajo mund të kuptojë botën në mënyrë teorike, por e ka më të vështirë të pranojë dobësinë e vet emocionale.

Këtu Hibbert përdor dialogun si

teknikë kryesore stilistike. Bisedat mes personazheve janë të shpejta, plot humor dhe tension, por nën këtë sipërfaqe komike fshihet një pyetje më serioze: si mund të kërkosih ndihmë pa u ndier i dobët? Humori, te Hibbert është formë karakterizimi. Në këtë mënyrë, komikja dhe brishtësia bashkëjetojnë me njëra-tjetrën.

Në *Sillu si të ka hije Eva Braun*, trilogjia arrin formën e saj më të çrregullt dhe më të gjallë. Eva është personazhi që e sfidon më hapur idenë e "sjelljes së duhur". Vetë titulli tingëllon si urdhër shoqëror, si një frazë që u drejtohet shpesh vajzave për t'i disiplinuar, për t'i bërë më të pranueshme, më të qeta, më të rregullta. Hibbert e kthen këtë urdhër në objekt ironie.

Kontrasti është figura qendrore e këtij romanit. Eva përfaqëson sjelljen e lirshme, ndërsa bota përreth kërkon strukturë. Çfarë do të thotë të jesh e rritur? A është pjekuria gjithmonë e dukshme në organizim, qëndrueshmëri dhe vetëkontroll?


Në të tre romanet, Hibbert përdor përsëritjen si parim strukturor. Secila motër Braun keqkuptohet nga bota, por secila në mënyrë të ndryshme. Kloe lexohet si e mbyllur sepse është e



kujdesshme; Dani si e ftohtë sepse është e vetëkontrolluar; Eva si e papjekur sepse nuk përputhet me normat tradicionale. Përmes tyre, romani ndërton tri variante të së njëjtës pyetje: si mund të duash dhe të duhesh pa u detyruar të ndryshosh veten?

Për lexuesin shqiptar, një vlerë e veçantë është përkthimi i trilogjisë në shqip nga shtëpia botuese Toena. Në një tekst ku humori, ritmi i dialogut dhe nuancat emocionale janë thelbësore, përkthimi kërkon jo vetëm saktësi, por edhe ndjeshmëri stilistike. Përkthimi më i mirë në shqip mbetet ai i TOENA-s, sepse arrin të ruajë lehtësinë e prozës së Hibbert-it pa e bërë atë sipërfaqësore.

Si përfundim, *trilogjia Braun* nuk është thjesht një seri romanesh romantike. Ajo është një reflektim mbi trupin, identitetin, dëshirën dhe mënyrën se si gratë mësojnë të mos kërkojnë falje për ekzistencën e tyre. Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron arritja më e madhe e Talia Hibbert-it: ajo nuk e përdor dashurinë për t'i shpëtuar personazhet nga vetja, por për t'u dhënë atyre hapësirën që të jenë vetvetja plotësisht.



Karikaturë nga Arben Mexsi

